

**STUDIME SOCIALE**  
**Revistë e Institutit të Sociologjisë**  
**Vëll. 4, Nr. 1, 2010**

**DREJTOR**  
LEKË SOKOLI

**KRYEREDAKTOR**  
SEJDIN CEKANI

**BORDI BOTUES:**

|                  |                    |
|------------------|--------------------|
| SERVET PËLLUMBI  | EGLANTINA GJERMENI |
| <i>kryetar</i>   | BARBARA HEYNS      |
| MARTIN BERISHAJ  | ANJEZA HOXHALLARI  |
| MIRELA BOGDANI   | KARL KASER         |
| ALBANA CANOLLARI | NEVILA KOÇALLARI   |
| LIQUN CAO        | PAJAZIT NUSHI      |
| TONIN ÇOBANI     | ALI PAJAZITI       |
| ZYHDI DERVISHI   | GËZIM TUSHI        |
| GRIDA DUMA       | ALFRED UÇI         |
| KRISTO FRASHËRI  | BRUNILDA ZENELAGA  |
| ILIR GËDESHI     | JAY WEINSTEIN      |

**Instituti i Sociologjisë**

**BORDI AKADEMIK:**

|                    |                 |
|--------------------|-----------------|
| MARK TIRTA,        | ARIM KRASNIQI   |
| <i>kryetar</i>     | IRENA NIKAJ     |
| FATBARDHA GJINI,   | LILJANA REÇKA   |
| <i>nënkryetare</i> | ENIS SULSTAROVA |
| ALBANA CANOLLARI   | LUAN SHAHOLLARI |
| KOZETA HOXHA       |                 |

**BORDI EKZEKUTIV:**

LEKË SOKOLI - *drejtor ekzekutiv*  
SERVET PËLLUMBI - *drejtor akademik*  
SEJDIN CEKANI - *drejtor i botimeve*

© Instituti i Sociologjisë

Mendimet e shprehura në materialet e revistës u përkasin autorëve dhe nuk shprehin  
opinionet e Institutit të Sociologjisë apo bordit të revistës

Arti Grafik: **Orest Muça**

Materialet e revistës *Studime Sociale* do t'i gjeni edhe në trajtë elektronike në:

[www.instituti-sociologjise.org](http://www.instituti-sociologjise.org)

Kontakte:

Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", pall. 3/3, Tiranë

Tel: + +355 (4)2268819; Cel: 0694067682; 0682236949

E-Mail: [info@instituti-sociologjise.org](mailto:info@instituti-sociologjise.org)

ISBN: 978-99956-795-7-6

## Instituti i Sociologjisë

- 130 anëtarë, nga të cilët:
- 83 anëtarë të Asamblesë
- 27 anëtarë korrespondentë në SHBA, Angli, Austri, Gjermani, Itali, Suedi, Hungari, Turqi, Greqi, Maqedoni, Kosovë etj.
- 10 Anëtarë Nderi
- Degë në të gjitha rrethet që kanë universitete



# STUDIME SOCIALE

## Revistë e Institutit të Sociologjisë

Vëll. 4, Nr. 1, 2010

### Përmbajtja:

|                                   |                                                                                                                                                                        |
|-----------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Lekë SOKOLI                       | <i>Diferencimi social dhe varfëria: Shqipëria në kontekst euroindor</i> ..... 5                                                                                        |
| Enis SULSTAROVA                   | <i>Nga ideologjia në utopi: rigjallërimi i demokracisë në Shqipëri</i> ..... 17                                                                                        |
| Brunilda ZENELEGA                 | <i>Shqiptarët që studiojnë në vendet e Europës Perëndimore, faktor real i transformimeve sociale</i> ..... 25                                                          |
| Albana CANOLLARI & Guida de ABREU | <i>Studim pilot mbi përfaqësitë sociale të prindërve rreth shkollimit të fëmijëve: rasti i emigrantëve, joemigrantëve dhe emigrantëve të kthyer shqiptarë</i> ..... 33 |
| Tonin ÇOBANI                      | <i>1989: Rënia e mureve dhe ardhja e parë (jo)rastësore e Nënë Terezës në Shqipëri</i> ..... 39                                                                        |
| Ermioni CEKANI                    | <i>Edukimi gjinor në arsimin parashkollor</i> ... 43                                                                                                                   |
| Rudina HOXHA                      | <i>Familja shqiptare dhe evoluimi i legjislationit shoqëruar shqiptar</i> ..... 51                                                                                     |
| Besim GOLLOPENI                   | <i>Evolucioni i martesës në Kosovë</i> ..... 61                                                                                                                        |
|                                   | <i>Recensione, analiza veprash:</i>                                                                                                                                    |
| Hasan JASHARI                     | <i>Sociologjia e një filmi: demokracia e vitit 1936</i> ..... 71                                                                                                       |
| Gëzim TUSHI                       | <i>Servet Pëllumbi midis filozofit dhe politikanit</i> ..... 76                                                                                                        |
| Enis SULSTAROVA                   | <i>Kombi dhe era globale</i> ..... 78                                                                                                                                  |



*Tiranë, më 24 prill 2010*

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Instituti i Sociologjisë**, anëtar i rregullt dhe kolektiv i International Sociological Association (ISA), i përfaqësuar nga drejtori akademik, prof. Servet PËLLUMBI dhe

**Universitetit “Marin Barleti”**, i përfaqësuar nga prorektori, prof. Dritan ZELA, bien dakord dhe nënshkruajnë këtë

### Marrëveshje bashkëpunimi

Instituti i Sociologjisë dhe Universiteti “Marin Barleti” vendosin një marrëdhënie afatgjatë bashkëpunimi. Objekt i kësaj marrëveshjeje është:

- Integrimi i shkollimit dhe përgatitjes së specialistëve të shkencave sociale (sociologji, psikologji etj.), realizuar nga Universiteti “Marin Barleti”, me kërkimin shkencor të realizuar nga Instituti i Sociologjisë dhe organizatat partnere të tij.

- Hartimi, aplikimi dhe realizimi i projekteve të përbashkëta për studimin e realitetit shqiptar, rritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore dhe, përgjithësisht, rritjen e cilësisë së arsimit të lartë etj.

- Organizimi i veprimtarive të përbashkëta të seksioneve tematike të Institutit të Sociologjisë me Katedrën dhe Departamentin e Shkencave Sociale të Universitetit “Marin Barleti” (konferenca kombëtare e ndërkombëtare, simpoziume, forume, promovime etj.), si dhe prezantimi i krijimtarisë së plotë të autorëve studiues të shkencave sociale.

- Organizimi i përvitshëm i “Ditës së vlerësimit dhe mirënjohjes”, kushtuar figurave të shquara të mendimit shqiptar.

- Realizimi i botimeve të përbashkëta dhe shkëmbimi i ndërsjellë i botimeve shkencore për bibliotekat respektive.

- Realizimi i sondazheve në nivel rajonal e kombëtar për njohjen e thelluar të jetës shoqërore, prirjeve të zhvillimit, interesave të të rinjve etj., si dhe krijimi i një qendre të përbashkët të përpunimit të të dhënave kërkimore.

- **Instituti i Sociologjisë** do të vërë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik të Universitetit “Marin Barleti” punimet dhe botimet shkencore të tij. Lidhjet ndërkombëtare të Institutit të Sociologjisë do të shfrytëzohen edhe për leksione të hapura në auditor ose on-line, për emisione apo veprimtari të tjera që do të realizohen në kuadrin e Universitetit “Marin Barleti”.

- Një pjesë të praktikave mësimore të parashikuara në programet e tyre të shkollimit, studentët e shkencave sociale të Universitetit “Marin Barleti” do t'i kryejnë pranë Institutit të Sociologjisë ose organizatave partnere të tij.

- **Universiteti “Marin Barleti”** do të krijojë hapësira e mundësi për organizimin e veprimtarive të Institutit të Sociologjisë, për botimin e organit shkencor të tij, për shërbime informatike etj.

### Në mënyrë më specifike parashikohet:

Nxjtja e një lëvizjeje për humanizimin e shoqërisë shqiptare, mbështetur edhe në mendimin humanist barletian, pjesë e rëndësishme e humanizmit evropian dhe botëror (sidomos në periudhën 2010-12, që përkon me 500-vjetorin e botimit të veprës kryesore të Barletit e deri në 500 vjetorin e vdekjes së tij);

Organizimi i konferencës shkencore ndërkombëtare: “Barleti dhe identiteti kulturor i shqiptarëve”, duke synuar rivlerësimin i figurës së Barletit e të veprës shumëdimensionale të tij në rrafsh filozofik, sociologjik, psikologjik, antropologjik, etnologjik, politologjik, historik, socio-linguistik etj., në kontekstin e formimit të identitetit kulturor dhe kombëtar shqiptar (në bashkëpunim me institucione dhe dikastere të interesuara).

Për Universitetin “Marin Barleti”  
Prorektori akademik  
Prof. Dritan ZELA

Për Institutin e Sociologjisë  
Drejtori akademik  
Prof. Servet PËLLUMBI

# DIFERENCIMI SOCIAL DHE VARFËRIA: SHQIPËRIA NË KONTEKST EUROLINDOR<sup>1</sup>

Lekë SOKOLI - *Instituti i Sociologjisë*

---

## Në vend të hyrjes: starti i pabarabartë

Njëzetvjetori i rënies së Murit të Berlinit (1989-2009) ishte një rast i veçantë për të reflektuar mbi shndërrimet e gjithanshme që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë kësaj periudhe të pazakontë, krahasuar me vendet e tjera të Europës. Qasja “Shqipëria në kontekst eurolindor...” (kjo është njëra gjymtyrë e temës së konferencës së sotme), na çon te metoda krahasuese e kërkimit dhe shqyrtimit.

Këtë metodë do ta aplikojmë në tri rrafshë: në krahasimin e transformimeve të ndodhura në vendet ish-komuniste të Europës Qendrore e Lindore kundrejt pjesës perëndimore të Europës (1); në krahasimin e transformimeve që kanë ndodhur në Sh-

qipëri, kundrejt vendeve të tjera të Lindjes europiane (2); në krahasimin e disa variabileve që rezultojnë nga testimi në realitetin e sotëm shqiptar e të disa treguesve mbi diferencimin social dhe varfërinë (3).

Por fillimisht na duhet të rendisim disa të vërteta - të pranuar gjerësisht nga studiuesit socialë - mbi këto problematika. Së pari, njëzet vjet pas fillimit të transformimeve demokratike në vendet ish-komuniste, termi “ish-komuniste” e ka humbur tanimë kuptimin. E ç’mund të përfaqësojë vendosja në një emërues të përbashkët, të themi, e Shqipërisë, Çekisë, Uzbekistanit apo Estonisë? Thuajse asgjë!

Së dyti, pavarësisht nga “fati i përbashkët historik” i vendeve të Europës Qendrore

**Lekë Sokoli** është drejtor ekzekutiv i Institutit të Sociologjisë dhe prorektor i Universitetit “Marin Barleti”. Është autor i mbi 20 librave në fushën e sociologjisë teorike, si “Sociologjia”, “Themeluesit e sociologjisë”, “Hyrye në sociologji” etj., të problemeve sociale, si “Droga - historia, përkufizime, klasifikimi, efektet, terapia”, “Divorci - vrojtime e refleksione”, “Interesat dhe harmonizimi i tyre”, “Trafikimi, rasti i Shqipërisë”, “Prostitucioni si profesion, vështrim sociologjik”; apo të metodologjisë, së kërkimit si “Metodat e kërkimit në shkencat sociale” etj., etj.

---

<sup>1</sup>. Referat i mbajtur në konferencën ndërkombëtare “Njëzet vjet transformime demokratike; Shqipëria në kontekst eurolindor” organizuar nga Instituti i Sociologjisë, Universiteti “Aleksandër Moisiu” i Durrësit dhe Fondacioni “Fridrich Ebert Stiftung”, mbajtur në Tiranë (Tirana International Hotel), më 20 dhjetor 2009.

dhe Lindore (të paktën si vende ish-komuniste), mund të thuhet se diferencimi i tyre në rrugën drejt demokracisë dhe integritimit evropian është kushtëzuar në një masë të konsiderueshme nga “starti jo i barabartë”. Shqipëria e vitit 1989 ishte një ndër vendet me nivelin më të ulët të plotësimit të interesave jetësore të shtetasve të saj<sup>2</sup>. Nga ana tjetër, Shqipëria ishte dhe mbeti vendi me shkallën më të lartë të përqendrimit të mjeteve të prodhimit në duart e shtetit. Në Shqipëri, *si askund tjetër, shteti u bë i vetmi pronar dhe i vetmi punëdhënës*.

Së treti, Shqipëria mbeti vendi më i pareformuar krahasuar me vendet e tjera ish-komuniste. Ajo eci thujse pa zigzage drejt një sistemi gjithnjë e më “të rëndë”, në rrafsh ekonomik,<sup>3</sup> por jo vetëm. Në të gjitha vendet e tjera u bënë, në shkallë të ndryshme, korrektive të sistemit dhe reformime. Shqipëria, përkundrazi, duke ndjekur strategjinë “as Lindje, as Perëndim”, shkoi në mënyrë paradoksale drejt komunistizimit gjithnjë e më të madh të

jetës politike, ekonomike e shoqërore<sup>4</sup>.

Pra “starti drejt demokracisë” i viteve 1989-1990 i vendeve të Lindjes europiane ishte i pabarabartë si për nga niveli i zhvillimit, ashtu edhe për nga niveli i reformimit ose shkalla e demokratizimit paraprak. Kjo do të thotë se Shqipëria, krahasuar me vendet e tjera, *objektivisht do ta kishte më të vështirë për të marrë kthesën drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut*.

Por, veç faktorëve objektivë, në distancimin nga vendet e tjera do të ndikojnë edhe faktorë të rendit subjektiv apo, siç mund t’i quajmë, “faktorë të vullnetit”. Le të ndalemi në një referencë domethënëse të viteve të para të tranzicionit demokratik të vendeve ish-komuniste. Në një artikull të vitit 1993, të titulluar “The Great transformation” (*Transformimi i madh*), studiuesi i madh polako-amerikan Zbigniew Brzezinski ka përcaktuar “kalendarin e ardhshëm” historik të vendeve ish-komuniste, duke i klasifikuar ato në katër grupime kryesore<sup>5</sup>.

<sup>2</sup>. Nga një studim i realizuar në vitet 1988-1989 mbi interesat e punonjësve në sektorin e industrisë së rëndë shqiptare, atëherë më të paguarit në Shqipëri (shih, për shembull, Sokoli, 2004), krahasuar me studime të ngjashme realizuar në vendete e tjera ish-komuniste provon nivelin mjaft të ulët të plotësimit të interesave themelore të njerëzve në Shqipëri, kundrejt thujse të gjitha vendeve të të njëjtit “kamp”.

<sup>3</sup>. Termi “i rëndë” për të karakterizuar variantin shqiptar të komunizmit, është huazuar nga “industria e rëndë”, që pati përparësi absolute në Shqipëri, kundrejt asaj të lehtë e ushqimore, madje deri në vitin 1990. Por ky emërtim është përdorur edhe për vendet e tjera. Në Hungari, për shembull, transformimet filluan qysh më 1956 (revolucioni demokratik hungarez). Pavarësisht se Hungaria mbeti një vend komunist, atje ndahet qartësisht periudha “e komunizmit të rëndë” e para vitit 1956 dhe ajo e komunizmit “të lehtë” (ose e komunizmit të gulashit, siç e quajnë hungarezët), pas këtij viti. Kështu edhe në vende të tjera, si në Poloni, Çekoslovaki, Jugosllavi etj.

<sup>4</sup>. Në fushën politike, deri në vitin 1990, Shqipëria nuk njohu asnjë lloj reforme. Në ekonomi u ndoq me kokëfortësi strategjia e ndërmarrjeve të mëdha (industria) dhe kolektivizimit të skajshëm e gjithnjë e më “të rëndë” (bujqësia - përmendim të ashtuquajturat “kooperativa të tipit të lartë”, tufëzimin e bagëtive, tkurrjen deri në shuarje të oborrit kooperativist etj.). Në jetën shoqërore u vijua pa mëdyshje drejt “krijimit të koncepteve unike për mënyrën e jetesës” (Alia, 1996), për të mos shkuar më tej.

<sup>5</sup>. Në grupimin e parë janë renditur Polonia, Republika Çeka, Hungaria, Sllovenia dhe Estonia. E ardhmja e këtyre vendeve, sipas këtij autori të njohur, ishte lehtësisht e parashikueshme. Ato ishin vendosmërisht të angazhuara për t’u bërë vende me një demokraci të qëndrueshme.

Në grupimin e dytë janë renditur Letonia, Bullgaria, Sllovakia, Kroacia, Lituania, Rumania, si vende me karakteristika që premonin për zhvillime demokratike normale, por që politikisht dhe ekonomikisht kishin më shumë dobësi, kundrejt të parave. Ai nuk përjashtonte, gjithsesi, mundësinë e zhvillimeve kontradiktore në këto vende.

Në kategorinë e tretë të këtij klasifikimi përfshihen Rusia, Ukraina, Bjellorusia, Gjeorgjia, Azerbajxhani, Armenia, Kazakistani dhe Uzbekistani. Këto, sipas tij, ishin vende me tipare ekonomike e politike të paqarta e që, të paktën për një dekadë apo diçka më tepër, nuk premonin shumë.

Kategoria e katërt e “kalendarit” Brzezinski përfshin vendet që mbeten: Serbia, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja, Moldavia, Takhikistani. Sipas tij, këto vende kishin tipare që, për shumë arsye, nuk premonin zhvillim demokratik atëherë (në vitin 1993) dhe në një të ardhme të parashikueshme.

Sot mund të konfirmohet se Brzezinski ka bërë ndoshta parashikimin më të saktë të dispariteteve që ekzistonin dhe vazhdojnë të ekzistojnë në Europën Qendrore e Lindore. Koha provoi se ky “kalendar” ishte përcaktuar me një saktësi të admirueshme. Ajo që bën përshtypje, referuar Shqipërisë, nuk është vetëm renditja e saj në grupimin e fundit, por edhe justifikimi i një renditjeje të tillë me një shkak të karakterit subjektiv. Brzezinski thotë shprehimisht:

Sjellja apo angazhimi i liderëve të këtyre vendeve drejt demokracisë pluraliste është problematike.

Shqipëria vazhdon të distancohet, në “garën integruese”, edhe nga vendi i parafundit i rajonit dhe, po të flasim në gjuhën e autorit të mësipërm, kryesisht sepse sjellja apo angazhimi i liderëve drejt një demokracie pluraliste vazhdon të jetë problematike.

20 x 20 x 20:  
disnivelet njëzet vjet më pas

Në këto dy dekada shndërrimet kanë qenë të gjithanshme. Ka ndryshuar thuajse gjithçka në bazën dhe superstrukturën e shoqërisë, në marrëdhëniet e pronësisë e përgjithësisht në marrëdhëniet ekonomike, në marrëdhëniet shoqërore, në idetë dhe perceptimin e botës etj, etj.

Le të marrim dy çështje që lidhen me njëra-tjetrën: varfërinë dhe diferencimin social-ekonomik apo shtresëzimin shoqëror. Le të krahasojmë fillimisht nivelin e zhvillimit të vendeve ish-komuniste, kundrejt vendeve të tjera (jo ish-komuniste) të Europës. Më 9 nëntor 2009, pikërisht në ditën e njëzetvjetorit të rënies së Murit të Berlinit, Fondi Monetar Ndërkombëtar, përmes *The economist*, publikoi disa të dhëna krahasuese, bazuar në sistemin “20 x 20 x 20”, që

do të thotë: 20 vjet transformime për 20 vende ish-komuniste të Europës, kundrejt 20 vendeve jo ish-komuniste të saj (15 ndër to ishin atëherë anëtare të BE-së). Na rezulton (tabela 1) se raporti i GDP (prodhimi i përgjithshëm bruto) për frymë të popullsisë Perëndim-Lindje është afërsisht 4 herë<sup>6</sup>.

Ndërsa ndër 20 vendet ish-komuniste, Shqipëria me rreth 3400 dollarë për frymë në vit, përbën treshen e fundit, bashkë me Ukrainën dhe Moldavinë. Kundrejt mesatares së këtyre vendeve, Shqipëria ka një GDP rreth 2.7 herë më të vogël. *Pra, na duhen ritme të tjera zhvillimi...*

Tabela 1: GDP për frymë i 20 vendeve ish-komuniste të Europës

| Renditja  | Shtetet 'ish-komuniste'                  | GDP për frymë/vit (në USD) |
|-----------|------------------------------------------|----------------------------|
| 1         | Sllovenia                                | 24180                      |
| 2         | Republika Çeke                           | 16680                      |
| 3         | Sllovakia                                | 16240                      |
| 4         | Estonia                                  | 13980                      |
| 5         | Kroacia                                  | 13220                      |
| 6         | Hungaria                                 | 12530                      |
| 7         | Lituania                                 | 12090                      |
| 8         | Letonia                                  | 11910                      |
| 9         | Polonia                                  | 10580                      |
| 10        | Rusia                                    | 8230                       |
| 11        | Rumania                                  | 7770                       |
| 12        | Bullgaria                                | 6820                       |
| 13        | Mali i Zi                                | 6510                       |
| 14        | Serbia                                   | 5480                       |
| 15        | Bjellorusia                              | 5190                       |
| 16        | Maqedonia                                | 4410                       |
| 17        | Bosnja                                   | 4080                       |
| 18        | Shqipëria                                | 3450                       |
| 19        | Ukraina                                  | 2520                       |
| 20        | Moldavia                                 | 1510                       |
| Mesatarja | Për 20 vendet 'ish-komuniste' të Lindjes | M (vl)=9363                |
| Mesatarja | Për 20 vendet e Perëndimit               | M (vp)=38380               |
| Raporti   | M (vp)/M (vl)                            | ~ 4 Herë                   |
| Raporti   | M (vl)/Shq.                              | ~ 2.7 herë                 |

<sup>6</sup> Nga 38 380 dollarë për frymë që është mesatarja e vendeve të Perëndimit (Mvp), në 9363 dollarë për frymë që është mesatarja e vendeve të Lindjes (Mvl).

**Tabela 2:** *Diferencimi përkundrejt pasurisë; Shqipëria vs. Lindjes europiane*

| Shtetet e krahasuara | Përqindja e pasurisë       |                            |         |
|----------------------|----------------------------|----------------------------|---------|
|                      | 20 % e familjeve të varfra | 10 % e familjeve të pasura | Raporti |
| Shqipëria            | 5.0                        | 30.0                       | 6.00    |
| Bullgaria            | 8.3                        | 24.7                       | 2.97    |
| Çekia                | 10.5                       | 23.5                       | 2.24    |
| Hungaria             | 6.0                        | 26.8                       | 4.47    |
| Polonia              | 7.1                        | 25.3                       | 3.56    |
| Rumania              | 8.9                        | 22.7                       | 2.50    |
| Sllovakia            | 11.3                       | 18.2                       | 1.61    |
| Sllovenia            | 9.3                        | 24.5                       | 2.63    |

### Diferencimi social-ekonomik

Njëzet vjet më parë, Shqipëria u sh-këput nga një rend i cili, nëse përdorim gjuhën e Çurçillit, ishte “rendi i shpërndarjes së barabartë të varfërisë”. Pas njëzet vjetësh, krahas rritjes së nivelit të jetesës, vërehet edhe një diferencim mjaft i skajshëm ekonomik, krahasuar me vendet e tjera ish-komuniste (tabela 2).

Pra, raporti mesatar i pasurisë së 10 për qind të familjeve më të pasura, kundrejt 20 për qind të familjeve më të varfra në të shtatë vendet e tjera të Lindjes europiane është 2.85 ose 2.1 herë më i vogël se i njëjti raport referuar Shqipërisë. Këtej dalim në përfundimin se duhen politika më të studiuar për rritjen harmonike të nivelit të jetesës në shtresa të ndryshme të

popullsisë, duke përfshirë ndoshta edhe një rishikim të modeleve të vendosura, siç është “taksa e sheshtë”.

### Përfundimet e një sondazhi kombëtar

Ndërrojmë “metodologji” dhe kalojmë nga metoda krahasuese në atë të testimit të problemeve. Do t’i referohemi në vijim një sondazhi të bazuar në një kampion kombëtar me 1364 individë, i realizuar në 11 nga 12 qarqet e Shqipërisë<sup>7</sup>. Prej kësaj rezultojnë, së pari, një mospërputhje midis sondazhit kombëtar me të dhënat zyrtare të INSTAT-it. Të dhënat zyrtare, me disa përlllogaritje tonat, janë si në tabelën 3.

Në këtë raport zyrtar jepen edhe disa detaje metodologjike. Prej tij citojmë:

**Tabela 3:** *Varfëria sipas INSTAT (prill 2009)*

| Kategoritë “të varfër” dhe “skajshmërisht të varfër” | 2002    |      | Vitet referues |      | 2008    |      |
|------------------------------------------------------|---------|------|----------------|------|---------|------|
|                                                      | Në nr.  | Në % | Në nr.         | Në % | Në nr.  | Në % |
| Të varfër                                            | 813 196 | 25.4 | 575 659        | 18.5 | 373 137 | 12.4 |
| Skajshmërisht të varfër                              | 160 078 | 5.0  | 108 908        | 3.5  | 36 110  | 1.2  |

<sup>7</sup>. Banka e të dhënave të këtij sondazhi ndodhet në arkivin e Institutit të Sociologjisë.

**Tabela 4:** *Familjet sipas niveli ekonomik*

| Vlerësimi i familjeve sipas nivelit të pasurisë | Frekuenca |              |
|-------------------------------------------------|-----------|--------------|
|                                                 | Në numër  | Në përqindje |
| E pasur                                         | 45        | 3.3          |
| E mesme                                         | 931       | 68.6         |
| E varfër                                        | 300       | 22.1         |
| Shumë e varfër                                  | 82        | 6.0          |
| Gjithsej                                        | 1358      | 100.0        |

Pjesa e popullsisë, konsumi mujor real për frymë i së cilës është 4891 lekë (me çmimet e vitit 2002), ka rënë nga 25.4 për qind në 2002, në 18.5 për qind në vitin 2005 dhe në 12.4 për qind më 2008.

Nga ky citim veçojmë dy çështje të kontestuara nga specialistët. Së pari, studimi nuk i referohet minimumit jetik të çdonjërit prej viteve të referencës, por një treguesi tjetër, që është konsumi mujor real për frymë (prej 4891 lekësh, afërsisht një dollar në ditë) për kategorinë e vendeve për të cilat minimumi jetik llogaritet me 1-2 dollarë në ditë, siç janë vendet e Afrikës, për shembull. Së dyti, për studimin e varfërisë, rëndësi të madhe ka studimi i indeksit të çmimeve dhe inflacioni. Kjo nuk mund të mos reflektohet edhe në llogaritjen e nivelit të varfërisë dhe të pjesës së

popullsisë që vlerësohet se është “e varfër” apo “skajshmërisht e varfër”.

Të dhënat në vijim janë nga sondazhi i realizuar. (Tabela 4).

Siç shihet, 28.1 për qind e familjeve të të anketuarve janë, sipas vlerësimit të tyre, familje “të varfra”. Ndër to, 6 për qind janë familje “shumë të varfra” ose, në gjuhën zyrtare që përdorëm më sipër, “skajshmërisht të varfra”. (Tabela 5).

Siç shihet nga të dhënat e tabelës 5, rreth 65 për qind e familjeve me nivel shumë të lartë ekonomik jetojnë në qytetet e mëdha, rreth 22 për qind në qytetet e vogla dhe 13 për qind në fshatra. E kundërta ndodh me familjet e varfra. *Mbi 60 për qind e familjeve që jetojnë në varfëri të skajshme jetojnë në fshatra*. Megjithatë të paktën ¼ e familjeve të klasifikuara si “shumë të varfra” jetojnë në qytetet e

**Tabela 5:** *Diferencimi i familjeve sipas vendbanimeve*

| Familja sipas nivelit ekonomik | Qytetet e mëdha | Qytetet e vogla | Fshatra | Gjithsej |
|--------------------------------|-----------------|-----------------|---------|----------|
| E pasur                        | 64.5            | 22.2            | 13.3    | 100.0    |
| E mesme                        | 50.7            | 21.7            | 27.6    | 100.0    |
| E varfër                       | 51.6            | 15.6            | 32.9    | 100.0    |
| Shumë e varfër                 | 25.4            | 14.3            | 60.1    | 100.0    |

<sup>6</sup> Chiesa, G., Villari, M., Superklani, kush e komandon ekonominë botërore? Bota Shqip: New Media Institut, 2004, f. 5.

mëdha. Sidoqoftë, diferencimi është i qartë dhe *sugjeron zhvillim të harmonizuar në qytete e fshatra, sidomos politika më efektive në sektorin e bujqësisë.*

### Një hipotezë rreth çështjes “varfëria dhe fëmijët”

Bazuar në jetën tradicionale shqiptare dhe në shndërrimet e periudhës 1945-1990 (në të cilën është stimuluar rritja sa më e shpejtë e popullsisë), si dhe në vështirësitë e dy dekadave të para të epokës demokratike (1991-2009), hartuam këtë hipotezë fillestare:

numri i madh i fëmijëve - karakteristike bazë e familjes tradicionale shqiptare - në kushtet e kërkesave të reja të kohës - të panjohura më parë - vështirëson plotësimin e funksioneve bazë të familjes, pra ndikon në rritjen e varfërisë, e cila, nga ana e saj, bëhet shkak për vështirësi suplementare që cenojnë më tej cilësinë e jetës së fëmijëve dhe kështu me radhë...

Prisnim, pra, që shkalla e varfërisë së familjeve të ishte në përpjesëtim të drejtë me numrin e fëmijëve. Por nga studimi konstatuam vetëm “mbeturinat” e një fenomeni (tradite të mëparshme), por jo vetë fenomenin e supozuar fillimisht në

formë hipoteze. Në këto vite të periudhës paskomuniste rezultoi të kenë ndodhur ndryshime radikale në fushën e familjes e të marrëdhënieve familjare, të marra në kompleks. Këto shndërrime kanë ndikuar në ndryshimin e peshës specifike të fëmijëve (deri 18 vjeç) në popullsinë shqiptare, në krijimin e një problematike të re moshore, në një status të ri të fëmijëve etj.

Pra, të dhënat e provojnë vetëm pjesërisht hipotezën tonë. Gjithsesi rezultoi se:

familjet “e varfra” kanë mesatarisht më shumë fëmijë se familjet “e mesme” (raporti  $v/m=1.2$ );

familjet “e mesme” kanë më shumë fëmijë se familjet “e pasura” (raporti  $m/p=1.1$ );

familjet “e varfra” kanë ende më shumë fëmijë se familjet “e pasura” (raporti  $v/p=1.3$ ). Kjo është më e theksuar për familjet “shumë të varfra” (që shkon në një raport afërsisht 1.4).

Këto të dhëna pasqyrohen në tabelën vijuese (tabela 6: *Fëmijët sipas nivelit ekonomik*). Ne përllogaritëm gjithashtu numrin e fëmijëve që aktualisht jetojnë në familje “të pasura”, “të mesme” apo “të varfra”. (Tabela 6).

Siç shihet, rreth një e treta e fëmijëve jetojnë në familje që e konsiderojnë veten “të varfra” (23.9 për qind) e “shumë të varfra” (8.4 për qind), rreth 65 për qind në familje të vlerësuara si “të mesme” dhe vetëm një pjesë

**Tabela 6:** Fëmijët 0-18 vjeç, sipas nivelit ekonomik të familjeve të tyre

| Fëmijë që jetojnë në:   | Frekuenca, referuar fëmijëve 0-18 vjeç |              |
|-------------------------|----------------------------------------|--------------|
|                         | Në numër                               | Në përqindje |
| Familje të pasura       | 34 037                                 | 3.0          |
| Familje të mesme        | 734 059                                | 64.7         |
| Familje të varfra       | 271 159                                | 23.9         |
| Familje shumë të varfra | 95 303                                 | 8.4          |
| Gjithsej                | 1 134 558                              | 100.0        |

<sup>7</sup> Obama, B., Guximi për të shpresuar, Dudaj 2008, f. 35.

<sup>8</sup> Nurellari, A., Kriza ekonomike dhe rruga e tretë, *Shqip* 21. 10. 2008.

**Tabela 7:** *Vlerësimi i niveli ekonomik kundrejt dhjetë viteve më parë*

| Familja është:       | Frekuenca e përgjigjeve |              |
|----------------------|-------------------------|--------------|
|                      | Në numër                | Në përqindje |
| Më të pasur          | 589                     | 43.2         |
| Pak a shumë njësoj   | 450                     | 33.0         |
| Më të varfër         | 96                      | 7.0          |
| Nuk mund ta vlerësoj | 227                     | 16.7         |
| Gjithsej             | 1362                    | 100.0        |

*e vogël (rreth 3 për qind) në familje që vlerësohen si “të pasura”.* Nga të dhënat e këtij sondazhi del se numri i fëmijëve që jetojnë në familje të varfra është rreth 2.5 herë më i madh se të dhënat zyrtare të raportuara në raportin “Shqipëria: trendi i varfërisë 2002-2005-2008”, publikuar në prill 2009 nga Instituti i Statistikës (shih tabelën 3)<sup>8</sup>.

### **Dinamika e varfërisë; prirja e rritjes së nivelit ekonomik**

Por cila është dinamika e varfërisë? Thënë ndryshe: si jetojnë familjet shqiptare sot, kundrejt viteve më parë dhe çfarë presin ato për të ardhmen e afërt? Si instrument për matjen nivelit ekonomik të familjeve, në dinamikën e vet, shërbyen dy pyetje të anketës se (1) cili është niveli ekonomik i familjeve shqiptare kundrejt dhjetë viteve më parë (vitit 1999) dhe (2) si parashikohet të jenë ekonomikisht ato në vitin 2015? Përgjigjet e pyetjeve respektive janë paraqitur në tabelat 7 dhe 8.

Rezulton se përqindja e familjeve që jetojnë më mirë se dhjetë vjet më parë është 6.2 herë më e madhe se pjesa e familjeve niveli ekonomik i të cilave në këto dhjetë

vjet është ulur. Por rreth 1/3 e të anketuarve pohojnë se niveli ekonomik i familjeve të tyre nuk ka shumë ndryshim me atë të dhjetë viteve më parë. Pak a shumë këtë vlerësim kanë edhe ata që e kanë të vështirë të vlerësojnë ndryshimin, pra gjithsej. Kështu, rreth 1/2 e të anketuarve pohojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi se në dhjetë vjet niveli ekonomik i familjeve të tyre thuhet nuk ka ndryshuar. Por, dhjetë vjet të referencës sonë përfaqësojnë rreth 1/2 e periudhës paskomuniste, kohë në të cilën shqiptarët u vunë në kërkim të pasurisë, madje u pasuruan kundrejt periudhës së para viteve 1990. Në këtë këndvështrim, *mund të pohojmë se ky “stanjacion” i gjysmës së popullsisë përfaqëson një të dhënë shqetësuese.*

Në kërkim të një shpjegimi për këtë gjendje, na rezulton, së pari, se burimi i të ardhurave në gjysmën e dytë të tranzicionit (vitet 2000-2009) është kufizuar kundrejt gjysmës së parë të tij (vitet 1991-1999). Rezulton, së dyti, se qytetarët shqiptarë, siç janë treguar të aftë për të mbi-jetuar gjatë kësaj periudhe të vështirë, janë bërë njëherësh edhe shpërdorues të mëdhenj të parasë e të pasurisë së tyre. Një analizë më e hollësishme e strukturës së shpenzimit të të ardhurave duket se e provon këtë përfundim.

<sup>8</sup>. Por, nga ana tjetër, institucione të ndryshme, vendase apo ndërkombëtare, kanë raportuar nivele më të larta të varfërisë, kundrejt atyre që rezultojnë nga studimi ynë. Sipas të dhënave të publikuara nga UNICEF, për shembull, 39 për qind e popullsisë jeton në varfëri të plotë (UNICEF, 2006). Ky institucion vë alarmin për rritjen e numrit të fëmijëve lypsarë dhe të të varfërve në Shqipëri (pra për rritjen, jo uljen e numrit të të varfërve).

**Tabela 8:** *Vlerësimi mbi nivelin ekonomik të ardhshëm*

| Familja pritët të jetë: | Frekuenca e përgjigjeve |              |
|-------------------------|-------------------------|--------------|
|                         | Në numër                | Në përqindje |
| Më të pasur             | 662                     | 48.5         |
| Pak a shumë njësoj      | 121                     | 8.9          |
| Më të varfër            | 31                      | 2.3          |
| Nuk mund ta vlerësoj    | 550                     | 40.3         |
| Gjithsej                | 1364                    | 100.0        |

Por, çfarë pritët për të ardhmen, lidhur me dinamikën e pasurisë apo, në të kundërt, me dinamikën e varfërisë? Ne kërkuam një vlerësim nga të anketuarit për nivelin e pritshëm ekonomik të familjeve të tyre në një të ardhme të afërt dhe iu referuam vitit 2015. Vlerësimin e të anketuarve e kemi përmbledhur në tabelën 8.

*Bie në sy fakti se rreth ½ e të anketuarve besojnë se niveli ekonomik i familjeve të tyre në 5-6 vitet e ardhshme do të përmirësohet.* Me pesimizëm e shikojnë të ardhmen vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve, 2.3 për qind, të cilët parashikojnë se në vitin 2015 do të jenë më të varfër. Sidoqoftë rreth ½ e të anketuarve nuk ndihen të sigurt për të ardhmen ekonomike të familjeve të tyre. Në këtë kategori kemi përfshirë ata që mendojnë se niveli ekonomik i familjeve të tyre mund të mos ndryshojë, sikurse ata

që nuk janë në gjendje ta parashikojnë ndryshimin (përgjigjja “nuk mund ta vlerësoj”). (Tabela 9).

Nga të dhënat e tabelës del se, përgjithësisht, siguria për nivelin e ardhshëm ekonomik varet nga niveli i sotëm ekonomik i familjeve. Referuar familjeve të pasura, mbi 60 për qind e tyre pohojnë se niveli i tyre ekonomik do të rritet deri në vitin 2015. Megjithatë ¼ e tyre nuk janë të sigurt dhe japin përgjigjen “nuk mund ta parashikoj”.

Kur kalon në zbritje, sipas nivelit të sotëm ekonomik, bie në mënyrë disi drastike besimi për rritjen e nivelit ekonomik në të ardhmen. *Përkundrazi, kur kalon në zbritje sipas nivelit të sotëm ekonomik, rritet pasiguria për nivelin e ardhshëm ekonomik.* Kjo dinamikë e pritshmërisë për nivelin ekonomik qartësohet më tej nëse e analizojmë atë në raport me burimin e të

**Tabela 9:** *Pritmëria e gjendjes ekonomike të familjeve, sipas nivelit të sotëm ekonomik (Në përqindje)*

| Niveli i sotëm ekonomik | Pritmëria mbi nivelin ekonomik të vitit 2015 |                    |              |                          | Gjithsej |
|-------------------------|----------------------------------------------|--------------------|--------------|--------------------------|----------|
|                         | Më të pasur                                  | Pak a shumë njësoj | Më të varfër | Nuk mund ta parashikojnë |          |
| E pasur                 | 62.2                                         | 13.3               | =            | 24.5                     | 100.0    |
| E mesme                 | 55.0                                         | 7.6                | 1.5          | 35.9                     | 100.0    |
| E varfër                | 30.0                                         | 13.6               | 5.0          | 51.4                     | 100.0    |
| Shumë e varfër          | 13.4                                         | 8.5                | 6.1          | 72.0                     | 100.0    |

<sup>12</sup> Dione, Jr., As kapitalistë, as socialistë, The Washington Post, 2009.04. 02.

**Tabela 10:** *Burimi kryesor i të ardhurave të familjeve*

| Burimi kryesor i të ardhurave:         | Frekuenca e përgjigjeve |              |
|----------------------------------------|-------------------------|--------------|
|                                        | Në numër                | Në përqindje |
| Nga punësimet                          | 751                     | 56.9         |
| Aktiviteti bujqësor                    | 127                     | 9.6          |
| Ndihma ekonomike                       | 68                      | 5.2          |
| Pensionet                              | 81                      | 6.1          |
| Sipërmarrja private (biznesi)          | 183                     | 13.9         |
| Ndihma nga të afërm                    | 9                       | 0.7          |
| Ndihmë nga familjarë që janë emigrantë | 67                      | 5.1          |
| Nga prona                              | 8                       | 0.6          |
| Burime të tjera                        | 25                      | 1.9          |
| Gjithsej                               | 1319                    | 100.0        |

ardhurave (shih më poshtë). Tani për tani, mund të arrijmë në përfundimin se afërsisht edhe ata që e konsiderojnë veten si familje të mesme, nuk janë shumë larg pragut të shndërrimit në familje me të ardhura të ulëta apo të varfër. Kjo sepse vetëm diçka më shumë se gjysma e tyre pohojnë qartësisht se niveli ekonomik i familjeve të tyre pritet të rritet. Nga pjesa që mbetet, rreth 35 për qind, janë të pasigurt për gjendjen e tyre të ardhshme ekonomike.

Nga një përlogaritje e përafërt del se pasuria që disponojnë shqiptarët justifikohet me strukturën e të ardhurave të tyre vetëm në një masë që shkon diku në rreth 50 për qind. (Tabela 10).

Siç shihet nga tabela 10, rreth 57 për qind e të anketuarve shprehen se burimi kryesor i të ardhurave të familjeve të tyre është punësimi. Por, sidoqoftë, punësimet në Shqipëri janë relativisht të paqëndrueshme. Kjo lidhet me veçoritë e tregut të punës, natyrën dhe strukturën e sipërmarrjeve (bizneseve), llojshmërinë e sipërmarrjeve të të njëjtit lloj dhe pasigurinë e investimeve, arbitraritetin e punëdhënësve, nivelin shumë të ulët të organizimit sindikal dhe të institucioneve që monitorojnë respektimin e të drejtave

të punëmarrësve, lëvizjet e shumta në administratën publike etj., etj.

Në tabelën 10 ka edhe të dhëna të tjera domethënëse, ndër të cilat veçojmë të ardhurat nga prona, që çuditërisht konsiderohen si mjaft të ulëta. Këtej mund të nxirren përfundime të rëndësishme, një ndër të cilët është edhe “tundshmëria” e të ardhurave të pabazuara në pasuri të patundshme.

### **Prirja: sa më shumë rritet pasuria, aq më shumë rritet diferencimi social**

Referuar të ashtuquajturës “dinamika e varfërisë”, që e analizuam më sipër, vihet re qartësisht një prirje e tillë: *sa më shumë rritet pasuria me kalimin e viteve, aq më shumë rritet edhe hendeku midis nivelit të pasurisë së familjeve të pasura kundrejt familjeve të varfra dhe shumë të varfra*. Tetë nga dhjetë përfaqësuesit e familjeve të pasura që ishin në përbërje të kampionit tonë të studimit kanë pohuar se ato janë më të pasura se dhjetë vjet më parë. Nëse u referohemi familjeve të varfra dhe shumë të varfra, del se në këtë kategori bëjnë pjesë respektivisht vetëm rreth një e katërta dhe një e dhjeta e familjeve (tabela 11).

**Tabela 11:** *Niveli ekonomik kundrejt dhjetë vjetëve më parë, sipas shkallës së pasurisë*

| Niveli i sotëm ekonomik i familjes | Kundrejt dhjetë vjetëve më parë, ekonomikisht familjet janë: |                           |              | Gjithsej |
|------------------------------------|--------------------------------------------------------------|---------------------------|--------------|----------|
|                                    | Më të pasura                                                 | Pak a shumë siç kanë qenë | Më të varfra |          |
| E pasur                            | 80.1                                                         | 19.9                      | =            | 100.0    |
| E mesme                            | 58.3                                                         | 36.3                      | 5.4          | 100.0    |
| E varfër                           | 27.5                                                         | 57.3                      | 15.2         | 100.0    |
| Shumë e varfër                     | 9.8                                                          | 50.5                      | 39.4         | 100.0    |

Mendojmë se ka ardhur koha që të operohet me stimuj të diferencuar (asistencë, nxitës fiskalë etj.) për familjet e varfra e shumë të varfra, kundrejt familjeve të pasura. Kjo bëhet më e evidente nëse krahasojmë përvojën shqiptare me atë të vendeve të tjera të Lindjes europiane. Në terma më të thjeshtë, këto të dhëna *sugjerojnë zbutjen e kapitalizmit “të egër” shqiptar, zhvillimin e biznesit social, politika më të studiuara për harmonizimin e interesave midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe vendosjen e ekuilibrit socialë*, pa dobësuar stimulimin e prodhimit dhe pa frenuar aspak zhvillimin ekonomik.

### **Reduktimi i varfërisë: individi, shteti apo tregu?**

Çështja e fundit që do të trajtojmë në këtë punim lidhet natyrshëm me py-

etjen: si mund të reduktohet varfëria, cilët janë faktorët dhe subjektet që ndikojnë më shumë në reduktimin e saj? Pyetja që u drejtuam individëve të përfshirë në këtë sondazh ishte: sipas jush, zhdukja e varfërisë në Shqipëri varet më shumë nga vetë individët (1), shteti/qeverisja (2), tregu/sipërmarrja private (3) apo nga faktorë të tjerë, si integrimi, emigracioni i organizuar etj.? Të dhënat e siguruar janë pasqyruar në tabelën 12.

Siç shihet, të anketuarit e shikojnë reduktimin dhe zhdukjen e varfërisë para së gjithash si një problem të lidhur me shtetin, qeverisjen dhe cilësinë e saj. Këtë kanë përzgjedhur si alternativë përgjigjeje plot 63 për qind e të anketuarve. Rreth 22 për qind e tyre pohojnë se, pas qeverisjes, faktori me ndikim më të madh në reduktimin e varfërisë është vetë individi.

**Tabela 12:** *Individi, shteti apo tregu; roli kryesor në reduktimin e varfërisë*

| Reduktimi i varfërisë varet më shumë nga: | Frekuenca e përgjigjeve |              |
|-------------------------------------------|-------------------------|--------------|
|                                           | Në numër                | Në përqindje |
| Vetë individët                            | 292                     | 21.8         |
| Qeverisja/shteti                          | 846                     | 63.3         |
| Tregu/sipërmarrja private                 | 36                      | 2.7          |
| Integrimi europian                        | 95                      | 7.1          |
| Emigracioni i organizuar                  | 43                      | 3.2          |
| Të tjera                                  | 25                      | 1.9          |
| Gjithsej                                  | 1337                    | 100.0        |

## Disa përfundime e rekomandime

Nga lartësia e njëzet vjetëve të “epokës demokratike” mund të thuhet se disnivelet ndërmjet vendeve ish-komuniste janë kush-tëzuar ndjeshëm nga “starti i pabarabartë”, si për nga niveli i zhvillimit, ashtu edhe për nga niveli i reformimit ose shkalla e demokratizimit paraprak. Kjo do të thotë se Shqipëria *objektivisht do ta kishte më të vështirë për ta marrë kthesën drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut*, kundrejt vendeve të tjera.

Veç faktorëve objektivë, në distancimin e Shqipërisë nga vendet e tjera kanë ndikuar edhe faktorë të rendit subjektiv apo “faktorë të vullnetit”, ku veçojmë – duke folur në gjuhën e Brzezinskut - faktin se sjellja dhe angazhimi i liderëve drejt një demokracie pluraliste ka qenë e vazhdon të jetë problematike.

Nga krahasimi i GDP për frymë të popullsisë Perëndim-Lindje rezulton një raport afërsisht 4 me 1. Shqipëria ka GDP-në për frymë rreth 2.7 herë më të vogël kundrejt mesatares së vendeve ish-komuniste. Pra, na duhen ritme të tjera zhvillimi.

Diferencimi ekonomik e social në Shqipëri, kundrejt vendeve të tjera të Lindjes europiane është shumë i theksuar. Ndaj duhen politika më të studiuar për rritjen harmonike të nivelit të jetesës në shtresa të ndryshme të popullsisë, duke përfshirë ndoshta edhe një rishikim të modeleve të vendosura, siç është “taksa e sheshtë”.

Rezulton se përqindja e familjeve që

jetojnë më mirë se dhjetë vjet më parë është 6.2 herë më e madhe se pjesa e familjeve niveli ekonomik i të cilave në këto dhjetë vjet është ulur. Por, rreth ½ e të anketuarve pohojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi se në dhjetë vjet niveli ekonomik i familjeve të tyre thuhet nuk ka ndryshuar. Ky “stanjacion” i gjysmës së popullsisë përfaqëson një të dhënë shqetësuese.

Nga sondazhi mbi burimin e të ardhurave, del se pasuria që disponojnë shqiptarët justifikohet me strukturën e të ardhurave të tyre vetëm në një masë që shkon në rreth 50 për qind. Kjo do të thotë se formalizimi i ekonomisë kërkon ndërhyrje emergjente.

Rreth ½ e të anketuarve besojnë se niveli ekonomik i familjeve të tyre në 5-6 vitet e ardhshme do të përmirësohet. Por konstatohet qartësisht prirja se sa më shumë rritet pasuria me kalimin e viteve, aq më shumë rritet edhe hendeku midis nivelit të pasurisë së familjeve të pasura kundrejt familjeve të varfra dhe shumë të varfra. Ndaj mund të operohet me stimuj të diferencuar, në raport me nivelin ekonomik të familjeve.

Të dhënat sugjerojnë nevojën e ndërhyrjeve të studiuar për zbutjen e kapitalizmit “të egër” shqiptar, zhvillimin e biznesit “social”, politika më të studiuar për harmonizimin e interesave midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe vendosjen e ekuilibrave socialë, pa dobësuar stimulimin e prodhimit dhe pa frenuar aspak zhvillimin ekonomik.

# NGA IDEOLOGJIA NË UTOPI: RIGJALLËRIMI I DEMOKRACISË NË SHQIPËRI

Enis SULSTAROVA - *Fakulteti i Shkencave Sociale,  
Universiteti i Tiranës; Instituti i Sociologjisë*

---

*Intelektuali është i dënuar të mposhtet. Në këtë aspekt ai i ngjan Sizifit. Gjithmonë ka diçka të dyshimtë tek intelektualët që qëndrojnë në krahun fitimtar. Megjithatë, në një kuptim më të thellë, intelektualit mbetet, pavarësisht të gjitha humbjeve të tij, i pamposhtur – përsëri si Sizifi.*  
Vaslav Havel (1990: 167)

*Numri i njerëzve që nuk krijojnë asnjë vlerë po rritet. Ata janë vetëm këshilltarë, specialistë të marrëdhënieve me publikun. Nuk e di nëse qytetërimi me vullnetin e tij do të vijë në vete pa ndodhur tërmete apo cuname të stërmëdha.*  
Vaslav Havel (cit. te Matynia, 2009: 255)

Kanë kaluar njëzetë vjet që nga rënia e Murit të Berlinit dhe pothuaj po aq që prej vendosjes zyrtare të pluralizmit politik në Shqipëri. Është e pashmangshme që të bëhet një bilanc midis shpresave të atëhershme për demokracinë dhe realiteteve të zhvillimit të saj në vendet ish-komuniste. Është më se e natyrshme që realiteti konkret të dallojë prej ideve të demokracisë, por gjithsesi janë idetë demokratike ato që orien-

tojnë apo duhet të orientojnë zhvillimet konkrete, përndryshe nuk mund të këtë “zhvillim” demokratik në kuptimin e vetë fjalës. Sot në Shqipëri duket sikur demokracia konkrete i ka shpenzuar fuqitë e veta, sikur nuk i ka justifikuar shpresat e lëvizjes së viteve 1990-1991. Kemi një parlament të refuzuar nga opozita si jolegjitim, i cili megjithatë miraton ligje dhe gjithmonë e më shumë njerëz po e perceptojnë politikën shqiptare si një lojë

**Enis Sulstarova** është anëtar themelues i Institutit të Sociologjisë dhe anëtar i bordit akademik të tij. Ka kryer studimet universitare e pasuniversitare në degën e sociologjisë në Ankara. Është autor i shumë artikujve studimorë, si dhe i librave: *Ligjërimi nacionalist në Shqipëri* e *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Është pedagog në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

të interesave private dhe mesquine dhe jo si një praktikë demokratike në shërbim të interesave të popullit, sido që t'i përkufizojmë këto të fundit. Është e vërtetë se demokracia është “the only game in town”, mirëpo abstenimi gjithmonë e më shumë i qytetarëve nga pjesëmarrja në politikën partiake dhe shoqërinë civile dhe kthimi i tyre thjesht në spektatorë të politikës, nuk është diçka pozitive për një demokraci të shëndoshë në vend. Me fjalë të tjera, ajo që nevojitet është rigjallërimi i demokracisë dhe kjo mund të bëhet duke u kthyer për nga idetë demokratike, duke rimarrë shpresat dhe utopitë e artikuluara para njëzet vjetëve dhe për t'i përdorur për thellimin dhe zgjerimin e demokracisë në vend.

Një përpjekje modeste do ta bëjmë në këtë artikull për të treguar një rrugë teorike drejt këtij qëllimi. Ajo që vijon më poshtë është shkruar nën hijen e sociologut Karl Manhajm [Karl Mannheim] në antagonizmin që ai vendos midis utopisë dhe ideologjisë. Shkurtimisht, ai me “ideologji” kupton një botëkuptim që e legjitimon të tashmen duke iu referuar së shkuarës. Ideologjia propagandohet nga të pushtetshmit që duan të ruajnë statuskuonë. Ndryshe nga ideologjia, “utopia”, thotë Manhajmi, është një botëkuptim që kërkon të ndryshojë të tashmen duke iu referuar së ardhmes. Zakonisht utopitë përvijohen nga ata që duan ndryshime shoqërore apo rivolucione (Mannheim, 1930).

Nuk duhet të gënjehemi nga shfaqjet sipërfaqësore. Në Shqipëri forcat politike kryesore shpallin në fushata elektorale aspirata utopike të drejtuara nga e ardhmja: “koha për ndryshim”, “Shqipëria po ndryshon”, “Së bashku për ndryshim”, “Ndryshimi jemi ne”, mirëpo “ndryshimi” është i zbrazët nga përmbajtja dhe gjithçka që ndryshon janë vetëm ekipet qeveritare që zëvendësojnë njëri-tjetrin. “Ndryshimi” që gjoja kryhet me anë të votës po

kthehet në një ideologji, por që demokracia të jetë vërtetë utopi, duhet që realisht të jetë shprehëse e aspiratave të atyre shtrësave dhe kategorive shoqërore që e shikojnë veten të përjashtuara nga sistemi i tanishëm shoqëror, i emërtuar si “demokratik” dhe që duan që shumë gjëra realisht t'i ndryshojnë. Me fjalët e Maks Veberit, duhet që sërish fjala “demokraci” të arrijë magjepsjen e politikës dhe të frymëzojë qytetarët për t'u përfshirë në lëvizje të gjëra shoqërore.

Këtë artikullim utopik të “demokracisë” mund ta bëjnë intelektualët, të cilët Manhajmi i shikon si një grup shoqëror relativisht të shkëputur dhe të palidhur me ndonjë shtresë të caktuar shoqërore. Në këtë pikë të shtjellimit tonë me doemos na duhet të hyjmë te sfera e sociologjisë së intelektualëve.

Ka tri qasje klasike ndaj pozicionimit shoqëror të intelektualëve, të cilat riprodhohen edhe në teoritë bashkëkohore sociologjike. Qasja e parë i koncepton intelektualët si një klasë apo grupim i veçantë në shoqëri. Dokumenti përfaqësues i kësaj qasjeje është libri i shkrimtarit francez Zhyljen Bendës [Julien Benda] *La Trahison des clerks* (1927), që mund ta shqipërojmë si *Tradhtia e intelektualëve*. Tradhtia e intelektualëve, që përmend Benda, ka të bëjë me përfshirjen e tyre në politikën e ditës dhe me angazhimin e tyre në mbrojtje të interesave sektoriale, qofshin këto të fundit kombëtare, klasore apo racore, në kohën kur intelektualët duhet të përbënin një korporatë të veçuar, që nderon vetëm kultin e drejtësisë dhe të së vërtetës (Kurzman & Owens, 2002: 65-66).

Qasja e dytë i sheh intelektualët të lidhur me interesa të një klase të caktuar shoqërore dhe përfaqësuese klasike të saj janë shënimet e burgut të Antonio Gramshit në vitet 20-30. Sipas këtij teoricieni të njohur marksist italian, intelektualët nuk mund të konceptohet të veçuar nga

prodhimi dhe marrëdhëniet klasore. Kështu, borgjezia ka intelektualët e vet dhe po kështu proletariati duhet të ketë intelektualët e tij. Prej këndej rrjedh edhe terminologjia e tij e “intelektualëve organikë” (po aty: 66-67).

Ndërsa libri i vetë Manhajmit *Ideologjia dhe utopia* (1936) është dokument i qasjes së tretë klasike të sociologjisë së intelektualëve, asaj që i koncepton ata si të palidhur me ndonjë klasë shoqërore. Sipas tij, arsimi universal i intelektualëve i pengon ata që ta njësijnë veten (plotësisht) me interesat e kundërta të grupeve shoqërore. Edhe kur ata veprojnë nisur prej interesave apo botëkuptimit të një grupi të caktuar, kumtet e tyre i drejtohen të gjithë shoqërisë, për nga vetë nevoja e tyre për të sintetizuar mendimet dhe për të pasur një këndvështrim të gjerë për problemet shoqërore. Gjithsesi ata asnjëherë nuk mund të formojnë një klasë të veçantë nga pjesa tjetër e popullit dhe ata i kapërcejnë kufizimet e klasës apo shtresës shoqërore nga vijnë (po aty: 67-68).

Asnjëra nga të tri qasjet nuk e ka thënë fjalën e fundit për të shpjeguar sjelljen reale të intelektualëve, mirëpo mendojmë se, në rrafshin normativ, ajo për të cilën kemi nevojë tani është pikërisht tipi i intelektualit për të cilin flet Manhajmi. Pra, jo intelektualë të mbyllur në kullën e fildishtë të interesave të tyre si studiues apo akademikë dhe as intelektualë megafonë të interesave të pushtetit politik dhe atij ekonomik, por intelektualë që, duke u nisur nga gjendja e përgjithshme e qytetarit shqiptar sot, veçanërisht të atyre që janë dhe ndihen të përjashtuar nga sistemi, të mund ta artikulojnë sërish demokracinë si një utopi për t'u realizuar në të ardhmen për të gjithë shoqërinë. Vetëm kështu mund të motivohen qytetarët për ta bërë vetë ndryshimin e vërtetë.

Këtu nuk mund të japim receta të gatshme se si duhet realizuar kjo gjë, por ajo që mund të bëjmë është të që ofrojmë

një analogji, pikërisht nga lëvizja e intelektualëve disidentë para dhe gjatë shndërrimeve demokratike në shtetet e Europës Qendrore. Ishte një lëvizje për “demokraci”, fjalë me të cilën kërkohej ndryshimi i sistemit dhe ndërtimi i një shoqërie, diçka që i afrohet përdorimit të “utopisë” nga Manhajmi. I mëshojmë fjalës “analogji”, sepse kushtet ku disidentët vepruan ishin të ndryshme dhe të pakrahasueshme me Shqipërinë staliniste, por edhe për vetë faktin se ndikimi i ideve të tyre ka qenë pothuaj i padukshëm në lëvizjen demokratike shqiptare të viteve 1990-1991. Siç e vëren me shumë të drejtë Fatos Lubonja në fjalën e mbajtur me rastin e 20-vjetorit të rënies së Murit të Berlinit, në Shqipëri lëvizja demokratike nuk u udhëhoq nga kurrfarë disidence intelektuale, sepse thjesht nuk ekzistonin kushtet objektive që kjo disidencë të krijohet. Përveç Murit të Berlinit ekzistonte edhe Muri i Tiranës, që na ndante edhe nga Europa Lindore revizioniste (Lubonja, 2009). Kemi të bëjmë, si të thuash, me dy botë të shkëputura, pavarësisht se në të dyja, në fazën masive të lëvizjeve në vitet 1989-1990, ngriheshin dy gishta lart dhe kërkohej me forcë “demokracia”. Duket se ndikimi në Shqipëri ka qenë më shumë mediatik, prej imazheve të turmave që çanin Murin e Berlinit, sesa në rrafshin e ideve intelektuale. Edhe sot nuk kemi në shqip librat apo shkrimet politike të disidentëve kryesorë të asaj kohe, megjithëse emrat ua njohim më mirë si heronj të revolucioneve të vitit 1989, sikurse është rasti me Vaslav Havelin. Së dyti, e kemi fjalën për analogji, sepse utopia demokratike duhet të shohë për nga e ardhmja, ndoshta duke përshtatur për kontekstin shqiptar terminologji të njohura apo të përkthyer nga gjuhë të tjera, por gjithmonë për diçka që pritet apo që do të realizohet në të ardhmen.

Në retrospektivë, mund të flasim për një fazë përgatitëse dhe intelektuale të rev-

olucioneve të vitit 1989. Me zbutjen e totalitarizmit dhe me krijimin e asaj që Haveli e quante periudha pastotalitare në Europën Lindore (Havel, 1989: 37-41), u krijua hapësira e disidencës, e atyre intelektualëve që kundërshtonin paqësisht ideologjinë zyrtare dhe bindjen e përgjithshme dhe pasive të qytetarëve ndaj saj. Edhe pa pasur ndonjë shpresë për përmbyjsjen e shpejtë të regjimeve komuniste apo strategji të qartë politike, ata prapëseprapë kundërshtonin gënjeshtërinë e sistemit dhe pranimin e saj pasiv nga qytetarët. Ata kërkonin para së gjithash një ringritje morale të popullit, atë që Haveli në Çekosllovakia e quante “jetesa brenda së vërtetës”, përballë “jetesës brenda gënjeshtëtrës” së regjimit komunist. Metodot e tyre nuk ishin të dhunshme, por taktika të refuzimit dhe mosbindjes së vazhdueshme ndaj regjimit dhe të pohimit të aspekteve të jetës së çliruar nga ndrydhja e sistemit, diçka kjo që në Hungari Georg Konrad e quante “politika e kundërpolitikës”. Ata fillimisht nuk pretendonin të krijojnë lëvizje masive, kjo ishte krejt e pamundur nën regjimet komuniste. Mirëpo me anë të shkrimeve që qarkullonin fshehurazi, *samizdateve*, ku përdorej një gjuhë me shumë kuptimeve, ata synonin që të kapnin vëmendjen e lexuesve inteligjentë dhe të tronditnin tek ata topitjen e intelektit për t'i bërë ata që t'i shihnin gjërat ndryshe. Siç shkruante Haveli më 1978, jetesa brenda gënjeshtëtrës, pra bindja e jashtme ndaj sistemit, nuk do të thotë që gënjeshtëra është patjetër e përbrendësuar nga qytetarët, por prapëseprapë sjellja e tyre pranuese është ajo që e plotëson sistemin. Prandaj duhet dikush që të thërrasë se “perandori është i zhveshur”, në mënyrë që gjithçka të duket nën një dritë tjetër (Havel, 1989: 59-60). Disidentët vepronin në dukje brenda hapësirës ligjore të garantuar nga ligjet dhe traktatet ndërkombëtare dhe guximi i tyre për t'i shfrytëzuar në maksimum këto të drejta, të cilat regjimet

komuniste të Europës Lindore i kishin miratuar formalisht me anë të nënshkrimit të Kartës së Helsinkit, u jepte disidentëve një forcë morale (Tomash, 1997: 19).

Revolucionet e vitit 1989 shpeshherë interpretohen, nga pikëpamja liberale, thjesht si një dëshirë për të (ri)vendosur në shtetet e Europës Lindore sistemin liberal-demokratik, d.m.th. si imitim të asaj që ishte bërë realitet në Perëndim. Për këtë arsye, disa e kanë parë kontributin e këtyre revolucioneve thjesht si konfirmim të ideve të njohura liberal-demokratike. Me fjalë të tjera, ata nuk kanë vërejtur ndonjë përmasë utopike në shkrimet e disidentëve. Mirëpo lexime më të imta të teksteve të intelektualëve disidentë tregojnë se ata nuk kërkonin thjesht vendosjen e një regjimi demokratik që do të respektonte të drejtat njerëzore, por njëkohësisht prireshin për nga alternativa më radikale ndaj demokracisë liberale (Blokker, 2009). Siç vëren edhe studiuesja Barbara Falk, megjithëse shkrimet e disidentëve europianolindorë mund të klasifikohen si liberale,

...aspekte të tjera të *oeuvre*-s disidente gjenerojnë tension me përshkrimin liberal, si p.sh. konceptimi radikal kundërpolitik i shoqërisë civile; nocioni i një politike të moralshme, autenticiteti dhe subjektiviteti aktiv; etosi i solidaritetit shoqëror; implikimet për pjesëmarrje që rrjedhin nga kuptimi havelian i përgjegjësisë politike; si dhe një ripercaktim më i gjerë i vetë politikës (Falk, 2003: 339).

Për disidentët, demokratizimi nuk ishte vetëm përfaqësimi i qytetarëve në instancat e pushtetit, por përfshirja e tyre aktive në ushtrimin e pushtetit. Nëse tradita liberale e shihte shoqërinë civile si një kompensim ndaj shtetit të dobësuar dhe, për pasojë, si një mekanizëm që do të garantonte bindjen dhe rendin politik pa pasur nevojë për shtrëngim, koncepti disident i shoqërisë civile drejtohej kundër

shtetit dhe rendit ekzistues, duke u kthyer në një ide kundërpolitike (Tomash, 1997: 23). Për shembull, në konceptimin e Havelit, subjekti autentik nuk mund të kuptohet pa përgjegjësinë publike dhe politike të tij. Në mënyrë paradoksale, kjo do të thoshte një arratisje nga politika zyrtare dhe ceremoniale komuniste. Nëse në emër të universales ushtrohej shtypja, atëherë privatja, intima, joheroikja përfaqësonte lirinë në sytë e disidentëve. Siç e thotë njëri nga pjesëmarrësit në disidencën hungareze, “arratisja nga politika... është një nga variantet historike më të rëndësishme të aspiratës për liri” (Tomash, 1997: 46). Ndërsa Haveli, në një shoqëri ku gjithçka quhej socialiste dhe të ishte socialist nënkuptonte vetëm bindje ndaj pushtetit socialist, bënte thirrje që fjalës “socialist” t’i jepej kuptimi i dikurshëm: i veprimtarit apo intelektualit që është në anën e të shtypurve dhe të të munduarve (Havel, 1990: 9-10).

Kritika disidente ishte universaliste dhe nuk kursente as demokracitë e Perëndimit. Kështu, Haveli qysh më 1978 shkruante se edhe sistemet demokratike kanë rënë pre e automatizmit të shoqërisë teknologjike dhe konsumiste:

Në demokraci, qeniet njerëzore mund të gëzojnë shumë liri dhe siguri vetjake që ne [në Europën Lindore] nuk i njohim, por në fund të fundit ato nuk u hyjnë në punë, sepse edhe ato janë viktimat të të njëjtit automatizim dhe janë të paafta për të mbrojtur interesat e tyre në lidhje me identitetin, të parandalojnë sipërfaqësimin e tyre apo të kapërcejnë shqetësimin e tyre me mbi-jetesën vetjake dhe të bëhen anëtarë krenarë dhe përgjegjës të *polis*-it dhe për të dhënë një ndihmesë origjinale në krijimin e fatit të tij (Havel, 1989: 116).

Kjo do të thoshte se edhe shoqëritë demokratike dhe kapitaliste vuanin nga kriza morale. Individit në to është shpirtër-

isht i cekët, si pasojë e mbizotërimit të konsumerizmit si vlerë e epërme. Ai është i veçuar në anonimitetin që krijon tregu dhe si i tillë nuk mund të ketë një ndjenjë më të lartë përgjegjësie se sa thjesht mbi-jetesa vetjake (Sulstarova, 2003: 81).

Zgjidhja, sipas tij, do të ishte utopia e një përvoje të re të qenies njerëzore, një rrënjësim i saj i ri në univers, që do ta pajiste më një sens të ri të përgjegjësisë ndaj të gjithë botës, në një marrëdhënie më të ngushtë me njerëzit e tjerë dhe me njerëzimin: “këta faktorë tregojnë qartë drejtimin që duhet të marrim” (po aty: 117). Në rrafshin e politikës, kjo do të thotë se duhet të krijohen struktura publike të tilla që të bëjnë të mundur rehabilitimin e vlerave të përbashkëta të njerëzimit, si mirëbesimi, sinqeriteti, përgjegjësia, solidariteti. Duke qenë se për këtë utopi atij i dukej i konsumuar termi “demokraci”, Haveli përdori termin “pas-demokraci” (po aty: 120), po në atë mënyrë që përdorte edhe termin pastotalitarizëm për të përshkruar gjendjen e Çekoslovakisë pas Pranverës së Pragës dhe ndërhyrjes sovjetike kundër saj. Utopia e tij është demokracia, por përtej përfaqësimit politik, demokracia e kuptuar si një mënyrë jetese, si një qëndrim etik ndaj vetes, tjetrit, njerëzimit dhe gjithë botës.

A u realizuar kjo utopi në Çekoslovakia dhe në vendet e tjera të Europës Lindore pas vitit 1989? Njëzet vjet më pas, ish-disidentët Adam Miçniku nga Polonia dhe Haveli, ky i fundit edhe ish-president i Çekisë, diskutojmë mbi mundësitë politike dhe shoqërore që u hapën nga revolucionet e Europës Lindore, por që nuk u realizuan. Të dy mendojnë se bota po përjeton një “degradim progresiv” të klasës politike dhe shoqërive moderne në përgjithësi, po në të njëjtën kohë kur në shumë pjesë të saj po kalohet nga diktatura në demokraci. Pyetjes së Miçnikut se ç’duhet bërë në këtë gjendje, Haveli i përgjigjet me shpresën të revolucionit ekz-

istencial dhe ndryshimi i mendësisë së njerëzve. Alternativat nga e majta dhe e djathta po u ngjajnë pluhurave larës në treg: në të gjitha etiketat e tyre lexohet “i ri/e re”, por ti nuk e di se çfarë ka ndryshe secili. Ndryshimi i vërtetë duhet të vijë nga vetë angazhimi i qytetarëve në shoqërinë civile për probleme që shqetësojnë njerëzimin. Mbi të gjitha dëshira për ndryshim nuk duhet të mbetet një ëndërr vetëm e intelektualëve, por duhet të dëshirohet nga e tërë shoqëria (Havel, cit. te Matynia, 2009: 258-259).

Le të kthehemi në situatën e sotme në Shqipëri. Cila janë gjasat për një lëvizje të demokracisë nga ideologjia drejt utopisë? Këtu thjesht mund të përmendim disa zhvillimeve që, për mendimin tonë, çojnë te nevoja për utopinë dhe disa zhvillime të tjera që dobësojnë shanset për gjenerimin e kësaj utopie. Së pari, kriza e përgjithshme ekonomike botërore ka nxjerrë në dukje nevojën për të reformuar shumëçka në sistemin e tanishëm ekonomik dhe politik. Çmimi Nobel që iu dha presidentit amerikan pas vetëm një viti të marrjes së detyrës, tregon se shumëkush kërkon të kapet pas çdo shenje optimiste që diçka do të ndryshojë për mirë në mbarë botën. Kjo frymë, që shikon nga e ardhmja, patjetër që do të ndikojë edhe në Shqipëri. Së dyti, elitës politike shqiptare i janë shterur energjitë dhe nuk pritet që ajo të gjenerojë vizione domethënëse për të ardhmen, prandaj pritet që alternativa të artikulohej në shoqërinë civile (e cila duhet thënë se, nga ana e saj, vuan nga të meta të rënda strukturore). Së treti, kthimi në Shqipëri i të arsimuarve në Perëndim dhe krijimi i qendrave të reja universitare pritet që t’u japë një frymëmarrje të re debateve publike. Së katërti, që ndoshta është më e rëndësishmja, shumë grupe shoqërore të mënjanuara, pikësëpari periferitë e qendrave të mëdha urbane, po fillojnë të vetëdijeshohen dhe të kërkojnë përfshirje dhe afirmim

më të madh në jetën e vendit. Deri tani periferitë informale urbane në Tiranë, Durrës, etj., kanë qenë rezerva njerëzore e partive populiste, gjithmonë të gatshme për një “demokraci anarkike të rrugës” dhe për t’u bërë klientë të udhëheqësve partiakë, por nuk është e thënë se do të vazhdojë gjithmonë kështu. Mirëpo, që ata dhe kategori të tjera të mënjanuara të kthehen në një forcë për ndryshim, duhet që të orientohej për nga utopia demokratike që do të vijë.

Në krahun pesimist, përmendim përhapjen e konsumerizmit masiv dhe apatinë e brezit të ri, që duket se është i dhënë pas modeleve hedoniste të masmediave. Megjithatë, mospërputhja midis botës virtuale të argëtimit pa mbarim e pa fre dhe kokëfortësisë së realiteteve konkrete shoqërore, me problematikat e tyre që kërkojnë zgjidhje, do të bëjë që shumë të rinj të jenë një forcë e ndryshimit dhe të gatshëm për ndërtimin e utopisë së re demokratike.

Për sa i përket elitës kulturore, një zhvillim tjetër negativ i viteve të fundit ka qenë uzurpimi i rolit të intelektualit publik nga analisti i mediave. Ky i fundit, për nga vetë strukturimi i rolit të tij publik, duket se më shumë i shërben ruajtjes së sistemit se sa ndryshimit të tij. Ngritja e analistit shoqërohet me rënien e intelektualit publik; megjithëse ata të dy luajnë pothuajse të njëjtin rol, efektet që krijojnë janë të kundërta. Nëse intelektual publik është dikush që bën lidhjen e dukurive që në pamje të parë duken si të palidhura, pra po të përdorim shprehjen e Habermasit, intelektualit ka “intuitën pararojë për relevancat”, në krahun tjetër, analisti përdor klishtë, analizën sipërfaqësore, personalizimin e politikës, fragmentarizimin e dukurive të ndërlikuara. Nëse intelektual ideal publik është ai që bën kritikën e sistemit dhe ofron alternativa të tjera, analisti, megjithëse aspiro për

rolin e intelektualit, kritikën e zhvillon në funksion të ruajtjes së sistemit (Pula, 2006; Kajsiu, 2009).

Lindja e një utopie është diçka e vështirë. Utopia është e tillë sepse sheh jashtë sistemit, prandaj kemi nevojë për një disidencë intelektuale ndaj demokracisë ideologjike të tanishme. Nëse para gati njëzet vjetëve u kryen shndërrimet demokratike në vend pa u paraprirë nga mendimi disident, tani kemi nevojë që në

Shqipëri të zhvillojmë një mendim disident në demokraci. Mos po kërkojmë shumë nga intelektualët? A janë ata qenie të afta për të mbajtur këtë barrë që duam t'u vëmë mbi shpinë? Gjatë njëzet vjetëve a nuk kanë dështuar para tundimit të parasë dhe pushtetit shumë prej atyre që shpresonim se kishin vlera të larta morale dhe intelektuale? Mirëpo, nëse nuk shpresojmë te intelektualët si një forcë për ndryshim, ku të shpresojmë tjetër?

## BURIMET

- Blokker, P. (2009) "Democracy through the Lens of 1989: Liberal Triumph or Radical Turn?", *International Journal of Politics, Culture and Society*, 22: 273-290.
- Falk, B. J. (2003) *The Dilemmas of Dissidence in East-Central Europe: Citizen Intellectuals and Philosopher Kings*. Budapest: CEU Press.
- Havel, V. (1989) *Vaclav Havel, Living in Truth*. London; Boston: Faber & Faber.
- Havel, V. (1990) *Disturbing the Peace: A Conversation with Karel Huizdala*. New York: Alfred A. Knopf.
- Kajsiu, B. (2009) "Lindja e analistit dhe vdekja e intelektualit", *Panorama*, Tiranë, 20.10.2009.
- Kurzman, C. & Owens, L. (2002) "The Sociology of Intellectuals", *Annual Review of Sociology*, 28: 63-90.
- Lubonja, F. (2009) "Muri i Berlinit dhe Muri i Tiranës", *Korrieri*, Tiranë, 09.12.2009.
- Mannheim, K. (1936) *Ideology and Utopia*. New York: Hartcourt, Brace & World.
- Matynia, E. (2009) "Twenty Years Later: A Call for Existential Revolution: Vaclav Havel in Conversation to Adam Michnik", *International Journal of Politics, Culture and Society*, 22: 255-262.
- Pula, B. (2006) "Analiza e analistëve: Shënime për një sociologji kritike të rolit të analistit", *Polis*, 2: 47-52
- Sulstarova, E. (2003) "Politika dhe morali: Shembulli i Vaslav Havelit", *Politika & Shoqëria*, 6 (2): 77-84.
- Tomash, G. M. (1997) "Trashëgimia e disidencës"; "Përsiatje për shoqërinë civile", në Tomash, G. M., Feher, F. & Heler, A. *Filozofia dhe tranzicioni: Ese të zgjedhura*. Tiranë: Arbri & Fondacioni Soros.

# SHQIPTARËT QË STUDIOJNË NË VENDET E EUROPËS PERËNDIMORE - FAKTOR REAL I TRANSFORMIMEVE SOCIALE

Brunilda ZENELAGA - *Universiteti "Aleksandër Moisiu" i Durrësit;  
Instituti i Sociologjisë*

---

**T**ransformimi social përmban dy dimensione. *Njëri dimension* lidhet me procesin nëpërmjet të cilit një individ ndryshon statusin social të trashëguar nga prindërit e tij me statusin social të arritur nga përpjekjet e tij individuale. *Dimensioni tjetër* i referohet në një shkallë të gjerë ndryshimit social në fushat kulturore, ekonomike dhe politike të një vendi. Dimensioni i parë përqendrohet tek individ, ndërsa i dyti përqendrohet te sistemi shoqëror.

*Transformimi social në nivel individual* është i ndryshëm nga riprodhimi social dhe mobiliteti social, sepse në vend që të shihet si një mobilitet ndërbrezor ose si masa e ndryshimeve në statusin social që ndodh nga prindërit te fëmijët, transformimi social në nivel individual fokusohet në atë se si një individ mund të ndry-

shojë klasën kulturore dhe sociale me të cilën ai identifikohet. Transformimi social në këtë dimension konsiderohet një negociim ndërpersonal, sepse lidhet me faktin që individët kërkojnë të kenë pozicionin e tyre social të vlerësuar nga të tjerët. Është një marrëdhënie reciproke në të cilën njerëzit duhet të përqafojnë dhe identifikohen në mënyrë korrekte me pritshmëritë kulturore të klasës, anëtarë të së cilës ata janë. Kjo është e vetmja mënyrë se si një person mund të lëvizë nga statusi i tij i atribuar, i trashëguar nga prindërit, në statusin e ri të arritur.

*Transformimi social në kontekstin e sistemit social* kërkon një ndryshim në vetëdijen kolektive të një shoqërie në nivel lokal, shtetëror, kombëtar ose global. Transformimet sociale ndodhin kur qëndrimet dhe vlerat në të cilat mbështetet shoqëria,

**Brunilda Zenelaga** është zëvendëse e Fakultetit të Edukimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës dhe pedagoge e sociologjisë në këtë universitet. Ka kryer studimet e larta për sociologji në Universitetin e Tiranës, ku ka vijuar edhe studimet pasuniversitare për master në sociologji. Është anëtare e Institutit të Sociologjisë dhe kryetare e degës së tij për prefekturën e Durrësit.

duke iu përshtatur një konteksti tërësisht të ri, ngrihen në besime dhe supozime të ndryshme nga të mëparshmet.

Ky artikull do të fokusohet në rolin që kanë luajtur dhe luajnë studentët që kanë studiuar në vende të ndryshme të Europës Perëndimore, në transformimet dhe ndryshimet shoqërore në Shqipëri.

### **Ndikimi i emigrantëve në transformimet sociale të vendit të origjinës**

Analiza e shkaqeve të transformimeve dhe ndryshimeve sociale ka qenë në fokusin e vëmendjes së mendimit sociologjik të disa prej mendimtarëve të njohur përgjatë historisë, si Karl Marks e Max Weber. Sipas Marksit, në epokën moderne, impulsi shtytës përpara i ndryshimit dhe transformimeve sociale është presioni drejt shndërrimit të pareshtur ekonomik. Sidomos shoqëritë kapitaliste që i drejtohen ekonomisë së tregut karakterizohen nga sisteme ekonomike shumë më dinamike se çdo sistem pararendës (Giddens, 2006). Analiza që u bën Marks faktorëve që nxisin ndryshimin, sidomos në sistemin kapitalist, është ndjekur me interes dhe është mbështetur nga mjaft mendimtarë të tjerë, por nga ana tjetër shumë autorë janë përpjekur të hedhin poshtë pikëpamjen e tij duke argumentuar se Marks e ekzagjeroi ndikimin e faktorëve ekonomikë të mirëfilltë si shkaqe të ndryshimeve shoqërore.

Weberi, në kundërshtim me Marks, ka argumentuar se zhvillimi dhe transformimi social ndikohen më së shumti nga faktorë joekonomikë. Sipas tij, ndryshimet në shoqëritë moderne dhe përhapja e mënyrës perëndimore të jetesës në të gjithë botën është nxitur nga vlerat dhe idetë, nga ndikimi i shkencës, religjionit, burokracisë dhe racionalizimit (Giddens, 2006).

Duhet mbajtur parasysh se transformimet në një shoqëri shpesh nxiten si nga faktorë ekonomikë ashtu edhe nga faktorë ideorë. Përveç tyre, transformimet

sociale të një shoqërie nxiten nga një ndërthurje e stimuljeve të jashtëm, që shpesh aktivizohen në mënyrë të qëllimshme, me stimuj të brendshëm.

Transformimet sociale në Shqipëri, në fillim të viteve '90 të shekullit XX, janë nxitur pikërisht nga kjo ndërthurje e faktorëve të jashtëm me stimujt e brendshëm. Rënia e murit të Berlinit në Gjermani, ndryshimet politiko-sociale në Europën Juglindore përbëjnë pa dyshim elemente nxitëse, që vepruan së jashtmi dhe nxitën transformimet sociale në Shqipëri. Nga ana tjetër, varfëria absolute e masës, mungesa e lirive, veprimi dhe të drejtave të njeriut, nevoja për reformizëm shoqëror dhe politik etj., përbëjnë stimuj që nxitën së brendshmi këto transformime në shoqërinë shqiptare.

Sociologë të ndryshëm argumentojnë se ekziston një kategori sociale që ndërlidh stimujt e jashtëm me ata të brendshëm e që ndikon dukshëm në transformimet sociale të një vendi. Kjo kategori përbëhet nga emigrantët, të cilët përmes përvojës së tyre në vendet pritëse, transmetojnë elemente që nxisin ndryshimin në vendet e origjinës. Emigrantët luajnë rolin e madh të lidhjeve qytetëruese midis vendit të tyre të lindjes dhe Perëndimit. Ata realizojnë gjithashtu një urë komunikimi të kulturave dhe vlerave qytetëruese të vendeve përkatës (Fuga, 2004). Migrantët dhe jomigrantët, megjithëse të ndarë nga distanca fizike, ende zënë të njëjtën hapësirë sociale. Imagjinatat e tyre kulturore formohen dhe performohen së bashku.

Duke u mbështetur në idetë e Levitt, mund të thuhet se në shek XXI shumë njerëz u përkasin dy shoqërive në të njëjtën kohë. Kërkuesit quajnë migrantë ndërkombëtarë (transnacionalë) ata që mbajnë lidhje të ngushta dhe të rregullta me vendin e tyre të origjinës dhe që organizojnë aspekte të jetës së tyre përgjatë kufijve kombëtarë. Ata nga njëra

anë integrohen në vendin pritës, ndërkohe që mbajnë lidhje të forta me vendin e origjinës. Integrimi dhe marrëdhëniet transnacionale nuk janë reciprokisht përjashtuese të njëra-tjetres; ato ndodhin në mënyrë simultane dhe ndikojnë njëra-tjetrën. Përvoja e disa migrantëve në vendet pritëse ndikohet nga lidhjet e forta të tyre me vendin e origjinës (Levitt, 2001).

Analistët e ekonomisë theksojnë se remitancat ekonomike që migrimi transnacional gjeneron, konsiderohen si ilaç që shëron sëmundjet e botës dhe e çon atë drejt zhvillimit. Kriza ekonomike botërore, që u pasqyrua me uljen e ndjeshme të nivelit të remitancave ekonomike në vendet e origjinës, dëshmoi rëndësinë e tyre në zhvillimin e vendeve në të cilat këto remitanca kontribuonin.

Sociologët, përveç se në rolin e remitancave ekonomike, fokusohen edhe në rolin e remitancave sociale që migrantët i dërgojnë vendit të tyre të origjinës. Kapaciteti social i emigrantëve, që nxit transformime në vendin pritës, njihet me emrin remitanca sociale. Thënë ndryshe, remitancat sociale janë idetë, mënyrat e sjelljes, identitetet dhe kapitali social që migrantët eksportojnë në komunitetet e tyre të origjinës. Ato mund të përfshijnë idetë mbi demokracinë, shëndetin, përkatësinë gjinore, barazinë, të drejtat e njeriut dhe organizimin e komunitetit. Remitancat sociale ndryshojnë nga rrjedha kulturore globale në faktin se është e mundur të identifikohen kanalet nëpërmjet të cilave këto remitanca sociale përhapen dhe mund të përcaktohet ndikimi i tyre.

Ka dy qëndrime të studiuesve mbi rolin e remitancave sociale. Disa fokusohen te roli pozitiv i tyre e disa të tjerë në rolin negativ. Disa i shohin migrantët si një forcë për më shumë demokratizim dhe përcjellje të ideve të reja në vendin e origjinës, të tjerë i shohin ata si përgjegjës për rritjen e nivelit të materializmit dhe individualizmit (Levitt 2001).

Ky studim ndalet në rolin që luan një kategori e veçantë e migrantëve në transformimet në vendin pritës. Kjo kategori përbëhet nga individët që emigrojnë për qëllime studimi. Përgjithësisht ka një lloj hezitimi për t'i përfshirë studentët me të drejta të plota në kategorinë e emigrantëve dhe kjo i detyrohet faktit që studentët kanë një leje qëndrimi për arsye studimi e për rrjedhojë perceptohen si "të përkohshëm" në shoqërinë e vendit pritës. Megjithatë nuk duhet harruar se "përkohshmëria" e tyre i afrohet disi edhe përkohshmërisë së të gjithë migrantëve (Devole, 2008). Fakti që studentët shihen si kalimtarë dhe tranzitorë, bën që ata shpesh të mbeten jashtë vëmendjes së institucioneve e madje ndonjëherë edhe të studiuesve dhe harrohet se, përveç të tjerash, kjo kategori ndikon fuqishëm në transformimet shoqërore të vendit pritës nëpërmjet remitancave sociale që përcjell në këtë vend. Sociologët këtë e shpjegojnë duke u mbështetur në rolin që luan edukimi në vetvete.

Sipas sociologut Rando Devole, shkolla e lartë mbetet e lidhur pazgjidhshmërisht me formimin e elitave. Në bankat e saj ulen sot ata që do të udhëheqin nesër. Sipas tij, kategoria e studentëve që edukohen në Perëndim përbën një pasuri të dyanshme, si për vendlindjen ashtu edhe për vendin që i arsimon. Qëndrimi i tyre mes dy kulturave dhe dy sistemeve arsimore përbën një urë lidhëse dhe integruese për të dyja vendet (Devole, 2008).

## **Edukimi dhe transformimet sociale**

Edukimi është perceptuar si një mjet i rëndësishëm edhe për akumulimin e pasurisë dhe për formimin dhe akumulimin e kapitalit social. Në ato vende, ku niveli i edukimit është i ulët, ka gjasa që edhe pabarazitë sociale të jenë të mëdha. Në botën perëndimore, sisteme të zhvilluara të edukimit kanë prodhuar shoqëri të shëndosha, demokratike dhe të

mbështetura në liri dhe barazi. Ndërsa për vendet në tranzicion karakteristike është ende një sistem edukimi jo i konsoliduar dhe jo cilësor.

Në veprën e tij *Pedagogy of the Oppressed*, Paulo Freire i referohet të mësuarit tradicional si një sistem përgjatë të cilit studentët depozitojnë njohuritë e prodhuara nga mësuesi. Nëpërmjet liberalizmit, edukimi ka si qëllim të ngushtojë hendekun mes mësuesit dhe studentit duke rritur fuqinë kreative të nxënësit (Freire 1993). Bota përëndimore e ka përqaftuar shumë më herët se vendet e tjera mënyrën liberale të mësimdhënies. Në këtë mënyrë studentët mësojnë të zhvillojnë potencialet e tyre për ta perceptuar në mënyrë kritike ekzistencën e tyre në botë, duke e parë atë jo si një realitet statik, por si një realitet në proces, në transformim (Freire, 1993). Idetë e Freire ndikuan në luftën për transformime sociale në vendet e botës paskoloniale në interesin e lirisë së popullsisë së shtypur kundër ideologjive kolonizuese që i dominonin ato (McLaren & Leonard 1993).

Në *Bowling Alone: America's Declining Social Capital*, *Journal of Democracy*, Robert Putnam argumenton se edukimi luan një rol shumë të rëndësishëm në krijimin dhe forcimin e kapitalit social e për rrjedhojë edhe të kohezionit social. Sipas tij, kapitali social ka të bëjë me lidhjet sociale, normat dhe besimin që kanë një efekt të fuqishëm në produktivitetin shoqëror. Avokatët e kapitalit social raportojnë lidhje të qëndrueshme në vende të ndryshme mes kapitalit social dhe rezultateve sociale, si: niveli i ulët i krimeve, përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve, shërbim publik më i mirë, administrim qeverisës më eficient, reduktim i korrupsionit politik dhe evazionit të taksave, përmirësim i performancës së tregut etj. Sipas Putnam-it, kapitali social është një komponent shumë i rëndësishëm në performancën e edukimit (Putnam, 1995).

Sipas tij, procesi i edukimit është parë si një hallkë e rëndësishme që krijon dhe forcon kapitalin social. Për çdo qeveri që interesohet të rrisë kapitalin dhe kohezionin social, procesi i edukimit është leva më e rëndësishme politike që e mundëson këtë rritje. Në këtë kontekst, institucionet e arsimit janë organet primare që mund të luajnë një rol qendror në hartimin dhe zbatimin e strategjive për të ndërtuar kapitalin social.

Edukimi ka rol të rëndësishëm në ndryshimet individuale, çka e bën individin më aktiv dhe bashkëpunues në shoqëri, sepse ai dhe shoqëria krijojnë njerëzjetrin (Shor, 1992). Historia e shumë vendeve ka treguar se suksesi ekonomik dhe shoqëror i një vendi ndërtohet duke investuar kryesisht mbi trurin.

### **Rasti studimor, qëllimi, metodologjia dhe fusha analitike**

Studimi bazohet në analizën e të dhënave të marra nga intervistat e drejtpërdrejta të 54 individëve që kanë përfunduar studimet e larta në vende të Europës Perëndimore, si Itali, Gjermani, Francë dhe Angli. Nga këta, 36 janë kthyer dhe jetojnë e punojnë në Shqipëri, ndërsa 15 vazhdojnë të jetojnë në vendin ku kanë përfunduar studimet dhe 3 jetojnë në një vend të tretë. Nga 54 të intervistuarit, 33 ishin femra dhe 21 meshkuj.

Personat e intervistuar i përkasin grupmoshës 30-40 vjeç. U zgjodh kjo grupmoshë sepse ajo pasqyron më qartë mendësinë e një brezi që ka përjetuar transformimet në dimension individual dhe social të periudhës paskomuniste. Intervistat u zhvilluan në periudhën gusht-nëntor 2009. Nga personat e intervistuar, 24 ishin nga Durrësi, 15 nga Tirana, 7 nga Elbasani, 5 nga Shkodra dhe 3 nga Vlora. Duke qenë se kampioni u përzgjedh në bazë të metodës së campionimit gjysmërastësor e meqë edhe numri i per-

sonave të intervistuar është i përcaktuar, për rrjedhojë nuk mund të bëhen përgjithësime të sigurta. Megjithatë, analiza e mbështetur në këtë metodë cilësore lejon paraqitjen dhe shqyrtimin në thellësi të të dhënave të marra drejtpërdrejt nga të intervistuarit, si dhe të kuptuarin holistik të çështjes së shqyrtuar.

Qëllimi i studimit ishte dhënia e të gjitha dritëhijeve të mendësive, qëndrimeve dhe përvojave të personave të intervistuar mbi rolin që ka luajtur kontributi i të rinjve shqiptarë që kanë studiuar në vendet e Europës Perëndimore në transformimin e shoqërisë shqiptare gjatë këtyre 20 viteve të fundit.

Zgjedhja e metodës cilësore nuk kërkoi domosdoshmërisht hartimin e hipotezave të formuluar rigorozisht që në fillim të studimit. Duke u mbështetur më shumë në metodën induktive “nga faktet-lart”, studimi lejoi mbledhjen e informacionit nga çdo i intervistuar për ta përgjithësuar në fund atë.

Disa nga problemet lidhur me këtë strategji studimore kishin të bënin me ruajtjen e subjektivitetit dhe mosndërhyrjen, me aftësinë për të dëgjuar intervistën e çdo personi të përfshirë në studim. Pikat e forta të përdorimit të kësaj metode kanë të bëjnë me shkallën e konsiderueshme të fleksibilitetit gjatë studimit.

### **Transformimet sociale në Shqipëri përmes të rinjve që studiojnë në Europën Perëndimore. Gjetjet e studimit.**

Sociologë dhe studiues të ndryshëm mendojnë se transformimet sociale në Shqipëri janë nxitur, përveç të tjerash, edhe nga të rinjtë që kanë studiuar në Perëndim. Transformimet e një vendi nxiten nga tranzicioni që u paraprin këtyre transformimeve. Prof. Hamid Beqja dhe studiuesi Lekë Sokoli kanë bërë një paralelizëm mes tranzicionit të të rinjve dhe tranzicionit të shoqërisë shqiptare në fillim të

viteve '90. Nëse tranzicioni i të rinjve ka të bëjë me një krizë mes dy segmenteve të jetës, fëmijërisë dhe moshës së pjekur, tranzicioni i një vendi, sidomos i shoqërisë shqiptare në vitet '90, kishte të bënte me një krizë të një shoqërie që nuk ishte as komuniste e as kapitaliste. Të dyja këto forma tranzicioni mund të perceptohen si përpjekje për të integruar me sukses të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen (Beqja & Sokoli, 2000). Kështu, dëshira e të rinjve drejt lirisë dhe zhvillimit përkonte kryekëput me nevojën e shoqërisë shqiptare të viteve '90 për të shkuar drejt Perëndimit.

Duke u ndalur në kategorinë e individëve që emigruan për të studiuar në Perëndim, mund të thuhet se pavarësisht nga prania apo mosprania e tyre fizike në Shqipëri, ata kontribuan mjaft në transformimet shoqërore në Shqipëri gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Si ndodhi kjo?

Studentët shqiptarë në vendet e Europës Perëndimore mbajtën gjallë frymën e komunikimit me familjarët, të afërmit, miqtë dhe të njohurit e tyre në vendin e origjinës. Përmes këtij komunikimi, ata përcollën ide, vlera, mendësi, qëndrime të reja dhe elemente kulturore me të cilat u njohën në Perëndim.

*“Më kujtohet që, kur isha student në Angli në vitet 1994-1999, motra e vogël më kërkonte kaseta me këngë të “The Beatles”, fjalorë të gjuhës angleze, revista mode... Sa herë vija në Shqipëri, motra dhe miqtë më dëgjonin me kërshtëri, kur u tregoja për mënyrën e jetesës së Angli, organizimin e jetës dhe rregullin atje...” (Indriti nga Tirana, 34 vjeç)*

Studentët përbëjnë kategorinë më aktive dhe më kritike të shoqërisë. Si të tillë, duke njohur nga afër botën perëndimore akademike, ata arritën të vetëdijesheshin për ndryshimet mes vendit të origjinës dhe vendit pritës më shpejt se pjesa tjetër e emigrantëve, të cilët nuk

kishin emigruar për arsye studimi. Të qenit të vetëdijshëm dhe aktivë, bëri të mundur që kontributi i tyre në vendin e origjinës të ishte thelbësor. Nëse kategoritë e tjera të emigrantëve kontribuan fillimisht në vendin e origjinës nëpërmjet remitançave ekonomike, studentët kontribuan në vendin e origjinës kryesisht nëpërmjet remitançave sociale.

Shoqëria shqiptare e pas viteve '90, përveç krizës politike, ekonomike e sociale, u zhyt në një krizë vlerore të tejshkajshme. Sikurse çdo gjë tjetër, edhe paketa vlerore që kishte ekzistuar deri para viteve '90 u përmbys në mënyrë të menjëhershme dhe u zëvendësua me pseudovlera të "kopjuara" keq nga vendet e zhvilluara perëndimore. Studentët shqiptarë në vende të Europës Perëndimore përçollën më së shumti në Shqipëri një paketë vlerore që ndryshon dukshëm nga pseudovlerat dhe konfuzioni vleror që u zhvilluan së fundmi në shoqërinë shqiptare. Të intervistuarit listuan disa vlera që ata i konsideronin si kontrib-

ute të studentëve shqiptarë për transformimin pozitiv të vendit, por përballë tyre gjejnë edhe pseudovlera, që pengojnë implementimin e vlerave të vërteta të importuara nga bota perëndimore.

1. Elemente të kulturës demokratike perëndimore përballë pseudokulturës demokratike në Shqipëri.
2. Modele eficiente të organizimit social, përballë modeleve joeficiente të organizimit social.
3. Mënyra të reja të të menduarit dhe të jetuarit, që proklamojnë liri mendimi dhe veprimi që i kundërvihen mendimit të ndrydhur dhe veprimeve të kompleksuara dhe të paragjykuara në shoqërinë shqiptare.
4. Respekt për ligjet dhe institucionet në kundërshtim me mosbesimin dhe mosrespektimin e ligjeve dhe institucioneve në Shqipëri.
5. Individualizëm dhe konkurrencë e ndershme për arritjen e suksesit

| <i>Vlera të përcjella në Shqipëri nga të rinjtë shqiptarë që studiojnë në Europë</i>                                                   | <i>Pseudovlerat në shoqërinë shqiptare pas viteve '90</i>                                                                          |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Besimi në elemente të kulturës demokratike perëndimore                                                                                 | Besimi në një pseudokulturë demokratike                                                                                            |
| Modele eficiente të organizimit social                                                                                                 | Modele jo eficiente të organizimit social                                                                                          |
| Mënyra të reja të të menduarit dhe të jetuarit që proklamojnë liri mendimi dhe veprimi                                                 | Mendimi i ndrydhur dhe veprime të kompleksuara dhe të paragjykuara                                                                 |
| Respekt për ligjet dhe institucionet                                                                                                   | Mosbesimi dhe mosrespektimi i ligjeve dhe institucioneve                                                                           |
| Individualizëm dhe konkurrencë e ndershme për arritjen e suksesit individual, por nga ana tjetër bashkëpunim për të mirën e përbashkët | Konkurrencë e ashpër për të arritur "gjithçka për vete" dhe mungesë e plotë e bashkëpunimit për të arritur "të mirën e përbashkët" |
| Përmirësim i gjendjes materiale nëpërmjet kultivimit të meritokracisë                                                                  | Materializëm i theksuar dhe i shkajshëm, që synon të arrihet nëpërmjet formave të pandershme dhe nepotizmit                        |

individual, por nga ana tjetër bashkëpunim për të mirën e përbashkët, duke kundërshtuar konkurrencën e ashpër për të arritur “gjithçka për vete” dhe mungesën e plotë të bashkëpunimit për të arritur të mirën e përbashkët në Shqipëri.

6. Përmirësimin e gjendjes materiale nëpërmjet kultivimit të meritokracisë, duke iu kundërvënë materializmit të theksuar e të skajshëm që synon të arrihet nëpërmjet formave të pandershme dhe nepotizmit në Shqipëri.

Një nga qëllimet e studimit ishte edhe analiza e vetëperceptimit të të intervistuarve në lidhje me fushat ku ata mendonin se kishin ndikuar më shumë për të sjellë ndryshim. Ata pohuan se të rinjtë që kanë studiuar në Europë kanë sjellë më shumë ndryshime në:

- *Organizimin familjar.* Ata mendojnë se kanë ndikuar në sjelljen e përvojave dhe të mendësive në lidhje me forma të reja të organizimit familjar, si bashkëjetesa, kundrejt formave tradicionale siç është martesë, përhapjen e familjes-bërthamë përkundërt familjes me dominim patriarkal etj.
- *Lirinë në shprehje dhe veprim.* Të intervistuarit mendojnë se njerëzit në Shqipëri kanë mendime më të kamufluara e jo të drejtpërdrejta, madje shpesh që shoqërohen me veprime të kompelsuara. Përvoja europiane që përcjellin studentët, proklamon liri në sjellje dhe veprim.
- *Ndryshime në etikën dhe organizimin e punës.* Sipas të intervistuarve, kafetë e shpeshta gjatë orarit të punës, zvarritja e punës deri në shtyrjen e saj, si dhe mungesa e

profesionalizmit e dëmtojnë eficiencën e punës, ndërkohë që të rinjtë e arsimuar jashtë Shqipërisë shprehën se kanë përcjellë më shumë ide të reja dhe kreativitet në punë, më shumë korrektësi në orare, më shumë përgjegjësi e përkushtim e, për rrjedhojë, më shumë produktivitet.

- *Ndryshime në perceptimin e roleve gjinore.* Të intervistuarit pohojnë se rolet gjinore në Shqipëri, sidomos në zonat rurale, tentojnë ende të jenë tradicionale. Modeli evropian që kanë sjellë të rinjtë që kanë studiuar në Europë tenton t'i largohet tradicionalizmit duke proklamuar barazi gjinore dhe jo role gjinore të diferencuara tradicionalisht.

Te intervistuarit mendonin se kanë ndikuar më pak në:

- *Ndryshimin e klimës politike në Shqipëri.* Ekzistenca e grupeve dhe klaneve politike, sipas tyre, ka krijuar një bllokadë që e pengon ndryshimin në Shqipëri.
- *Ndryshimin në ritmet e zhvillimit ekonomik.* Sipas të intervistuarve, zhvillimi ekonomik i Shqipërisë pengohet nga niveli i lartë i korrupsionit dhe nga interesat klanore sunduese. Gjithashtu, ata mendojnë se ekonomia në Shqipëri mbështetet më së shumti në biznesin familjar, çka lë pak hapësira për ndërhyrje dhe ndikim.

“Ne vëmë re që dëshira për ndryshim dhe transformim ekziston në Shqipëri, por has barrierat e shumta, sidomos në ato fusha ku preken drejtpërdrejt interesat e grupeve të caktuara shoqërore...” (Flora nga Durrësi, 37 vjeç, diplomuar për shkencë politike në Siena, Itali.)

## Konkluzione

Sido që të shihet çështja e studentëve shqiptarë në Perëndim, del se ajo është e lidhur me të ardhmen e vendit të origjinës. Rezultatet e studimit treguan se shqiptarët që kanë studiuar dhe studiojnë në Europë sollën dhe vazhdojnë ende të sjellin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë elemente të kulturës demokratike perëndimore, modele eficiente të organizimit social, mënyra të reja të të menduarit dhe të jetuarit, që shpallin nga njëra anë liri në sjellje dhe nga ana tjetër respekt për ligjet dhe institucionet.

Rezultatet e studimit gjithashtu treguan se mendja e hapur e të rinjve shqiptarë që kanë studiuar në vendet e Europës Perëndimore dhe që janë kthyer

në Shqipëri, shërbeu si një kontribut shumë i rëndësishëm që nxiti transformimet sociale në Shqipëri gjatë këtyre 20 viteve të fundit.

Megjithatë, vetëperceptimi i këtyre të rinjve është disi pesimist në lidhje me hapësirat që ata kanë patur dhe kanë për të ndikuar në ndryshimet e shoqërisë shqiptare. Barrierat në mendësitë e zhvilluara në Shqipëri gjatë 20 viteve të fundit, pengojnë transformimin social dhe, për rrjedhojë, ndikimi i studentëve nga bota perëndimore është shumë i ngadalhtë dhe i kufizuar.

Shumica e të intervistuarve pohojnë se transformimi është një proces i gjatë dhe i mundimshëm dhe se Shqipëria është ende në fillimin e këtij transformimi, që duhet të përballlet me sfida të reja.

## REFERENCAT

- Beqja, H. & Sokoli, L. 2000. *Tranzicioni demokratik dhe zhvillimet psikologjike*, Politika dhe shoqëria. Vol.1 . Nr (1). Fq. 33-44.
- Devole, R. 2008. *Ura mbi det. Emigracioni shqiptar në Itali*. Ora, Tiranë.
- Freire, P. 1970. *Pedagogy of the Oppressed*. New York: Seabury Press.
- Fuga, A.. 2004. *Shoqëria periferike*, Tiranë. Ora.
- Giddens, A. 2006. *Sociology*, Fifth edition, Polity Press.
- Levitt, P. 2001. *Transnational Migration: Taking Stock and Future Direction*. Global Networks 1(3): 195-216.
- McLaren, P. & Leonard, P. 1993. *Paulo Freire: A Critical Encounter*. New York: Routledge.
- Putnam, R. 1995. *Bowling Alone: America's Declining Social Capital*. *Journal of Democracy*, Januay 1995, Volume 6. Number 1.
- Shor, I. 1992. *Empowering Education: Critical Teaching for Social Change*. Chicago: University of Chicago Press.

# STUDIM PILOT MBI PËRFAQËSITË SOCIALE TË PRINDËRVE RRETH SHKOLLIMIT TË FËMIJËVE: RASTI I EMIGRANTËVE, JOEMIGRANTËVE DHE EMIGRANTËVE TË KTHYER SHQIPTARË

Albana CANOLLARI - *Universitetit "Kristal"; Instituti i Sociologjisë*  
Guida de ABREU - *Oxford Brookes University, Angli*

---

## Qëllimi i studimit

Vlerat që përcjellin prindërit të fëmijët e tyre, si dhe praktikat që ata përdorin gjatë rritjes së tyre kontribuojnë të mënyrat sesi i jepet formë zhvillimit të fëmijëve në tërësi. Studimi aktual shken-  
cor ndërtohet mbi bazën e teorive

psikologjike kulturore të Vygotsky-t, Bronfenbrenner-it dhe Moscovici-t, të cilët hodhën themelet e perspektivës historike dhe kulturore për trajtimin e fenomeneve. Qëllimi i këtij studimi ka në fokus investigimin e ndikimit të ndryshimeve social-kulturore mbi përfaqësitë sociale të prindërve rreth sh-

**Albana Canollari**, anëtare e Institutit të Sociologjisë dhe e bordit akademik të tij, është shefe e departamentit të psikologjisë të Universitetit "Kristal". Është diplomuar në Universitetin e Oksfordit, në Angli, në psikologji dhe sociologji. Më pas ka vijuar studimet për master në kërkim, në fushën e psikologjisë, fokusuar në zhvillimin e identitetit të studentit shqiptar në botë, kryesisht në Itali dhe Angli. Është fituese e Konkursit Kombëtar për Exelencën, për vitin 2007.

**Guida de Abreu**, Prof. nga Oxford Brookes University (2010) dhe PhD nga Universiteti i Kembrixhit (1994), është lektore e Psikologjisë Kulturore në Oxford Brookes University, në Angli. Është marrë me hulumtime shkencore në fushën e psikologjisë së kulturës, të zhvillimit njerëzor, emigracionit dhe ndikimit të tij në identitetin kulturor etj. Hulumtimet e saj janë shtrirë, veç Anglisë, edhe në Brazil, Portugali etj. Ajo ka bashkëpunuar me studiues nga vende të ndryshme. Fryt i këtij bashkëpunimi janë botimet "Tranzicionet në kontekstin e praktikave matematikore" (2002), "Arsimimi i fëmijëve portugezë në Britani", "Ndërmjetësi-  
mi social në të mësuarit në shkollat multi-etnike" etj.

kollimit të fëmijëve të tyre. Shqipëria, si vend i vogël në Ballkan, i dha fund regjimit diktatorial rreth 19 vjet më parë. Gjatë këtyre dy dekadave të fundit, kanë ndodhur transformime në shumë aspekte socio-kulturore, si dhe zhvillime ekonomike. Një aspekt i veçantë për këtë studim është sistemi arsimor, që ka njohur ndryshime rrënjësore. Ndikimi i këtyre ndryshimeve makrosociale mbi përfaqësitë sociale të prindërve shqiptarë është fokusi i këtij studimi.

Kërkimet psikologjike rreth mënyrës sesi prindërit ndërmjetësojnë procesin e të nxënës dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre në situata të ndryshme janë ende të paeksploruara mirë, ndonëse të kuptuarit e përfaqësive sociale të prindërve është aspekt shumë i rëndësishëm, pasi luan rol me ndikim të drejtpërdrejtë në shkollimin e fëmijëve të tyre (Abreu & Cline, 2005; O'Toole & Abreu, 2005). Përfaqësitë sociale janë "*imazhe* që përmbledhin nënkuptime dhe domethënie të shumta, që e lejojnë individin të interpretojë atë që ndodh realisht; ato janë quajtur *kategori* që shërbejnë për të klasifikuar situata, fenomene dhe individë më të cilët përballemi, *teori* që na ndihmojnë të përkufizojmë fakte rreth tyre" (Jodellet, 1991). Si proces, përfaqësitë sociale kanë të bëjnë me përkufizime që janë të njohura e njëkohësisht ato transformohen nga nevoja për të kuptuar ndryshimin dhe të panjohurën.

Në një studime të kohëve të fundit, psikologët e zhvillimit kulturor, O'Toole & Abreu (2005), studiuan përfaqësitë e prindërve rreth shkollimit të fëmijëve të tyre në dy situata edukimi në ndryshim. Situata e parë përfshinte prindër imigrantë në Angli, pra prindër të arsimuar në një tjetër vend. Situata e dytë përfshiu prindër arsimuar para prezantimit të kurrikulës kombëtare në Angli. Nga studimi rezultoi se prindërit,

në mënyrë të menduar apo jo, mund të sjellin përvojat e mëparshme për të përkufizuar situatat e momentit, që kishin të bënin me shkollimin e fëmijëve. Më specifikisht, studiuesit zbuluan se, kur e kaluara e prindërve rreth shkollimit të tyre nuk përputhej me atë që donin për të ardhmen e fëmijëve, ata e përdornin të kaluarën për të promovuar ndryshimin. Ky, gjithsesi, është një ndikim i ndërlikuar, pasi dëshira për ndryshim në një dimension (p.sh., mbështetje emocionale), mund të stimulojë praktika që bien ndesh me shkollimin e fëmijëve. Për shembull, prindërit që kishin pasur përvoja jo të këndshme kur kishin qenë fëmijë dhe, si rrjedhojë, mbështetje negative, ishin më shumë të prirë për t'i inkurajuar me pozitivitet fëmijët e tyre. Megjithatë, ata nuk treguan se mund t'i kuptonin ndryshimet në moshën e fëmijëve dhe se kur pritet që fëmijët të lexojnë. Ky studim ka në fokus ndryshimet që lidhen me përvojën rreth arsimit të prindërve të përfshirë në ndryshime radikale në praktikën e shkollimit, por njëkohësisht në ndryshimet radikale makropolitike. Për shembull, krijimi i institucioneve private të arsimit, krahas atij publik në vend.

Siç u tha edhe më lart, teorikisht hulumtimi mbështetet në fushën e psikologjisë së zhvillimit kulturor të mendimtarëve Vygotsky-it, Bronfenbrenner-it dhe Moscovici-it. Në këto qasje psikologjike kuptimi i të mësuarit individual dhe zhvillimit psikologjik të individit përfshin marrjen në konsideratë të marrëdhënieve reciproke midis parametrave mikro dhe makro socio-kulturore. *Së pari*, studimi inkurajohet nga nocioni i Vygotsky-t, ku proceset e ndërmjetësimit social dhe kulturor janë thelbësore për të kuptuar funksionimin psikologjik (Abreu & Elbers, 2005; Vygotsky, 1978). Abreu dhe Elbers's (2005) përkufizuan "përfaqësitë sociale

si ndërmjetës specifik që bën lidhjen midis kontekstit të gjerë social me kontekstin social më të ngushtë mikro”. *Së dyti*, modeli ekologjik i zhvillimit human është përdorur për të conceptualizuar lidhjen midis niveleve makro dhe mikro. Me nivel makro nënkuptohet konteksti që ka të bëjë me grupimet (kultura, nënkultura apo ndonjë tjetër strukturë sociale), anëtarët e të cilëve ndajnë të njëjtat vlera apo sisteme besimi, burime, stile jete, struktura mundësish dhe modele të shkëmbimeve sociale (Bronfenbrenner, 1993, p. 25). Ky përkufizim sugjeron se shoqëri të ndryshme ndajnë makrosisteme të ndryshme dhe se grupe të ndryshme në një shoqëri ndajnë vlera dhe pikëpamje të ndryshme. Prandaj, grupe të ndryshme janë pozicionuar në ato nivele makro që jetojnë/jetuan dhe në ato sisteme mikro që ata zgjedhin/zgjedhën të përfshihen (shkolla, shoqëria, familja, lidhjet e përditshme etj.). *Së treti*, duke shqyrtuar zhvillimet e fundit të teorisë së Moscovici-t, studimi do të hulumtojë mbi përfaqësitë sociale të prindërve shqiptarë rreth shkollimit të fëmijëve të tyre mbi supozimin se përfaqësitë sociale punojnë për të koduar realitetin duke *‘mbartur imazhe dhe eko të historive tona individuale dhe kolektive’* (Howarth, 2006).

Për të pasur një tablo të detajuar rreth këtyre marrëdhënieve reciproke, u shqyrtuan tri ndryshime makrosociale që mund të kenë ndikuar në përfaqësitë sociale mbi praktikën e edukimit. Konkretisht, hapi i parë do të përfshijë kërkimin mbi ndikimin e ndryshimeve: a) si pasojë e zhvillimeve politike dhe ekonomike në sistemin arsimor në vend; b) si rrjedhojë e emigrimit jashtë vendit (p.sh. Britani e Madhe); c) si rrjedhojë e rikthimit në vendlindje (Shqipëri).

Për më tepër, për të kuptuar përfaqësitë sociale të prindërve, paralelisht ky studim hulumtoi fëmijët e tyre mbi hipotezën se perceptimi i tyre rreth prak-

tikave shkollore do të ndihmonte të tregonte se deri në ç’masë ballafaqohen ose jo përvojat e përjetuara. Të pakta janë kërkime psikologjike rreth mënyrave se si prindërit ndërmjetësojnë në procesin e nxënies dhe zhvillimit të fëmijëve në një shoqëri që ndryshon (Howarth, 2004) dhe se nevoja për të kuptuar përfaqësitë sociale të prindërve ka rëndësi të veçantë, ngaqë ato luajnë rol kyç në arsimimin e fëmijëve (Abreu & Cline, 2005; O’Toole & Abreu, 2005). Shkollimi i fëmijëve dhe mënyra si e përjetojnë ata këtë proces në tri situata të ndryshme socio-kulturore (si fëmijë të emigrantëve, joemigrantëve dhe emigrantëve të kthyer), u hetua nëpërmjet metodologjisë tematike cilësore.

Qëllimi i këtij raporti është të përcjellë rezultatet që lidhen me hulumtimin në lidhje me prindërit si emigrantë, joemigrantë dhe emigrantë të kthyer, duke marrë parasysh se prindërit janë fokusi i studimit në tërësi. Studimi synon të japë një kontribut të veçantë duke sjellë për herë të parë në vend një këndvështrim të ri në fushën e psikologjisë kulturore. Studimi në fjalë ka për objekt që, në këtë kuadër, të kontribuojë për të sjellë një aspekt të ri rreth mënyrës se si ndryshimet socio-kulturore në nivel makro kanë ndikim në përfaqësitë sociale të prindërve rreth shkollimit të fëmijëve të tyre (sistemi mikro). Për më tepër, pritet që rezultatet e studimit të kontribuojnë në politikën arsimore në vend, si dhe do të japin informacion rreth arsimit të fëmijëve shqiptarë. Studimi ka potencial mjaftueshëm të parashtrijë çështjet kryesore në marrëdhëniet midis përfaqësive të prindërve dhe përfaqësuesve të institucioneve arsimore rreth shkollimit të fëmijëve.

## Metodologjia

Rekrutimi i pjesëmarrësve në Britani dhe Shqipëri u bë sipas procedurave standarde të kërkimit shkencor britan-

ik, bazuar në lejen e Këshillit të Etikës pranë Universitetit Oxford Brookes. Ky studim cilësor, që fokusohet në analizimin e tematikave të veçuara nga intervistat, përfshiu 34 pjesëmarrës përfaqësues në tre statuse: *emigrantë* - 10 pjesëmarrës (4 prindër, 4 fëmijë dhe 2 mësues), *joemigrantë* - 10 pjesëmarrës (4 prindër, 4 fëmijë dhe 2 mësues), si dhe *emigrantë të kthyer* - 14 pjesëmarrës (6 prindër, 6 fëmijë dhe 2 mësues).

Pjesëmarrësit emigrantë ishin rezidentë në Londër; ata joemigrantë dhe emigrantë të kthyer ishin rezidentë në Tiranë, Durrës dhe Vlorë. Me të gjithë pjesëmarrësit u zhvilluan intervista individuale, që zgjatën rreth një orë, ndërsa fëmijëve (mosha 9-11 vjeç) iu kërkuua gjithashtu të vizatonin veten e tyre në 5 situata të ndryshme: *si nxënës në shkollë; si nxënës në shtëpi; si i shohin prindërit; si i sheh mësuesi; si e shohin veten e tyre kur të jenë 25 vjeç*. Vizatimet e fëmijëve dhe aktivitetet e tyre të përditshme shkollore janë krahasuar midis tre grupeve pjesëmarrëse për të arritur në përfundimin se instrumentet e përdorura për kërkim janë të vlefshme për zbulimin e perceptimeve të tyre.

Njëherazi, disa nga mësuesit e fëmijëve pjesëmarrës u intervistuan për të nxjerrë konkluzione rreth perceptimit të tyre mbi zhvillimin e arsimit në vendet përkatëse dhe si e vlerësojnë ata rolin e prindërve në praktikën shkollore të fëmijëve të tyre. Analizimi i të dhënave të mbledhura nga fëmijët dhe mësuesit formoi një trekëndësh që ndihmon për vlerësim të saktë mbi mënyrën se si prindërit formojnë përfaqësitë sociale rreth shkollimit të fëmijëve. Intervistat me prindërit rezidentë në tre statuset socio-kulturore, krijojnë një tablo të gjerë mbi fenomenet që patën ndikim në arsimimin e tyre.

Intervistat me prindër u zhvilluan në ambiente të ndryshme, sipas prefer-

encave (shtëpi, klasa, zyrë pune) dhe zgjatën rreth 1.5 orë. Pyetjet e gjysmëstrukturuara të stilit narrativ, të ndara në seksione, kishin të bënin me: domethënien e prindërve rreth edukimit në përgjithësi dhe veçanti (arsimi shkollor); arsimimi i tyre; pikëpamjet mbi shkollimin e fëmijëve të tyre; përfshirja e tyre në aktivitetet shkollore të fëmijëve të tyre; domethënia e arsimit në mjedis multikulturor (për grupin e emigrantëve dhe të emigrantëve të kthyer). Tematika interesante lidhej me periudhën pas regjimit komunist, përshatjen gjatë dekadës së parë dhe zhvillimet në arsim gjatë dy dekadave të fundit, ndikimet e migrimit, si dhe shumë aspekte socio-kulturore që mund të kenë ndikuar në perceptimet e prindërve rreth arsimit. Për efekt publikimi, në këtë raport janë paraqitur rezultatet e 14 prindërve pjesëmarrës.

## TEMATIKAT KRYESORE

Intervistat u transkriptuan dhe përkthyen nga shqipja në anglisht dhe më pas u analizuan në paketën për studime cilësore NVIVO (versioni 8). Tematikat më të rëndësishme që dolën në pah nga prindërit pjesëmarrës në të tria grupet ishin:

### 1. Ndikimi i ndryshimeve politikë-ekonomike në përfaqësitë sociale të prindërve rreth shkollimit të fëmijëve

#### *Ndikimi pozitiv*

a. 1. Fundi i regjimit diktatorial - si regjim që përkufizonte performancën e studentit në bazë të statusit social të prindit - ku studentët nuk kishin mundësinë të zgjidhnin profilizimin që dëshironin.

a. 2. Hapja e arsimit privat, rikonstruktimi i ambienteve të shumë shkollave, trajnime për mësuesit, gjuha e huaj,

kompjuteri në shkolla etj.

a. 3. Sot çdokush ka mundësinë të zgjedhë sipas formimit që ka e nëse ka mundësi materiale, mund të shkollohet edhe jashtë.

a. 4. Marrëdhënia prind-fëmijë është më e hapur, flasin si shokë.

a. 5. Inkurajohet mësimi interaktiv e jo më mekanik.

a. 6. Mundësia e prindërve për t'u shkolluar sot

a.7. Prindërit nuk kishin vizion të qartë në arsimimin e tyre; sot fëmijët janë të aftë ta projektojnë të ardhmen e tyre.

### *Ndikimi negativ*

b.1. Siguria e fëmijëve nuk është siç ka qenë dikur.

b.2. Korrupsioni në shkollë.

b.3. Niveli i teksteve.

b.4 Fëmijët në shkolla publike ende nuk janë të hapur për shqetësimet e tyre si pasojë e frikës ndaj mësuesit dhe vlerësimit të tij në fund.

## **2. Ndikimi i migrimit në përfaqësitë sociale të prindërve rreth shkollimit të fëmijëve (emigrantë dhe emigrantë të kthyer)**

2.1. Përvoja me arsimin jashtë vendit reformon pikëpamjet e prindërve ndaj arsimit në përgjithësi.

2.2 Përvojë e pasur, mësues të përkushtuar, që nuk i fyejnë nxënësit, marrëdhënia prind-mësues korrekte, marrëdhënia fëmijë-mësues e dashur, etj

2.3 Inkurajimi i fëmijëve për të thënë atë që mendojnë.

2.4 Shkollat shqipe në diasporë në ndihmë të familjeve dhe fëmijëve shqiptarë jashtë vendit për mësimin e gjuhës shqipe dhe organizimin e ngjarjeve kulturore. (p.sh., shkolla "Ardhmëria" në Londër, me 650 fëmijë shqiptarë, ku mësojnë rreth kulturës, kërcimeve, gjuhës shqipe dhe të tjera formime në shqip).

## **3. Ndikimi i kthimit në atdhe në perceptimet sociale rreth shkollimit të fëmijëve**

3.1 Përshtatja me arsimimin në vend - një eksperiencë jo e mirë; pasiguria e fëmijëve në shkollë; korrupsioni në shkollë; moskontaktimi nga mësuesit nëse fëmija mungon; mësuesit - tepër të ngarkuar me regjistra apo dokumente - kanë pak kohë për të zhvilluar lojëra me fëmijët; librat bazë ndryshojnë nga një shkollë në tjetrën.

3.2 Fëmijët kanë nevojë të mësojnë ato që u duhen për jetën; programet janë tepër të ngarkuara për ta.

3.3 Fëmijët gjykohen mbi bazën e përgatitjes në orën e matematikës; nëse je i mirë në matematikë, atëherë i mirë je në të gjitha.

3.4 Prania e arsimit privat me mësues më të përkushtuar ndaj fëmijëve me identitet dykulturore.

## **Përfundime**

Roli i prindërve për shkollimin e fëmijëve është tepër i rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e tyre.

Nëse biem dakord që prindërit luajnë rol parësor në ecurinë e fëmijëve të tyre, atëherë është e rëndësishme të kuptojmë se si ata i ndërtojnë perceptimet mbi të cilat marrin vendime për fëmijët e tyre.

Rezultatet që dolën në pah pas analizimit të intervistave me prindër, konfirmuan se e kaluara e prindërve ndërjetëson dhe i jep kuptim së tashmes. Me fjalë të tjera, eksperiencia gjatë shkollimit të këtyre prindërve është e pranishme dhe ata përfshihen dhe marrin vendime rreth jetës shkollore të fëmijëve të tyre. Së dyti, statusi socio-kulturore i fëmijëve ndërvepron me dëshirat dhe aspiratat akademike të prindërve. Së treti, ndihmën e parë rreth paqartësive që hasin gjatë orës së studimit në shtëpitë e tyre,

fëmijët e marrin nga nënat. Një tjetër faktor me rezultat interesant ishte dhe roli i lëndës së matematikës, që e rrit nivelin e komunikimit prind-fëmijë gjatë orës së studimit.

Studimi sugjeron se roli i prindërve është parësor dhe se e kaluara e tyre ndërmjetëson mënyrën se si ata e perceptojnë shkollimin e fëmijëve të tyre sot. Po ashtu, prindërit dhe mësuesit duhet t'i ri-

dimensionojnë perceptimet mbi klasat, pasi ato çdo ditë mbushen me fëmijë të ardhur nga formime të ndryshme kulturore. Fëmijët sot zhvillojnë identitete kulturore heterogjene, ndryshe nga ai i prindërve apo mësuesve të tyre.

Në përfundim, riformatimi i marrëdhënies shkollë-shtëpi përfshin krijimin e një atmosfere mikpritëse, të dashur dhe bashkëpunuese.

## LITERATURA

- Abreu, G. de, & Cline, T. (2005). Parents' representations of their children's mathematics learning in multiethnic primary schools. *British Educational Research Journal*, 31(6), 697-722.
- Abreu, G. d., & Elbers, E. (2005). Introduction: The social mediation of learning in multiethnic schools. *European Journal of Psychology of Education*, 20 (1), 3-11.
- Bronfenbrenner, U. (1979) *The ecology of human development: experiments by nature and design* (Cambridge, Harvard University Press) In Elliot, J. & Tudge, J. (2007) *The impact of the west on post-Soviet Russian education: change and resistance to change*, (p.93).
- Bronfenbrenner, U. (1993), *Development ecology through space and time: a future perspective* In Elliot, J. & Tudge, J. (2007) *The impact of the west on post-Soviet Russian education: change and resistance to change*, (p.94).
- Howarth, C. (2006) *A social representation is not a quiet thing: Exploring the critical potential of social representations theory*. The British Psychological Society, 45,
- Jodelet, D. (1991). *Madness and social representations*. Hemel Hempstead, UK: Harvester Wheatsheaf.
- Moscovici, S (1973) In Moscovici, Serge (2000). *Social representations: Explorations in Social Psychology* (Ed. Gerard Duveen) Cambridge: Cambridge University Press.
- O'Toole, S., & Abreu, G. d. (2005). Parents' past experiences as a mediational tool for understanding their child's current mathematical learning. *European Journal of Psychology of Education*, 20 (1), 75-89.
- Vygotsky, L. (1978). *Mind in society: the development of higher psychological processes*. Cambridge, Mass: Harvard University Press.

# 1989: RËNIA E MUREVE DHE ARDHJA E PARË (JO)RASTËSORE E NËNË TEREZËS NË SHQIPËRI

Tonin ÇOBANI MA - *Instituti i Sociologjisë & KKRT*

---

*“Me të drejtë thuhet se një popull karakterizohet jo aq fort nga njerëzit e tij  
të mëdhenj se sa nga ajo se si sillet ndaj tyre.”*  
Niçe

## PËRMBLEDHJE

Simbolika e rënies së “Murit të Berlinit” mund të interpretohet dhe të keqinterpretohet në vartësi të këndvështrimeve. Kriteri i parë është domethënia për popullin gjerman e ngritjes së “Murit të Berlinit”, por edhe për popujt e Europës e më gjerë. Jo domethënia për dy kampet apo sistemet kundërshtarë, sepse pikërisht antagonizmi i tyre është njëri ndër shkaqet kryesore për ngritjen dhe e mbajtjen në këmbë të atij muri. Kriteri i dytë mund të formulohet si një pyetje: a ekzistojnë, edhe pas 20 vjetëve, “mure” të tjerë në gjirin e popullit gjerman, “mure” ndërmjet popujve europianë e atyre ndërkontinentalë, rrjedhoja e të cilëve ndoshta duhet lexuar në krizën e fundit globale? Për ne, shqiptarët, domethënia e “Murit të Berlinit” dhe e rënies së tij është shprehur me të ashtuquajturën luftë klasash, që ka qenë një perde ndarëse e shqiptarëve brenda shtetit të tyre; e veçimit të shqiptarëve njëri me tjetrin në rajon e diasporë; e izolimit të shqiptarëve brenda kufirit të tyre shtetëror nga e gjithë bota. Një nga dëshmitë më absurde të “murit” - tani do ta quajmë të Tiranës - ishte refuzimi i vazhdueshëm që iu bë Nënë Terezës për t’u futur në Shqipëri - ndërkohë që ajo qarkullonte në të gjithë botën - moslejimi i saj për të takuar nënën dhe motrën në Tiranë, qoftë edhe për t’iu ndodhur pranë në çastet e fundit të jetës së tyre, ndërkohë që një nga sfidat e misionareve të saj ishte mosbraktisja deri në çastet e fundit të jetës e kujtdo qenieje njerëzore mbi glob,

**Tonin Çobani** është anëtar themelues i Institutit të Sociologjisë dhe kryetar i seksionit të komunikimit, kulturës dhe artit të tij. Ka botuar, veç artikujve studimorë, edhe disa libra me problematikë socio-kulturore, si: “Miti dhe antimiti fishtjan”, “Paralele kulturore”, “Princi i përfulur Lekë Dukagjini”, “Variacione me fjalën komb”, “Fishtologji”, “Pjetër Zarishti dhe krijimi i rruzullimit”, “Mitet në Lahuta e Malcisë” etj.

pavarësisht statusit të tyre kombëtar a klasor, politik a ideologjik, fetar a familjar. Njëzet vjet më parë, me lejin e Nënë Terezës për të vizituar varrin e nënës dhe të motrës së saj në Tiranë, shënohet fillimshembja e “Murit të Berlinit” në Shqipëri. Më pas ajo erdhi dhe ngriti disa qendra të misioneve të saj në Shqipëri, madje u lartësua emri i saj dhe u ngritën monumente si për asnjë shqiptar tjetër më parë. Por të gjitha këto nuk do të thonë se qenka shembur perdia ideologjike ndër shqiptarët.

**T**ezën që dua të shtroj këtu mund ta përmbledhja në dy togfjalësja: rënia e Murit të Berlinit, rasti shqiptar. Ajo kohë, ndoshta rastësisht, lidhet me vizitën e parë të Nënë Terezës në Tiranë, prandaj qëndrimin ndaj emrit dhe veprës së saj do ta përdor për të argumentuar ekzistencën ose jo të këtyre “mureve” edhe sot pas 20 vjetëve.

## Hyrje

Simbolika e rënies së Murit të Berlinit mund të interpretohet dhe të keqinterpretohet në vartësi të këndvështrimeve, prapa të cilave qëndrojnë përfitime imediate, interesa afatmesme dhe strategji afatgjata të grupimeve gjeopolitike tradicionale dhe më të reja. Pavarësisht prej këtij klasifikimi, dy janë kriteret që ndajnë interpretimet realiste prej demagogjive ose keqinterpretimeve. Kriteri i parë, sipas pikëpamjes sime, është domethënia për popullin gjerman e ngritjes së Murit të Berlinit, por edhe për popujt e Europës e më gjerë. Jo domethënia për dy kampet apo sistemet kundërshtarë, sepse pikërisht antagonizmi i tyre është njëri ndër shkaqet kryesore për ngritjen dhe e mbajtjen në këmbë të atij muri. Kriteri i dytë mund të formulohet si një pyetje: a ekzistojnë, edhe pas 20 vjetëve, “mure” të tjera në gjirin e popullit gjerman, “mure” ndërmjet popujve europianë e atyre ndërkontinentalë, rrjedhoja e të cilëve ndoshta duhet lexuar në krizën e fundit globale?

## Muri i Tiranës

Nuk kam ndër mend t’u tregoj gjermanëve domethënien e ngritjes dhe të rënies së muri të tyre. Ata e bëjnë vetë një gjë të tillë, si dinë ata ta bëjnë: gjermanisht. Edhe popujt e tjerë do të kthjellohen si duhet në “gjuhët e tyre kombëtare”. Për ne shqiptarët, domethënia e murit të Berlinit dhe e rënies së tij është shprehur me të ashtuquajturën luftë klasash, që ka qenë një perde ndarëse e shqiptarëve brenda shtetit të tyre, e veçimit të shqiptarëve njëri me tjetrin në rajon e diasporë, e izolimit të shqiptarëve brenda kufirit të tyre shtetëror nga e gjithë bota. Një nga dëshmitë më absurde të murit - tani do ta quajmë të Tiranës - ishte refuzimi i vazhdueshëm që iu bë Nënë Terezës për t’u futur në Shqipëri - ndërkohë që ajo qarkullonte në të gjithë botën - moslejimi i saj për të takuar nënën dhe motrën e saj në Tiranë, qoftë edhe për t’u ndodhur pranë në çastet e fundit të jetës së tyre, ndërkohë që një nga sfidat e misionareve të saj ishte mosbraktisja deri në çastet e fundit të jetës e kujt do qenieje njerëzore mbi glob, pavarësisht statusit të tyre kombëtar a klasor, politik a ideologjik, fetar a familjar:

Atyre që janë në prag të vdekjes, -shprehej Nënë Tereza,- mundemi që të paktën t’u japim përsh-  
typjen e vërtetë të një gjëje shumë të rëndësishme: që ekziston dikush, i gatshëm për t’i dashur me të vërtetë dhe me fakte, sepse dhe ata, si gjithë të tjerët ose ndoshta me të drejta më shumë se të tjerët, janë bij të Zotit dhe meritojnë të duhen.<sup>9</sup>

<sup>9</sup>. “Më shumë dashuri - mendime të Nënë Terezës”, përkthyer në shqip nga Laureta Çobani, botim dygjuhësh: shqip-italisht, Toena, Tiranë 2003, fq. 145.

Dhe ai mur i Tiranës filloi të binte 20 vjet më parë, ndoshta 3-4 muaj më parë se të shembej Muri i Berlinit, pikërisht kur Nënë Tereza arriti të hynte në Shqipëri, më 15-18 gusht 1989. Pyetja që vjen, riformulohet: a ka mure të tjerë tiranas që ndajnë një shqiptar a një grup shqiptarësh nga gjiri i familjes së vet dhe i kombit për motive biografike, fetare, ekonomike apo botëkuptimore? Unë them se po. Dhe, nëse kjo “po” është sadopak e vërtetë, atëherë entuziazmit tonë, përvjetor pas përvjetori për rënien e Murit të Berlinit (apo të Tiranës), duhet t'i vëmë fre. Duhet të thellohem edhe më në shkaqet e ngritjes së mureve të tilla në Berlin e gjetkë, pavarësisht nga teknologjia e sofistikuar e ndërtimit të tyre: që i bëjnë ato mure të dukshme, më pak të dukshme apo krejtësisht të padukshëm në sytë tanë të vjetruar qysh nga krijimi i gjallesave mbi tokë, apo diçka më vonë, qyshkur jeta e qenieve njerëzore u shoqërizua. Nënë Tereza është syri i hapur i mbarë njerëzimit, syri që depërton çfarëdolloj muri që e vetmon njeriun prej njeriut, prandaj, ndoshta, ka reagime ndaj veprës së saj prej atyre që ushqehen ose, me saktë, majmen duke veçuar kombe, duke ndarë popuj apo duke e kacagjeluar njeriun kundër njeriut.

### Ngërç sociologjik shqiptar

Ceka më sipër se 20 vjet më parë, me lejimin e Nënë Terezës për të vizituar varrin e nënës dhe të motrës në Tiranë, shënohet fillimshembja e murit të Berlinit në Shqipëri. Më pas ajo erdhi dhe ngriti disa qendra të misioneve të saj në Shqipëri, madje u lartësua emri i saj dhe u ngritën monumente si për asnjë shqiptar tjetër më parë. Por të gjitha këto nuk do të thonë se qenka shembur perdia ideologjike ndër shqiptarë. Unë nuk do të përmend fakte të tilla, si debati që u bë për ngritjen e katedrales me emrin e saj në

Prishtinë, për ngritjen e monumentit në Shkodër apo për fshehjen e monumentit të saj në Tiranë. Ajo që më shqetëson është qëndrimi ndaj veprës së saj, si përvojë dhe mendësi e re për menaxhimin e shoqërisë së sotme njerëzore. Unë shoh një mur të ri të Tiranës (jo më të Berlinit) në këtë qëndrim: indiferentizmi ndaj veprës së saj dhe tendenca për ta lënë atë në “shenjtërinë” e vet muzeale krijojnë atë mur të sofistikuar që shprehet me një ngërç jo të vogël edhe në mendimin sociologjik shqiptar.

Edhe sikur të mos ishte fare shqiptare, përvoja e gjallë e Nënë Terezës dhe sentencat e saj në përballjet realiste me teorizimet fraziste të të gjithë globit përbëjnë një kontribut universal në studimet sociologjike, së cilës medoemos do të duhej t'i referoheshin shqiptarët. Asnjë teori sociologjike nuk do të funksiononte nëse nuk do t'i shërbente realisht shoqërisë e, aq më pak, një koineje të caktuar ku aplikohet ajo teori, ashtu si vepronte Nënë Tereza dhe motrat e saj. Pikërisht ky thelb i shmangur, që buron nga veprimtaria praktike dhe sintetizohet në aforizmat e saj, shpjegon atë që në krye të kësaj kumtese e quajta keqinterpretim të simbolikës së rënies së Murit të Berlinit (dhe të Tiranës). Thënë troç, megjithëse 20 vjet më para ra perdia e Tiranës që e pengonte Nënë Terezën të hynte në Shqipëri, ka mbetur ende më këmbë një mur tjetër që pengon mendësitë e saj të shtrohen, qoftë edhe si alternativë e mendimit tonë sociologjik për një menaxhim më human të shoqërisë së sotme shqiptare, nevoja e të cilit përflitet prej ne të gjithëve.

### Tullat njëzetvjeçare

Veprimtaria dhe mendimi sociologjik i Nënë Terezës nuk mund të shqyrtohet jashtë doktrinës sociale të Kishës (dottrina sociale della Chiesa). Së pari, sepse institucioni i Nënë Terezës asnjëherë nuk ka

bërë ndonjë përpjekje për t'u shkëput nga mbikëqyrja e Kishës dhe, së dyti, sepse Kisha, nga ana e vet, nuk u është kundërvënë ndonjëherë institucioneve të motrave të saj, por i ka pranuar ato edhe kur i tejkalonin dukshëm praktikën e deriatëhershme të teorive të saj sociale. Madje, qyshkur autoriteti i institucioneve të Nënë Terezës u bë i njohur në shkallë botërore, Vatikani u përpoq ta përfshinte veprimtarinë e tyre në misionin e Caritas-it. Por të gjitha këto përfshirje nuk mund të jenë tulla të një muri të ri në mes të shqiptarëve, siç është vënë re në shkrimet e ndonjë intelektualit të respektuar, i cili nuk ka marrë parasysh edhe një motiv laik të deklaruar prej saj në disa raste: *“Për ne nuk ka rëndësi të cilës fe janë personat që u shërbejnë. Kriteri ynë i ndihmesës nuk bazohet në besimin e njerëzve, por në nevojat e tyre.”*<sup>10</sup>

Gjithsesi, nuk është qëllimi i këtij kumti të gjykojë marrëdhëniet e institucionit të Nënë Terezës me besimin e saj, për të cilin ajo pohonte: *“Do të isha e gatshme të hiqja dorë nga jeta ime, por jo nga besimi im”*.<sup>11</sup> Unë dua vetëm të sqaroj se veprimtaria dhe teoritë e Nënë Terezës, sado që nuk mund të shqyrtohen pavarësisht doktrinë sociale të Kishës, në këndvështrimin sociologjik nuk mund të jenë një perde ndarëse për intelektualët shqiptarë, sepse, në krahun tjetër, individualiteti i veprimtarisë dhe i mendimit të

Nënë Terezës i tejkalon shumë herë praktikën e Caritas-it dhe rezultatet e doktrinë sociale të Kishës prej nga rrjedh Caritas-i, për të mos thënë se Caritas in Veritate, doktrina më e re sociale e Vatikanit, që për shumë teoricienë e përfron atë me teoritë më të fundit ekonomike të një “shteti social”<sup>12</sup>, ka marrë prej veprimtarisë dhe ideve të saj<sup>13</sup>, kur thoshte: *“Nuk kemi të drejtë të gjykojmë të pasurit. Nga ana jonë, ajo që dëshirojmë nuk është një ndeshje klasore, por një takim që të pasurit të shpëtojnë të varfrit dhe të varfrit të shpëtojnë të pasurit.”*<sup>14</sup>

## Përfundim

Mund të argumentohet edhe më gjerësisht se muret do të jenë realisht të shembura kur mendimi sociologjik shqiptar të bëjë objeksion parësor veprimtarinë e Nënë Terezës dhe mendimin e saj, duke zbuluar në të universalitetin dhe atë që është e dobishme për shoqërinë e sotme shqiptare. Dhe këto mure duhet të fshihen tani. Në këtë pikë, për simbolikën e imperativit *tani* të “rënies së Murit të Berlinit, rasti shqiptar”, dua të përfundoj me një sentencë filozofike të vetë Nënë Terezës: *“Dje është tanimë e shkuar dhe nesër do ende kohë që të vijë. Mua më intereson vetëm e tanishmja. Dhe sot shoh njerëz që po vdesin, duhet t'i ndihmoj që të jetojnë. Nëse nuk i ndihmoj sot, ata vdesin.”*<sup>15</sup>

<sup>10</sup> Po aty, fq. 119.

<sup>11</sup> Po aty, fq. 11.

<sup>12</sup> Cardinale Angelo Scola, “Crisi, occasione per un nuovo welfare”, ZENIT.org. - sabato, 1° novembre 2009

<sup>13</sup> Pranay Gupta “Voice For the Poor”

[http://209.85.229.132/search?q=cache:06\\_KVgclDtwJ:www.cyberindian.com/mother-teresa/special-voice-of-poor.php+mother+teresa+social+justice&cd=1&hl=en&ct=clnk](http://209.85.229.132/search?q=cache:06_KVgclDtwJ:www.cyberindian.com/mother-teresa/special-voice-of-poor.php+mother+teresa+social+justice&cd=1&hl=en&ct=clnk) “They will cogitate over policy, and they will issue grave commentaries on sustainable development. They might do better to study how one small woman, in a simple white cotton sari, didn't bother much with reports and theories; instead, she simply went out into the world and changed the lives of millions.”

<sup>14</sup> “Me shumë dashuri - mendime të Nënë Terezës”, përkthyer në shqip nga Laureta Çobani, botim dygjuhësh: shqip-italisht, TOENA, Tiranë, 2003, f. 142.

<sup>15</sup> Po aty, f. 66.

# EDUKIMI GJINOR

## NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Ma. Ermioni CEKANI - *Instituti i Sociologjisë*

### ABSTRAKT

Ky punim ka si objekt vlerësimin e ndryshimeve që ka pësuar arsimit parashkollor në vite, analizon mënyrën si është realizuar deri tani dhe si mund të bëhet ndryshe edukimi gjinor në arsimin parashkollor. Me këtë rast, do të përpikemi të bëjmë një analizë të modeleve alternative të edukimit për të parë se si realizohet edukimi gjinor gjatë veprimtarisë mësimore-edukative, rolet gjinore dhe trajtimi i fëmijëve nga edukatorët, mjetet didaktike dhe materialet mësimore që përdoren në arsimin parashkollor, përbërja e personelit mësimor dhe ndihmës, si dhe ndikimi i tyre në krijimin e stereotipave gjinore.

### Hyrje

Disa psikologë dhe sociologë, zhvillimin e njeriut nga dita që lind e deri sa vdes e krahasojnë me një ndërtesë dh-

jetëkatëshe, ku tetë katet e para hidhen deri në moshën gjashtë vjeç.<sup>16</sup> Ky krahasim domethënës na bën të kuptojmë rëndësinë e madhe që ka mosha parashkollore për formimin dhe rritjen e individit të lirë dhe

**Ermioni Cekani**, anëtare e Institutit të Sociologjisë, është specialiste e shërbimeve sociale në Bashkinë e Tiranës. Është mastër në mësuesi dhe pedagoge me kohë të pjesshme në lëndën “Sociologjia e arsimit” në Universitetin “Kristal”. Është autore e shtatë librave metodikë, botime të Institutit të Sociologjisë dhe Shtëpisë botuese “Polis”, që janë: “Libri i mësueses së arsimit parashkollor”, “Fletore vlerësimi (grupi i parë, i dytë dhe i tretë)”, “Teste për mua (grupi i parë, i dytë dhe i tretë)”, “Mësime e lojëra inteligjente”, “Veprimtari praktike sipas fushave të zhvillimit”, “Mësojmë shkronjat një nga një – Abetare për fëmijët parashkollorë” dhe “Metodika për mësueset e arsimit parashkollor”.

<sup>16</sup>. Standardet e Përmbajtjes në Arsimin Parashkollor, ribotim, Tiranë 2005, botim i Institutit të Kurikulës dhe Standardeve, f. 3.

të përgjegjshëm, sepse duhet ta kemi të qartë që fëmijëria e hershme nuk mund të shkëputet nga i gjithë procesi i arsimit të individit në vitet që pasojnë.

Arsimi parashkollor është një shërbim që u ofrohet fëmijëve të moshës 3-6 vjeç dhe ka si objektiv kryesor *socializmin e tyre*, duke mbështetur, mundësuar e lehtësuar zhvillimin e gjithanshëm. Kopshtet, si niveli i parë i arsimit, përbëjnë një objekt të rëndësishëm për kërkime të ndryshme shkencore, ku fëmijët konsiderohen si individë që janë pjesë e një sistemi edukativ kompleks. Thënë ndryshe, procesi i edukimit në arsimin parashkollor ka si qëllim të realizojë një përvojë dhe mënyrë edukimi të veçantë e personale për çdo fëmijë dhe për çdo grup fëmijësh.

Konferenca e Jomtienit, që u mbledh në vitin 1990, arriti në përfundimin se, nëse bota dëshiron të realizojë objektivat e Arsimit për të Gjithë, fëmijëria e hershme (3-6 vjeç) është pikërisht mosha më kritike për të ndërhyrë. Duke pasur parasysh aftësitë e jashtëzakonshme të të nxënit në këtë moshë, fëmijëria e hershme vlerësohet si guri i themelit për reformën arsimore dhe aktualisht përbën *objektivin e parë* në kuadrin e 6 objektivave të përcaktuara në nismën botërore Arsim për të Gjithë. Ka ardhur koha që arsimi parashkollor të mos ketë vetëm një rol ndihmës, sepse *ndërhyrja cilësore në fëmijërinë e hershme ka një normë të lartë kthyeshmërie në gjithë sistemin e arsimit të detyrueshëm dhe për të gjithë personat që përfitojnë nga kjo ndërhyrje*.<sup>17</sup>

Një studim i bërë në ShBA, ka treguar se, në moshën 27-vjeçare, për çdo dollar të investuar në arsimin parashkollor, kthyeshmëria e përllogari-

tur sipas disa aspekteve është 7.16 USD, ndërsa në moshën 40 vjeçare shkon deri në 12.90 USD.

Përvoja botërore e dekadave të fundit ka nxjerrë në pah rëndësinë e viteve të para të jetës (a) në aspektin e zhvillimit optimal fizik, psikologjik dhe social të fëmijës, (b) në aspektin e përfshirjes së potencialit të femrës në zhvillimin e shoqërisë dhe (c) për faktin se kombinimi i këtyre dy faktorëve ka ndikim të pazvëndësueshëm në luftën kundër varfërisë.

### Elemente të edukimit gjinor në arsimin parashkollor

Ashtu si kemi thënë edhe më lart, vitet e fëmijërisë së hershme - që përmbledhin periudhën nga 0-6 vjeç - përbëjnë njërin nga periudhat më të rëndësishme për zhvillimin e njeriut. Gjatë këtyre viteve fëmija formon personalitetin e tij, zhvillon aftësitë sociale, zhvillon të folurit, të menduarit etj. Këto realizohen si në familje, në komunitetin ku fëmija bën pjesë, por sidomos nëpërmjet programeve që zhvillohen në arsimin parashkollor. Nga mënyra se si paraqiten rolet gjinore në programet e këtyre grupmoshave, varet në një masë të madhe edhe përfytyrimi që do të krijojnë fëmijët për të ndërmarrë rolin e tyre në shoqëri në të ardhmen. “Përgjithësisht është pranuar se socializmi i roleve gjinore fillon në familje dhe se kopshti dhe shkolla nëntëvjeçare e vazhdojnë këtë proces duke luajtur një rol të rëndësishëm për ndërtimin e përkatësisë gjinore përmes mënyrave të organizimit të praktikave të tyre... Njëkohësisht, media dhe ndërveprimi me fëmijë të tjerë kontribuojnë në mënyrë të dukshme në procesin e socializmit.”<sup>18</sup>

<sup>17</sup>. Shtojcë e *Strategjia Kombëtare e Arsimit për zhvillimin e integruar të fëmijërisë së hershme në Shqipëri*, A. 6.2 – Rëndësia e fëmijërisë së hershme, faqe 2.

<sup>18</sup>. Measor dhe Sikes, 1992 – *Integrimi gjinor në arsim*, Botim i qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë 2004.

Nëse do t'i bënim një analizë çastit të parë kur diskutohet për ekzistencën e një fëmije ende pa u bërë i qartë seksi i tij, që këtu vihen re ndarjet gjinore. Ndërsa, po t'u referoheshim zakoneve dhe traditave në vendin tonë, do të vërenim se që në fillim bëhet urimi: "Me një djalë!" Edhe pse mendësia e të paturit të një djali për trashëgimtar tanimë duket se ka pësuar një lloj përthyerjeje, gjithsesi ajo vijon të mbetet ende një ide e ngulët. Prirja për nga mashkullorësia, që më së shumti ka ardhur si rrjedhojë e faktorëve historikë, ekonomikë dhe socialë, haset edhe në krijimtarinë gojore të popullit, kur bëhet fjalë për fëmijën që pritet të lindë. U ndalëm jo rastësisht te parapëlqimi gjinor në shoqërinë dhe familjen tradicionale, por për të nënvizuar idenë se edhe në ditët e sotme kanë një ndikim të dukshëm forca dhe inercia e "normave kulturore" të trashëguara nga e kaluara. Natyrisht, ka shumë norma të tilla në shoqërinë shqiptare, të cilat, ngaqë kanë ndikim të fortë, marrin edhe trajtën e rregullit apo të masës kur bëhet fjalë për përkatësinë mashkull-femër, duke filluar me sjelljen, mënyrën e veshjes, marrëdhëniet me të tjerët, paraqitjen në publik etj.

Si rregull, këto "norma kulturore" ushtrojnë tryzni dhe kërkojnë të bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar në jetën sociale dhe në stereotipet gjinore të përditshme. Shpesh, për fat të keq, falë mjedisit familjar apo mikromjedisit, ato zënë vend edhe në psikologjinë, vetëdijen dhe mentalitetin e fëmijëve. Pra, që herët ushqehet ideja e dallimit thelbësor lidhur me përkatësinë gjinore. Po sjellim një shembull. Që në çastin kur merret vesh seksi i fëmijës, prindi përgatitet për një lloj ndryshimi apo dallimi, që nis me ngjyrën e rrobave që do të përgatiten: rozë për vajza dhe bojë qielli për djemtë. Por dallimet midis meshkujve dhe femrave vijnë duke u theksuar me kalimin e viteve dhe varen në një masë të madhe nga qënd-

rimet që mbajmë ndaj të dyja seksëve, nga toleranca në lidhje me sjelljen e tyre etj. Këto probleme krijohen dhe vijnë duke u thelluar akoma më shumë në vitet e kopshtit, duke qenë se këto janë vitet kur "zë rrënjë" formimi i tyre, pa anashkaluar këtu edhe familjet dhe mjedisin social ku rriten këta fëmijë. Përvoja na tregon se pabarazia gjinore shfaqet edhe në arsimin parashkollor. Dhe nuk vërehet vetëm te mënyrat e sjelljes dhe këndvështrimit të fëmijëve të këtyre grupmoshave, por edhe në përmbajtjen e *programeve* që zbatohen apo edhe te *mësueset*.

Pra, si padashur, krijohen "standarde" dhe "norma" të sjelljes dhe qëndrimit femëror, të sjelljes gjinore, që së bashku përbëjnë "idenë" dhe "modelin" mbi-zotërues që shoqëria ka për femrën dhe femëroren. Më pas, këto "norma" apo "zakone" kanë ndikim të fortë në deformimin e realitetit social, që e marrin fillësën e vet te mënyra e sjelljes që në shtëpi apo në kopsht, që në rastin tonë përbën mjedisin social.

1. Do të ishte mirë që *mësueset* e arsimit parashkollor vazhdimisht të reflektonin dhe ta vlerësonin pozicionin e tyre në punë përmes qëndrimit që duhet të mbajnë në lidhje me fëmijët në kopsht. Por, gjithsesi, ende nuk mund të pritet shumë prej tyre, nisur nga fakti i thjeshtë se ato kanë pak njohuri për integrimin gjinor në sistemin arsimor në përgjithësi e për sistemin parashkollor në veçanti. Megjithatë përfshirja e elementeve të përkatësisë gjinore në arsimin parashkollor paraqitet më mirë se në nivelet e tjera të arsimit, përsëri ka ende punë për të bërë. Ndaj dhe kërkohet shumë më tepër ndërhyrje si në nivel politikash, institucionesh, botimesh por edhe një lloj vetëdijesimi të të gjithë aktorëve që kanë rol dhe ndikim te fëmijët e kësaj moshe. Është fakt se edukatorët e kanë të vështirë ta pranojnë ndryshimin e rolit dhe pozi-

cionit të tyre. Ndërkaq, të gjithë e dimë që figura e mashkullit (ashtu si dhe e femrave) është e pazëvendësueshme për këtë grupmoshë, por në arsimin parashkollor nuk gjejmë asnjë burrë në rolin e mësuesit. Dhe jo vetëm mësues, por as drejtues, kuzhinierë etj. Për fëmijët, në këtë periudhë vendimtare të formimit të tyre, do të ishte mirë edhe përvoja dhe angazhimi i një mësuesi. Përderisa në ciklin e ulët ka pasur dhe ka mësues, atëherë kjo mund të korrigjohet dhe të vendosen mësues edhe në arsimin parashkollor. Pra, nuk ka pse të mos themi se *ka ardhur koha që edhe në arsimin parashkollor të zërë vend figura e mësuesit ose drejtuesit.*

Nëse do t'i referoheshim *Raportit Vjetor Statistikor të Arsimit, 2006 – 2007*, botim i MASH, do të vinim re se në arsimin parashkollor japin mësim dhe janë në role drejtuese gjithsej 3 564 edukatore (femra) dhe asnjë edukator (mashkull).

emigrimit apo migrimit të popullsisë, nuk mund të kemi një shifër të saktë të frekuentimit të këtij niveli arsimit nga vajzat dhe djemtë. Kjo e dhënë, për arsimin parashkollor, mungon edhe në *Raportin Vjetor Statistikor të MASH.*

2. Po të analizonim me hollësi *programin* që zbatohet gjatë veprimtarisë mësimore-edukative në arsimin parashkollor, *mjetet dhe materialet* që përdoren gjatë zhvillimit të saj, do të vinim re se këto transmetojnë “mesazhe” të dukshme ose të padukshme, duke iu krijuar idenë vajzave dhe djemve se ka fusha ku ata mund të jenë ose mund të mos jenë të suksesshëm. Dhe kjo vetëm për shkak të përkatësisë së tyre gjinore. Gjatë analizës, hasen elemente që tashmë janë bërë stereotipe dhe janë të pranishme në arsimin parashkollor. P.sh., dita në kopsht fillon me ngrënien e mëngjesit dhe, zakonisht,

**Tabela 1:** *Numri i edukatoreve*

| Nr. i edukatoreve/<br>drejtuesve gjithsej | Nr. i edukatoreve/<br>drejtueseve femra | Nr. i edukatorëve/<br>drejtuesve meshkuj |
|-------------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------------------------|
| 3 564                                     | 3 564                                   | 0                                        |
| 100 %                                     | 100 %                                   | 0 %                                      |

Burimi: Raporti Vjetor Statistikor i Arsimit, 2006-2007, botim i MASH

Ashtu siç shihet edhe nga tabela dhe grafiku i mësipërm, e veçanta në arsimin parashkollor është se 100 % e edukatoreve janë femra, raport ky që nuk vihet re në asnjë nga nivelet e tjera të arsimit.

Nëse do të kishim të dhëna të sakta për numrin e popullsisë në përgjithësi dhe për numrin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, të ndarë në femra dhe në meshkuj, atëherë do të mund të analizonim (duke u bazuar në shifra), frekuentimin apo regjistrimin e vajzave dhe djemve në arsimin parashkollor, si një element i edukimit gjinor në këtë nivel arsimimi. Por edhe për shkak të

si kujdestare të ushqimit mësueset zgjedhin vajzat, të cilat kanë për detyrë të shtrajnë tryezën, ta pastrojnë atë, ta vendosin çdo gjë në vendin e vet pas përfundimit të ushqimit etj.

Dhe po ashtu, djemtë zakonisht zgjidhen “komandantë”. Për të vijuar më tej: te këndi i konstruksionit luajnë djemtë, ndërsa këndi i kuzhinës dhe ai i kukullave është “pronë” e vajzave. Nëse ndonjë djalë do të shkojë të luajë me kukulla, shpesh mësueset janë të parat që i thonë: “Ti je djalë dhe një djalë nuk luan me kukulla”. Këto dhe të tjera si këto, të përsëritura

shumë herë në familje, në mjedisin social ku fëmijët jetojnë dhe në kopsht, krijojnë një stereotip gjinor të caktuar dhe ndikojnë në zgjedhjet e mëvonshme, qoftë të djemve apo të vajzave. Stereotipet gjinore formohen te fëmijët që në moshën 3-5 vjeçare, sepse të gjithë e dimë që fëmijët 3, 4 apo 5-vjeçarë përpiqen ta modelojnë sjelljen e tyre në përshtatje me atë të të rriturve me të cilët jetojnë dhe reagojnë në përshtatje me atë se çfarë presin prindërit e tyre nga ata. Çdo ditë, në jetën e përditshme, ata ndeshen me dukuri të tilla, si: vajzat shpesh nxiten të mësojnë të bëjnë punë shtëpie dhe të kujdesen për të tjerët duke ndihmuar nënat, ndërsa djemtë në të njëjtën kohë nxiten të merren me sporte apo aktivitete të tjera, të shoqërojnë baballarët jashtë shtëpisë etj. Pra, në këtë moshë e më tej vajzat nxiten të jenë më pasive se meshkujt, si në shtëpi ashtu dhe në kopsht. Shpesh dëgjojmë mësuese që thonë: “Mos u hidh ashtu, se nuk je çun”. Apo “Kështu veprojnë vajzat?” Ky pasivitet që kultivohet te vajzat, më vonë mund të shfaqet si *mungesë aktiviteti, si varësi ndaj të tjerëve apo si mungesë interesi*. Dhe kështu krijohet përshtypja se femrat janë më pasive se meshkujt e kjo ndikon pastaj gjatë gjithë jetës së tyre. Megjithatë vajzat ndryshojnë nga djemtë që në gjene, këto ndryshime thellohen më shumë gjatë viteve të para të jetës. Shpeshherë, si në familje, po ashtu dhe në kopsht, agresiviteti i djemve justifikohet me fjalët: “Fundja, ai është djalë”. Ndërkaq, frika te një djalë nuk mund të tolerohet dhe atij i thuhet: “Ti nuk je vajzë!” Pra, që në këtë moshë djemtë nxiten që të jenë të fortë emocionalisht dhe kur një djalë i shpreh emocionet e tij duke qarë, menjëherë ndërhyjnë edukatorja duke i thënë: “Ti nuk je qaraman si vajzat”. Në të kundërt, nëse një vajzë i shpreh emocionet e çastit duke qarë, kjo është e pranueshme, ngaqë ato janë më të buta, “nuk dinë gjë tjetër veçse të qajnë” etj. Kësisoj,

sjelljet e djemve modelohen drejt veprimeve të rrezikshme e të pallogaritura, për të treguar se nuk janë frikacakë. Ndërsa e kundërta duhet të ndodhë me vajzat, të cilat, kur munden, do të tërhiqen, sepse ato “janë vajza”.

Këto devijime në sjellje ndikojnë në formimin e personalitetit të fëmijëve, çka sjellin edhe ndryshime në fushën e komunikimit. Dhe të gjitha këto për shkak të *edukimit të diferencuar gjinor*, të nxitur që në kopsht.

Për të parë se si veprohet në arsimin parashkollor dhe se si realizohet edukimi gjinor, do të përpiqemi të analizojmë programin që zbatohet në kopshte, si dhe praktikën e përditshme të aktiviteteve mësimore-edukative. Më poshtë po japim një vjershë, që mësohet në grupin e dytë me fëmijë të moshës 4-5 vjeç për zhvillimin e tyre gjuhësor:

Një të diel në mëngjes,/ lau Albana sytë e zes,/ lidh shaminë, ve një futë,/ ngjan tamam si një mama./ Si një flutur punët nis,/ bën pastrimin e shtëpisë,/ lan, fshin e shkund, /s’le një pluhur asgjëkund. /Hyn dhe Beni me nxitim, / me këpucët mbi qilim,/ vjen e shkon e shkon e vjen,/ kërkon topin por s’e gjen./ I thotë motra: - Ki kujdes, /eja merr dhe ti një fshesë./ Qeshi Beni: ha,ha,ha,/nuk më sheh? Unë jam baba.

Në këtë vjershë duket qartë roli i deshtuar gjinor i Albanës (të fshijë, të lajë, të marrë pluhurat, madje duke vënë edhe shaminë e përparësen: *ngjan tamam si një mama*) dhe i Benit (të luajë me top, të shkelë me këpucë mbi qilim dhe, si përfundim, ai është... *një baba*).

Ose një këngë për fëmijët e grupit të tretë, që thotë: “*Të shoh në ekran,/ të shoh në stadium,/ forca babi im, /me ty mburrem unë...*”

Po vazhdojmë më tej me programin e zhvillimit gjuhësor të fëmijëve të grupit të parë: “*Kush tha se jam e vogël,/ dhe s’ditkam të bëj punë,/ ja, prisni të lidh flokët,*

/ të vë përparësen unë./ Kur nis të fshij kuzhinën,/ /te çezma fshesën laj,/ pastaj me një leckë,/ /gjithë pluhurat i marr./ Mbi tavolinë kurrë,/ /s'harroj të ve dhe lule,/ /kush tha se jam e vogël/ dhe s'ditkam të bëj punë?"

Këto janë elemente të stereotipeve në përkatësinë gjinore, të cilat formohen pak e nga pak që në grupmoshat 3-6 vjeç.

Por, përveç vjershave (dhe të tjera si ato) që përmendëm më sipër, në arsimin parashkollor, fëmijëve u mësohen edhe vjersha të këtij lloji: *"Unë dhe motra në shtëpi,/ punët kurrë nuk i ndajmë,/ bashkë krevatat rregullojmë,/ edhe enët bashkë i lajmë./ Unë me fshesë fshij shtëpinë,/ ajo me leckë pastron,/ kur unë lyej këpucët,/ ajo mamin e ndihmon."* Ashtu siç kuptohet nga teksti i kësaj vjershe, rolet gjinore nuk janë të ndara, të përcaktuara.

Ndërsa, po të analizojmë figurat e fletoreve që përdoren në arsimin parashkollor, vihen re pak dallime gjinore. Në përgjithësi rolet gjinore të djemve dhe vajzave janë të shkrira, por përsëri, nëse do të shikonim me vëmendje "Librin e parashkollorëve" për grupin e dytë, në faqen 4, tek tema "Miq të rinj", në të dyja figurat, lodrat janë ndarë: djemtë kanë në dorë topa, ndërsa vajzat kukulla. Kjo e thekson dallimin gjinor midis tyre, përveç veshjes, që e bën të qartë se cilët janë djemtë në figurë e cilat janë vajzat. Ndërsa e njëjta fletore, por për grupin e parë, në faqen 8, tek tema "Mjetet e komunikacionit, lëvizja drejtvizore", shoferi i makinës është burrë, ndërsa pasagjerët janë edhe djem, edhe vajza. Ndërsa te fletorja për parashkollorët e grupit të tretë, "Vepërimtari gjuhësor", në faqet 8-9, tek tema "Sa na pëlqejnë lojërat me top!", të gjitha figurat që ilustrjnë këtë temë tregojnë djem që luajnë me top lojëra të ndryshme.

Po kështu, në arsimin parashkollor përdoren edhe kartolina për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve sipas grupmoshave. Në bazë të figurave që paraqiten atje, bisedohet midis edukatoreve dhe fëmijëve dhe

përveç zhvillimit të të folurit, krijohen koncepte të reja. Nëse do t'i analizojmë me kujdes kartolinat, do të vinim re se në to janë të ndara në mënyrë të qarta rolet gjinore. P.sh., vetëm gra duke vjelë rrushin ose domate; një gjysh që lexon gazetën ose që ngrohet; një gjyshe që bën triko ose gatuan gjellën; një babi marangoz ose traktorist; një vajzë që shtron tryezën; një mami që kujdeset për beben etj.

Në modelin edukativ të Rexhio-Emilias, analizuar projektin "Ne dhe toka", të realizuar me fëmijët e grupit të tretë, 5-6 vjeçarë, në kopshtin nr. 39 në Tiranë. Një nga pikat e projektit ishte: *Identiteti i planetit tonë*. Shumë interesante janë këndvështrimet e fëmijëve, që ndryshojnë nga djemtë tek vajzat dhe ndihet ndikimi i stereotipeve gjinore të krijuara në familje, në kopsht ose në mjedisin social ku jetojnë. Ja si shprehen ata për tokën - shoqëruar me vizatimet përkatëse.

Fabio: Ngaqë toka është më e madhe, ajo është gjysmë djalë e gjysmë vajzë.

Mateo: Është djalë, se ka ngjyrat e djemve.

Laurenti: Është çun, se ka dete e male.

Dea: Mund të jetë edhe vajzë, se ka lule.

Fertili: Toka është djalë, sepse rrotullohet, nuk rri në vend.

Po të analizojmë me kujdes përgjigjet e tyre, djemtë mendojnë se *toka është djalë* meqenëse ka më shumë dete e male (ngaqë detet e malet janë të forta si djemtë). Ndërsa vajzat, meqë në tokë ka edhe lule (që janë të buta si vajzat) atëherë *mund të jetë edhe vajzë*.

Këtu shihet qartë ndikimi i edukimit gjinor edhe në arsyetimin e fëmijëve të kësaj grupmoshe.

## Rekomandime

Nga kjo analizë e programeve dhe e materialeve didaktike që përdoren në arsimin parashkollor, dalim në përfundimin se: *prindërit dhe edukatorët kanë nevojë të mësojnë t'i trajtojnë fëmijët mbi bazën e dal-*

*limeve individuale dhe jo mbi bazën e dallimeve gjinore të paragjykuara.* Kjo gjë vjen nga mungesa e njohurive të prindërve dhe edukatoreve për çështje të përkatësisë gjinore. Për të ndryshuar këtë situatë, lipset të ndërtojmë strategji duke vlerësuar më parë situatën, duke bërë trajnime të edukatoreve dhe prindërve për probleme të edukimit gjinor, duke shpërndarë informacion nëpërmjet fletëpalosjeve, postereve, literaturës etj. Më tej, edukatorët duhet të qartësojnë dhe të thellojnë kuptimet

e koncepteve themelore në lidhje me përkatësinë gjinore dhe zhvillimin në arsim. Pra, të vetëdijesohen në lidhje me integrimin gjinor në arsim, duke ofruar metoda dhe strategji për të lehtësuar përfshirjen e perspektivës gjinore në programet mësimore-edukative. Dhe, që të realizohen të gjitha këto, edukatorët kanë nevojë për më shumë informacion, të cilin, përveç literaturës përkatëse, mund ta plotësojnë me trajnime nga specialistë të fushës së edukimit gjinor.

## REFERENCAT

- Standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor*, Tiranë 2002.
- Standardet e arritjes në arsimin parashkollor*, Tiranë 2004.
- Strategjia kombëtare e zhvillimit të arsimit parauniversitar 2004- 2015*, Tiranë, qershor 2004.
- Arti i rritjes së fëmijëve*, UNICEF dhe Ministria e Shëndetësisë, Tiranë 2005.
- Zhvillimi i fëmijërisë së hershme në Shqipëri*, Qendra e Zhvillimit Human & Save the Children, 2002
- Psikologjia e prindërve*, kapitulli VI.
- Integrimi gjinor në arsim*, botim i Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, 2004.
- Paketë burimore mbi përkatësinë gjinore. Për mësuesit e ciklit fillor*, botim i Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, 2007
- Përkatësia gjinore dhe zhvillimi. Koncepte të avancuara*. Publikim i Qendrës së Gruas.
- Integrimi gjinor*. Praktika dhe perspektiva, botim i Qendrës së gruas, Tiranë 2002.
- Raporti Vjetor Statistikor i Arsimit, 2006-2007*, botim i MASH

# FAMILJA SHQIPTARE DHE EVOLUIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR MBI FAMILJEN

Rudina HOXHA - *Universitetit "Aleksandër Moisiu" i Durrësit;*  
*Instituti i Sociologjisë*

---

Familja ballkanike, që ruan tipare kryesisht të pandryshueshme deri në fillimet e shek. XX, konsiderohet si një lloj i veçantë i familjes që ndryshon edhe nga strukturat komplekse të familjes së Europës Lindore, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria.

E drejta zakonore në vendin tonë ka luajtur rolin e një rregullatori në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore ndërmjet individëve. Ajo në literaturë përcaktohet si *tërësi e normave (rregullave të sjelljes) të pashkruara*, të përcjella në marrëdhëniet që buronin nga martesja e gjinia, si ato midis prindërve e fëmijëve dhe ndërmjet pjesëtarëve të tjerë të familjes, tradita gojore nga një brez në tjetrin e që kanë shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike e në fusha të ndryshme të jetës shoqërore.

Megjithëse ishte e tipit feudal dhe kishte natyrë të dyfishtë, ajo ishte një e

drejtë popullore e pashkruar, që ishte përcjellë nga një brez në tjetrin nëpërmjet traditës gojore, çka u jepte njëfarë mbrojtjeje shtresave të ulëta të popullsisë. Kjo e drejtë vepronte në një shoqëri me lidhje të forta fisnore. Struktura bazë e saj ishte familja, zgjerimi i së cilës përbënte vëllazërinë dhe disa prej tyre së bashku përbënin fisin. Në funksionimin e së drejtës zakonore në vendin tonë kanë ndihmuar organe të vetëqeverisjes, si: kuvendet, pleqtë, këshillat etj. Parimet që e kanë udhëhequr të drejtën zakonore shqiptare dhe kanunet që e kanë përfaqësuar atë kanë qenë: barazia e njerëzve nga gjaku, nderi vetjak e shoqëror, burrëria, besa, mikpritja etj.

Tiparet kryesore të së drejtës zakonore shqiptare janë konservatorizmi dhe partikularizmi i saj. Kjo e drejtë ka karakter konservator, si rrjedhojë e ekzistencës për një kohë të gjatë e marrëdhënieve patri-

**Rudina Hoxha**, anëtare e Institutit të Sociologjisë është master në sociologji si dhe pedagoge pranë departamentit Sociologji-Filozofi në Fakultetin e Edukimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" të Durrësit. Ajo është lektore e lëndëve "Sociologji", "Histori e qytetërimi", "Filozofi" "Sociologji e edukimit" dhe "Studime gjinore", në Universitetin e Durrësit, në Universitetin e Tiranë etj.

arkale-fisnore, në të cilat është sanksionuar pabarazia ndërmjet gruas dhe burrit në jetën familjare, shoqërore, ekonomike dhe politike. Tipari partikularist i kësaj të drejte zakonore shqiptare vërehet në ekzistencën e kanuneve të ndryshme, që kanë rregulluar jetën shoqërore në lokalitete të ndryshme, si: Kanuni i Lekë Dukagjinit, i Labërisë, i Skënderbeut, i Maleve etj.<sup>19</sup>

Familja patriarkale, si bërthama e gjithë strukturave më të mëdha shoqërore, shfaqet si dukuri historike e shoqërore. Ajo shfaqet me lindjen e pronës private dhe zhvillohet e forcohet në varësi të marrëdhënieve në prodhim, që bazohen në pronën private. Te iliro-shqiptarët, familja patriarkale ka ekzistuar në shekuj, qysh nga koha e bronzit, kur lindi së pari familja monogame, e deri në shekullin XX. Jetëgjatësia e familjes patriarkale te shqiptarët shpjegohet me vendin që kanë zënë bujqësia dhe blegtoria në ekonominë e tyre dhe me kushtet e veçanta historike. Kjo formë ka qenë tipike te shqiptarët deri në Luftën e Dytë Botërore, sepse pas kësaj periudhe kemi ndryshime në rendin ekonomiko-shoqëror.

Në të drejtën zakonore shqiptare familja patriarkale paraqitet jo vetëm si dukuri historike në zhvillimin e saj dialektik, por edhe si njësi themelore e organizimit shoqëror. Ajo kishte disa tipare. Ishte një bashkësi njerëzish *me lidhje gjaku në një mashkullore* (patrilineale) ose të bashkuar me anë martesë. Familja patriarkale shqiptare kishte një *ekonomi të përbashkët*, ku ajo karakterizohej prej një organizimi të brendshëm dhe punët në familje ishin të ndara sipas aftësive të gjithsecilit. Denich e përcakton një shoqëri të tillë si shoqëri patricentrike, thelbi kryesor i së cilës ishin lidhjet agnatike përmes burrave.<sup>20</sup> Pra, një familje ku në qendër të saj ishte

babai dhe që funksiononte në bazë të lidhjeve të gjakut përmes burrave.

Me familje - sipas së drejtës zakonore familjare që vepronte në Labëri, Dukagjin e në krejt Shqipërinë - kuptohet ajo bashkësi njerëzish të lidhur ndërmjet tyre me gjak ose me martesë, si dhe persona të tjerë që nuk kishin lidhje gjaku, po që jetonin së toku me një bazë ekonomike të përbashkët, të bazuar në pronën private dhe që mbështeteshin në marrëdhëniet ekonomike, morale e juridike me karakter patriarkal.

E drejta zakonore i njihte tagra të shumta kryefamiljarit. Pushteti dhe tagrat e tij shpreheshin para së gjithash në të drejtën ekskluzive të pronës, sepse vetëm ai kishte të drejtë ta blinte e ta shiste tokën, bagëtinë ose çdo pasuri tjetër, me përjashtim të pasurisë së veçantë, ku hyjnë dhe dhuratat që kishte gruaja, si dhe të jepte e të merrte hua. Martesa ishte një marrëveshje që kishte një element thelbësor, që ishte shpërblimi për martesë, që familja e djalit ia jepte asaj të vajzës. Gjatë bisedimeve, me ndërmjetësinë e shkuesit, palët binin në ujdë për shumën që duhej të paguante pala e djalit. *Ky shpërblim përbën faktin më poshtëruar të pozitës inferiore dhe nënshtrimit të gruas në marrëdhëniet familjare dhe skllavërimit të saj në familjen patriarkale.*

E drejta zakonore rregullonte edhe marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve pas martesës. Këto marrëdhënie ndaheshin sipas të drejtës zakonore familjare, në parimin e mosbarazisë (ndërmjet burrit dhe gruas) dhe ishin marrëdhënie patriarkale. Me gjithë marrëdhëniet diskriminuese që vendoste ndërmjet burrit dhe gruas, e drejta zakonore shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve familjare dhe sho-

<sup>19</sup>. Për zhvillimin e kësaj pjese të punimit jam mbështetur në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe Labërisë.

<sup>20</sup>. Kera, Gentiana dhe Papa, Enriketa: Familja, feja dhe e drejta zakonore në Shqipëri deri në gjysmën e parë të shekullit XX, Rev. "Politika & Shoqëria", nr.1 (11), 2003, fq. 32.

qërore në vendin tonë në periudhën e Mesjetës, mbeturina të së cilës i gjejmë edhe sot. Në shek. XIX-XX, kur u regjistrua e drejta zakonore shqiptare, familja patriarkale e kishte kryer gjatë shekujve evolucionin e saj historik dhe gjendej në prapun e dekompozimit.

Familja shqiptare në vitet '20-'30 përshkohej prej të njëjtave tipare prej të cilave karakterizohej në periudhën e sundimit të së drejtës zakonore. Meqenëse kjo ka ekzistuar deri në fillim të shekullit të XX, shpesh i referohem Luftës së Dytë Botërore si kufi ndarës, por mbeturina të kësaj forme të familjes i gjejmë deri vonë. Tiparet e saj ishin të njëjta, si roli i madh i babait në familje, patriarkaliteti, patrilokaliteti, patrilinealiteti apo dhe karakteri ekzogam i saj. Gjatë viteve '20-'30, janë bërë thirrje të intelektualëve shqiptarë për ndryshimin e gjendjes së familjes shqiptare dhe ndryshimin sadopak të pozitës inferiore dhe skllavëruese të gruas në të.

Problematikë e viteve '30, e ngritur shpesh nga intelektualë të ndryshëm të kësaj periudhe me në krye Branko Merxhanin, doktrina e të cilit, neoshqiptarizma, ishte një mënyrë zhvillimi e shoqërisë që ndërthurte modernitetin me tradicionalen, pra një rrugë origjinale zhvillimi, që e bënte Shqipërinë moderne pa humbur identitetin vetjak. Merxhani e kërkon reformimin e shoqërisë të reformimi i familjes. Sipas tij, familja shqiptare është e kalbur dhe duhet ngritur mbi baza të reja. Këtë kalbje të shoqërisë dhe familjes ai e shihte në rivlerësimin e rolit të gruas në familje dhe shoqëri. Në Parlamentin e 1921, deputetët shqiptarë të kësaj kohe, sigurisht, të ndikuar prej vendeve më të përparuara europiane, kërkuan që të drejtat e gruas në familje, në fushën ekonomike, politike dhe shoqërore të sanksionoheshin në ligje të veçanta. Që

në seancat e para, qeveria i paraqiti Parlamentit një projektshtojcë të nenit 200, qëllimi i së cilës ishte që çështjet civile, që deri në atë kohë shqyrtoheshin prej zyrrave fetare, t'u kalonin gjyqeve civile shtetërore. Që në nenin e parë paraqitej se martesë duhej të regjistrohej në zyrat e gjendjes civile. Pas kryerjes së formaliteteve, çifti mund të kryente edhe ceremonitë fetare.<sup>21</sup>

Nga sa u paraqit më lart, arrijmë në përfundimin se diskutimi në Parlament i të drejtave e lirive të gruas në familje e shoqëri, pavarësisht nga kufizimet, patën shumë rëndësi, sepse çuan në hartimin dhe miratimin e rregullorëve për të drejtat e gruas dhe burrit në familje dhe për përmirësimin e pozitës së gruas në familje.

Më 1 prill 1929, hyri në fuqi Kodi Civil i Mbretërisë së Shqipërisë, që u hartua mbi bazën e kodeve më të përparuara të asaj kohe, si Kodi Civil francez i Napoleon Bonapartit i vitit 1804, Kodi Civil italian dhe ai zviceran. Ky kod çoi më tej legjislacionin për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Në Kodin Civil shpallej se gruaja kishte kapacitet të plotë civil, por nga ana tjetër, kjo e drejtë mbetej formale dhe kufizohej, sepse për të ushtruar një profesion ose industri (zanat), ajo duhej të merrte pëlqimin e burrit (neni 191 i KC). Në rast se burri nuk pranonte t'i jepte pëlqimin, çështjen duhej ta zgjidhte gjykata e paqit. Një hap pozitiv ishte ndalimi i poligamisë, ku burrit i ndalohej martesë me më shumë se një grua në të njëjtën kohë, e përcaktuar kjo në nenin 9 të Kodit Civil. Po ashtu, sanksionoheshin martesë civile e detyrueshme, duke caktuar edhe masa penale për mosbatimin e saj. Mosha e martesës ishte 18 vjeç për burrin dhe 16 vjeç për gruan. Mbreti mund të lejonte lidhjen e martesës për meshkujt deri në 15 vjeç dhe për va-

<sup>21</sup>. Musaj, Fatmira, "*Gruaja në Shqipëri (1912-1939)*," Rev. "Sfinga", nr. 7, bot. Prograf, Prishtinë, 2004, fq 273.

izat deri në 14 vjeç, me kusht që ta kishin dhënë pëlqimin e tyre prindërit dhe paraardhësit, sepse në të kundërt martesat nuk quhej e ligjëruar dhe individët konsideroheshin se jetonin nën një bashkëjetesë ilegale. Pra, siç vërehet, është bërë një hap mbrapa me uljen e moshës së vajzës për martesë, ku projektshojca 200 e miratuar në Parlamentin e vitit 1921 përcaktonte moshën 18 vjeç për djalin dhe 16 vjeç për vajzën. Ky kod lejonte zgjidhjen gjyqësore të martesës (shkurorëzimin) së shtetasve, pavarësisht nga përkatësia fetare.

Nëpërmjet parimit të monogamisë në martesë, që shënoi kalimin përfundimisht në epokën e martesës monogame, ky kod përbën një moment të rëndësishëm në abrogimin e poligamisë, që ishte një praktikë e njohur në martesat e popullsisë myslimane, për shkak të zbatimit të sheriatit<sup>22</sup>.

Në Kodin Civil të vitit 1929 rregullohen marrëdhëniet për institutin e fejesës, që shihej si mjaft i rëndësishëm, sepse ishte një hallkë që çonte drejt martesës, ndaj dhe prishja pa shkaqe e tij shkaktonte pasoja juridike. Pra, siç vërehet, me miratimin e këtij kodi janë hedhur edhe themelet e miratimit të legjislacionit në vend. Ky përbën një hap përpara për kohën, që ka të bëjë me përmirësimin e marrëdhënieve familjare dhe përmirësimin e pozitës së gruas në familjen patriarkale e të kohës, me gjithë kufizimet që mbarte ky kod në vetvete.

Kur Partia Komuniste e Shqipërisë erdhi në pushtet më 1944, ajo zyrtarisht shpalli luftën ndaj mentalitetit “reaksionar” patriarkal, skemave patriarkale të sjelljes dhe formave të jetës sociale. Megjithatë sapo erdhën në pushtet komunistët u përpoqën t’i shkatërronin strukturat dhe institucionet fisnore, ta largonin familjen prej zakoneve të vjetra e prapanike, prej traditave të peri-

udhës së mëparshme etj., ata nuk mundën të ndryshonin ideologjinë tradicionale të familjes dhe strukturave të saj. Shndërrimet në marrëdhëniet familjare në këtë periudhë kanë të bëjnë me shndërrimin e sistemit dhe të politikave. Megjithatë meriton vëmendje të veçantë barazia ndërmjet burrit dhe gruas, përkujdesja për nënën, krijimi i sistemit shëndetësor dhe arsimor. Familja ka pësuar ndryshime në këtë periudhë shoqërore, e cila, përgjatë këtij punimi paraqitet si një fenomen shoqëror që varet prej strukturave shoqërore, por edhe në marrjen e vendimeve, ajo ka një pavarësi relative.

Familja në periudhën socialiste nuk trajtohej si një institut thjesht privat, por si një institut shoqëror dhe lidhej ngushtë me funksionet e rëndësishme që duhej të kryente. Sipas materializmit historik, familja është një dukuri shoqërore dhe, si e tillë, ka pësuar ndryshime në përshtatje me fazat e zhvillimit historik. Karakteristikë dalluese e saj është simpatia dhe dashuria e ndërsjellë e anëtarëve të saj, ndershmëria, thjeshtësia dhe patriotizmi, bashkëpunimi shoqëror dhe ndihma për njëritjetrin, uniteti i interesave të të gjithë anëtarëve të saj me ato të shoqërisë, barazia e të drejtave të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me anëtarët e tjerë. Këto ishin ato çka propagandonte qeveria komuniste në pesëvjeçarën e parë të qeverisjes së saj. Për të zgjidhur çështjet familjare, pra që ato të zgjidheshin me pajtim ose të përmbushnin detyrimet ligjore në mënyrë vullnetare, ndërhynin këshillat popullore ose organizatat shoqërore, të cilat, nëpërmjet, aktivizimit të personave të zgjedhur, bënin përpjekje për parandalimin e mosmarrëveshjeve civile.

*“Gjithë ky interesim jo vetëm që s’do të thotë politizim i problemeve familjare, por, përkundrazi, zbërthim i mëtejshëm i*

<sup>22</sup>. Ligji më i lartë mysliman; njëri prej kushtetutë e myslimane e që rregullonte marrëdhëniet ndërmjet popullsisë.

*kujdesit të shtetit socialist e të shoqërisë për ruajtjen sa më të shëndoshë të qelizës bazë të shoqërisë, të familjes.*<sup>23</sup>

Kushtetuta e 14 marsit të vitit 1946 sanksionoi, ndër të tjera, edhe parimet më kryesore mbi të cilat do të ndërtohej e drejta familjare, si degë e re dhe e veçantë e së drejtës socialiste. Kjo Kushtetutë sanksionoi sërishmi *“barazinë e gruas me burrin në çdo fushë të jetës politike e shoqërore (neni 17), si dhe shpalli njëkohësisht se martesë dhe familja gëzonin “mbrojtjen e shtetit”, se e ligjshme ishte vetëm martesë që lidhej para organeve përkatëse të shtetit dhe se për shqyrtimin e zgjidhjen e të gjitha çështjeve që kishin të bënin me martesën ishin kompetente vetëm gjykatat shtetërore* (neni 19).

Mosha për martesë për të dy bashkëshortët e ardhshëm u caktua 18 vjeç dhe nuk kërkonte pëlqimin e prindërve. Vetëm për shkaqe të arsyeshme, gjykata mund ta lejonte martesën edhe para kësaj moshe. Pra, është bërë një hap përpara në legjislacionin e kohës për barazinë në moshë të burrit dhe gruas të parashikuar në Kodin e mëparshëm Civil - 18 vjeç për djalin dhe 16 vjeç për vajzën. Ky unifikim në moshën e të dyve kryhej për përmbushjen e politikës së kohës për barazi ndërmjet burrit dhe gruas dhe madje ka qenë shkaku themelor për unifikimin e moshës për martesë.

Në nenin 17 të saj, shpallej se *“gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe shoqërore”*. Gruaja ishte e dyzuar ndërmjet punës dhe familjes. E përkthyer ndryshe, ajo gjendej ndërmjet dy fronteve dhe i duhej t’u përgjigjej më së miri të dyve. Duke u përpjekur të ishte e zonja në të dy pozicionet, roli i nënës në familje u reduktua duke qenë se sistemi i punës me tri turne bëri që ajo të shndërrohej në “gruan e mashk-

ullarizuar”. Por, në anën tjetër, roli që ajo luante në familje u reduktua funksionet që kishin të bënin me përkujdesjen e fëmijëve, që i përmbushte familja, tashmë kryheshin prej institucioneve të specializuara, si çerdhet, kopshtet dhe arsimit 8-vjeçar i detyrueshëm.

Një normë tjetër e moralit komunist dhe e një tradite të lashtë familjare shqiptare gjen shprehjen e vet në nenin 8 të Kodit të Familjes, në të cilin thuhet: *“Fëmijët kanë për detyrë të respektojnë prindërit e të kujdesen për ta, sidomos kur janë të paafte dhe pa mjete të mjaftueshme jetese.”*<sup>24</sup>

Sipas Kushtetutës së vitit 1946, fëmijët e lindur jashtë martesë barazoheshin me fëmijët e lindur nga martesë dhe prindërit e tyre ngarkoheshin me po ato detyrime që kanë prindërit e fëmijëve të lindur nga martesë (neni 19). Kjo ishte një përpjekje e kotë propagandistike e kohës, pasi këta fëmijë nuk arritën të integroheshin në shoqëri, siç propagandonte regjimi, ngaqë mbanin mbi shpinë vulën e jetimit.

Më 1 janar 1966 u miratua Kodi i Familjes i Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili u ndërtua në bazë të parimeve të larta të moralit komunist. Në nenin e parë të këtij kodi vihej në dukje rëndësia e madhe e familjes, si bërthamë bazë, si vatër e rëndësishme e edukimit të brezit të ri me tipare të larta të moralit komunist. Në nenet vijuesu u sintetizuan një sërë parimesh themelore të së drejtës familjare, si parimi i lirisë së shprehjes së vullnetit të bashkëshortëve të ardhshëm në lidhjen e martesës, parimi i ndjenjave të shëndosha të dashurisë mbi të cilin duhej të mbështetej martesë, parimi i barazisë, i bashkëpunimit, i ndihmës dhe i respektit reciprok që duhej të karakterizonte marrëdhëniet bashkëshortore.

<sup>23</sup>. Begeja, Ksanthipi, E drejta familjare e RPS të Shqipërisë, bot. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Tiranë, 1984, fq 34.

<sup>24</sup>. Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1982, fq 61.

Ligji nr. 223, datë 29.3.1946 “Mbi disa dispozita të posaçme të shkurorëzimit” u dha mundësi bashkëshortëve, që ishin të ndarë nga njëri-tjetri, të zgjidhnin martesën. Në bazë të tij, për t’u shkurorëzuar, duhej që ndarja në fakt të kishte vazhduar të paktën një vit. Ligji u tregua i ashpër ndaj personave që bashkëjetonin. Ata ndëshkoheshin nëse nuk e legalizonin lidhjen e tyre dhe për këtë arsye këto lidhje mbaheshin në fshtësi të plotë.

Një pamje krejt e kundërt ishte në vendet perëndimore, ku bashkëjetesa ishte një dukuri që spikaste në kolegjet universitare. Megjithëse, siç e pamë edhe më lart, normat ligjore në fuqi nuk i ndalonin në mënyrë të prerë bashkëjetesat. Strukturat partiako-shtetërore dhe organizatat e masave në shërbim të tyre mbanin nën kontroll të rreptë aspektet sociale të jetës bashkëshortore të të martuarve, sidomos të atyre që bashkëjetonin.

Ndërkaq, siç e thamë edhe më lart, me gjithë legjislacionin dukshëm të përmirësuar në këtë drejtim dhe përpjekjen demagogjike të rendit socialist për trajtimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose nga lidhje jashtë-martesore, ata nuk arritën të integroheshin asnjëherë në shoqërinë e kohës, sikundër u propagandua. Ata u bënë objekt i letërsisë artistike të kohës dhe kinematografisë. Të gjitha këto qëndrime sociale, nuk e ndaluan bashkëjetesën si dukuri shoqërore.

Në periudhën socialiste të familjes shqiptare, nga këndvështrimi social ajo ndahet në familje që ndaheshin në bazë të përkatësisë social-klasore të saj, familje që diferencohen në bazë të strukturës së tyre fiziko-demografike; pra, duke u ndarë në familje me një apo me shumë kurora. Por, si kriter për ndarjen e familjeve mund të shërbejë edhe karakteri i lidhjeve familjare, duke dalluar grupin e familjeve autoritare (mikroborgjeze, feudale, borgjeze etj.) dhe grupin e familjeve egalitare (u referohemi familjeve punëtoare, qytetare, intelektuale, fshatare etj.). Siç vërehet, në klasifikimin e familjeve merret në

konsideratë edhe aspekti kulturor arsimor e profesional, rajonal etj.

Ndryshimet politike dhe ekonomike në shoqërinë shqiptare paskomuniste pasqyruan në radhë të parë ndryshimet në familjen shqiptare. Në këtë faqe të re të historisë së shoqërisë sonë dhe familjes shqiptare, jetës intensive familjare dhe kohës së lirë që ofronte sistemi komunist tashmë i kishte ardhur fundi. Familja filloi t’i përshtatej sistemit ekonomiko-shoqëror, filloi t’u përshtatej strukturave të tregut dhe kapitalizmit, madje edhe kushteve të reja, duke u bërë promovuese e bizneseve të vogla familjare.

Kalimi nga ekonomia socialiste e centralizuar në ekonominë e tregut u shoqërua me shkatërrimin e kooperativave bujqësore dhe të ndërmarrjeve industriale të mëdha, me krijimin e njësisë të vogla prodhuese dhe të shërbimit në qytete dhe të ekonomive të vogla bujqësore në fshatra.

Familja është një institucion në ndryshim, në evolucion të vazhdueshëm, por në vendin tonë ajo ka kaluar nëpërmjet një revolucioni që erdhi si pasojë e këtyre viteve të tranzicionit. Ajo ndryshon kur shtohet në numër ose kur anëtarët e saj rriten, lëvizin, largohen; pra, është në një evolucion të vazhdueshëm. Megjithatë kjo nuk na pengon ta identifikojmë familjen si një grupim ku pjesëtarët e saj kanë lidhje të veçantë ndërmjet tyre. Duke marrë në konsideratë Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Familjes dhe konventa të tjera që janë pjesë e legjislacionit tonë, më poshtë po paraqesim aktet normative që rregullojnë marrëdhëniet familjare dhe martesore në Republikën e Shqipërisë pas viteve ’90.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë shkruhet:

Neni 53

1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë një familje.

2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.

Neni 54

1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë të shtetit.

2. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me fëmijët e lindur nga martesë.

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë dhe veçanërisht nën moshën minimale për punën, që mund t'i dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.<sup>25</sup>

Sipas nenit 217 të Kodit të Familjes:

4. Prindërit dhe fëmijët, reciprokisht, duhet të ndihmojnë, të duan dhe të respektojnë njëri-tjetrin.<sup>26</sup>

Mosha e lidhur e martesës në Kodin e Familjes (2003), është 18 vjeç për të dy sekset (në Kodin e mëparshëm, vajza 16 vjeç). Ky ndryshim u bazua në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve për trajtimin e njëjtë të të dy seksëve.

Në nenin 53 të Kushtetutës së Shqipërisë sanksionohet:

1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.

2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti.

3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohet me ligj.<sup>27</sup>

Në ndryshim nga Kodi i mëparshëm është përfshirë dhe shpallja e martesës. Shpallja e martesës bëhet para lidhjes së martesës nga nëpunësi i gjendjes civile dhe nënkupton afishimin në vende të caktuara nga bashkia ose komuna të një dokumenti ku tregohet identiteti, profesioni, vendbanimi dhe vendqëndrimi i bash-

këshortëve të ardhshëm, si dhe vendi ku do të lidhet martesë. Diversiteti i seksëve të bashkëshortëve të ardhshëm nuk përmendet në mënyrë të veçantë as si kusht, as si ndalesë e veçantë në disiplinën e martesës dhe kjo vërtetohet prej formulimit të martesës në Kodin e Familjes:

*“Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje”<sup>28</sup>*

Heteroseksualiteti është një parim dhe parimet kanë përparësi, sepse shkelja e tyre ia humbet kuptimin në thelb institutit përkatës. Megjithatë, kur i referohemi homoseksualitetit si dukuri shoqërore, pa dyshim që këndvështrimi ndaj kësaj dukurie ka pësuar ndryshim që prej '91 (i panjohur masivisht) e në 2009 ku ka ngacmime të vazhdueshme të politikës për ligjërimin e tij.

Për herë të parë trajtohet në Kodin e Familjes bashkëjetesa, e ndaluar në Shqipëri deri pas viteve '90, dukuri që përcaktohet në nenin 163: “Bashkëjetesa është një bashkim fakti mes burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”. Si një alternativë jo e re e martesës, ajo dënohej prej të drejtës zakonore shqiptare (martesa me provë) dhe dënohej në periudhën e regjimit socialist, por mori përmasa të tjera në shoqërinë e pas viteve '90. Dilema “martesë apo bashkëjetesë” është një prej zgjedhjeve të shoqërisë së sotme, ashtu sikundër dukuri të tjera, siç janë familjet me prindër të divorcuar, vajzat-nëna etj.

Siç e pamë, familja shqiptare ka evoluar jo vetëm ligjërisht, ashtu sikundër ajo

<sup>25</sup>. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, fq 18.

<sup>26</sup>. Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2007, neni 217, fq 73.

<sup>27</sup>. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, fq 18.

<sup>28</sup>. Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2007, Neni 1, fq 9.

europiane dhe botërore, pa ndonjë ndryshim në rrjedhën e zhvillimit të saj. Edhe nëse jo, ajo mbart defekte e probleme, sikundër institucionet analoge në botës. Familja ka ndryshuar në strukturë, përbërje, qëndrueshmëri dhe është rivlerësuar pozicioni i saj në shoqërinë tonë, e cila

mbart në vetvete një tërësi problematikash e fenomenesh negative që bëhen pengesë për zhvillimin e saj, ngaqë familja, siç e kemi emërtuar edhe më lart, është qeliza bazë e shoqërisë apo themeli prej të cilit një shoqëri përcaktohet si e shëndetshme apo shëndetligë.

## REFERENCAT

- Alia, Zana, *Familja socialiste dhe struktura e saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1988
- Balili. Arta. 2002. "Shkurt mbi të Drejtën Familjare, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe projektin e Kodit të ri të Familjes", Rev. *Newsletter*, Nr.4, Tiranë, 2002, fq 19- 29.
- Begeja, Ksanthipi, *E drejta familjare e RPS të Shqipërisë*, bot. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Tiranë, 1984
- Begeja, Ksanthipi, *E drejta familjare e RP të Shqipërisë I*, Tiranë, 1973.
- Birko, Edlira: "Modelet gjinore dhe modelet që ofron realiteti shqiptar (media në fokus)", Revista *Gaia*, Nr.3, Tiranë, 2008, fq 33- 39.
- Bisedimet e Këshillit Kombëtar, 1922, nr. 23, f. 411.
- Durham, Edith: *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, 8 nëntori, Tiranë, janar 1991.
- Elezi, Ismet: *E drejta zakonore e Labërisë në planin krahasues*, Libri Universitar, Tiranë, 1994.
- Elezi, Ismet: *E drejta zakonore penale e shqiptarëve*, 8 Nëntori, Tiranë, 1983.
- Engels, Friedrich: *Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1949.
- Gjeçovi, Shtjefën: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, bot. Albinform, Tiranë, 1993.
- Gjergji, Lush: "Gruaja shqiptare në të drejtën zakonore të Lekë Dukagjinit", Revista *Sfinga*, nr. 5, bot. Prograf, Prishtinë, 2001, fq 231-243.
- Kaser, Karl: "Historia e familjes në Shqipëri në shekullin XX. Një profil i parë", përkthyer Gentiana Kera dhe Enriketa Papa Revista *Politika & Shoqëria*, nr. 2 (12), 2003, fq 65- 75.
- Kera, Gentiana dhe Papa, Enriketa: "Familja, feja dhe e drejta zakonore në Shqipëri deri në gjysmën e parë të shekullit XX", revista *Politika & Shoqëria*, nr. 1(11), 2003, fq 31- 44.
- Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë, bot i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2007.
- Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1982.
- Krasniqi Luljeta, "Edith Durham në mesin e zakoneve shqiptare", Rev. *Sfinga*, Nr.6, bot. Prograf, Prishtinë, 2003, fq 243- 251.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998.
- Luarasi, Aleks: *Marrëdhëniet familjare*, Luarasi, Tiranë, 2001.
- Lloyd, Saxton, *The individual marriage and the family*, Wodsworth Pub.Comp, Belmont, California, U.S.A, 1980, pp 409- 505.
- Mandro-Balili, Arta; Meçaj, Vjollca; Zaka, Tefeta; Fullani, Arjana: *E drejta familjare*, botim i Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Kristalina KH, Tiranë, 2006.
- Marku, Mark: "Debat për gruan në shtypin shqiptar të viteve '30, pjesë e debatit për modernitetin", Revista *Gaia*, Nr.6, Tiranë, qershor 2008, fq 16-19.
- Martesa dhe familja në socializëm, bot. Lidhja Socialiste e Popullit për Kosovë- Metohi,

- Prishtinë, 1958.
- Merxhani, Branko: *Formula të Neoshqiptarizmit* (përgatitur nga Dr. Aurel Plasari), Apollonia, Tiranë, 1996.
- Musaj, Fatmira: "Gruaja në Shqipëri (1912-1939)", Revista *Sfinga*, Nr.7, bot. Prograf, Prishtinë, 2004, fq 273- 309.
- Sokoli, Lekë, *Analiza sociologjike*, Instituti i Sociologjisë & Rinia, Tiranë, 2006, f 6- 24.
- Stewart Elbert W.: *Sociology, the human science*, McGraw-Hill Book Comp., 1981, U.S.A, fq 325-358.
- Taylor, Steve, *Sociology, issues and debates*, Mac-Millan, London, 1999, pp 158- 179.
- Zaka, Tefta. 2003. *Të drejtat e njeriut*, , Kodi i Ri i familjes- një hap në zhvillimin e marrëdhënieve sociale dhe pasurore", Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, 2(34) Tiranë, qershor.
- UNICEF. 2005. *Trajtesa juridike dhe sociale për mbrojtjen nga dhuna në familje, botim Unicef*, Tiranë: Pegi.
- Uçi, Alfred, "Mbi disa aspekte të marrëdhënieve familjare dhe martesore", Revista *Politika & Shqëria*, Vëll 6, Nr. 1(11), Tiranë, 2003, fq 17-30.
- Zaçë, Valentina, *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Logoreci, Tiranë, 1996.

# EVOLUCIONI I MARTESËS NË KOSOVË

Besim GOLLOPENI - *Sociolog, demograf*

## PËRMBLEDHJE

Në shekullin e kaluar, Kosova është ballafaquar me sfida të mëdha; në njërin anë nga faktori politik e ushtarak (luftërat, eksodi, diskriminimi, etj.) dhe në anën tjetër faktori socio-ekonomik (mungesa e ushqimit, kushte të këqija shëndetësore, niveli i ulët i arsimit, kushte jo të mira për banim, etj.), për të vazhduar me gjendje jo të mirë deri në fund të shekullit XX, përkatësisht deri në luftën e fundit në vitin 1999. Me hyrjen e ndërkombëtarëve në Kosovë, pas vitit '99 u krijuan kushtet më të mira për lëvizje të lirë të qytetarëve, qasje në shërbime informative, përparimi në shkencë dhe teknologji, pavarësi ekonomik i të rinjve etj. Paralelisht me të gjitha këto zhvillime, nga fillimi i shekullit të kaluar e deri më sot, martesë sipas moshës dhe gjinisë ka pasur ndryshime të vazhdueshme drejt rritjes të moshës së martesës.

**S**tudimi i martesës, përbën një nga fushat më të rëndësishme të shken-  
cave shoqërore e veçmas të so-  
ciologjisë dhe demografisë. Martesa dhe  
familja si institucion shoqëror luajnë role  
të rëndësishme në zhvillimet e popullsisë.

Martesa synon krijimin e familjes,  
krijon bazë të mirë të qëndrueshmërisë  
së individit, çiftit, familjes dhe sho-  
qërisë. Martesa e qëndrueshme mundë-  
son familje të qëndrueshme dhe shoqëri  
të shëndoshë. Kur dy njerëz martohen,  
ata bëhen të afërt për njëri-tjetrin; mar-

tesa gjithashtu lidh së bashku një grup  
të madh njerëzish.

Ndryshimet shoqërore, në një mënyrë  
apo në një tjetër, ndikojnë në martesë. Në  
përcaktimin e saj, ajo ndjek hap pas hapi  
ndryshimet e jetës shoqërore. Megjithatë  
duhet të theksuar se këto të fundit nuk pas-  
qyrohen menjëherë në martesë, prandaj  
shpeshherë, si në lidhjen martesore<sup>29</sup>, ashtu  
edhe në moshën e martesës sjellin ndryshime  
që u përkasin stadeve të ndryshme të zhvil-  
limit ekonomik-shoqëror, si dhe  
psikologjisë e mentalitetit të popullit.

<sup>29</sup>. Yllka Selimi, *Jetë familjare*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, (Tiranë, 2007), f. 77.

Gjatë shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, në Kosovë, martesa sipas moshës dhe gjinisë ka pasur ndryshime.

Varësisht nga kushtet shoqërore-ekonomike të familjes ndryshonte edhe mosha e martesës, sikurse edhe diferenca e moshës së partnerëve<sup>30</sup>.

Në fillim të shekullit XX, shoqëria kosovare ishte nën ndikimin turk dhe gjendja shoqërore-ekonomike ishte tepër e rëndë. Në këtë kohë kemi të bëjmë me familje agrare, ku aktiviteti kryesor i familjes ishte i lidhur kryekëput me tokën. Edhe në vitet e mëvonshme, gjendja shoqërore-ekonomike e popullsisë së Kosovës nuk ndryshoi, por sa vinte dhe përkeqësohej nga okupimi hegjemonist serb.

Kjo kohë ndërlidhet me kushtet e rënda shoqërore-ekonomike. Shkalla e lartë e mortalitetit ishte e kushtëzuar nga gjendja e pavolitshme socio-shëndetësore, jeta dhe ekonomia e mbyllur agrare-blegtorale, shkalla shume e ulët e arsimimit, niveli i ulët i urbanizimit, sëmundjet endemike, luftërat e ndryshme që merrnin jetë të shumta njerëzish, si dhe mortaliteti shumë i lartë, që sillte rreth kufijve ekstremë. Duke vazhduar deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, martesat ishin të hershme dhe gratë shqiptare arrinin kufirin maksimal të mbarsjes.

Nga vitet 1950 e këndej, martesa në Kosovë, si për nga mosha ashtu dhe gjinia, filloi të ketë stabilitet, por me tendencë të rritjes së moshës së martesave për të dy gjinitë. Pas viteve '80 dhe '90, martesa në Kosovë mori një goditje të rëndë për shkak të gjendjes së përkeqësuar, sidomos asaj politike dhe socio-ekonomike. Në dekadën e fundit të shek. XX, për arsye tanimë të njohura (përndjekjes së shqiptarëve), martesa në Kosovë e humb stabilitetin e vet. Gjatë kësaj periudhe

kohore migruan shumë shqiptarë për në vise të ndryshme të botës. Migrimi përfshinte kryesisht popullsinë në moshë të re (popullsinë mashkullore). Gjatë këtyre viteve vonohen martesat dhe në këtë mënyrë paraqitet rritja e moshës së martesave për të dy gjinitë. Ndërsa pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë (1999), popullata u dha pas ndërtimeve, meqë kishin ndodhë dëmtime të mëdha. Në dekadën e fundit, rinia kosovare e ka vënë në rend të parë stabilitetin jetësor afatgjatë (shkollimin, avancimin e karrierës etj.) e më pas krijimin e familjes. Ndërsa mosha e martesës shkon vazhdimisht duke u rritur.

Hulumtimi i evolucionit të martesës në Kosovë sipas moshës dhe gjinisë është me rëndësi të veçantë, sepse na mundëson të njihemi me rrjedhat e saj sipas moshës dhe gjinisë nëpër vite, por edhe na ndihmon për të përcaktuar prirjet në të ardhmen. Për hulumtimin e kësaj teme mbështetemi në këto çështje hulumtuese: prirja e martesës sipas moshës dhe gjinisë në Kosovë, efektet dhe faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e martesave sipas moshës dhe gjinisë.

Ndërsa çështjet kyçe të këtij hulumtimi janë: a) Çfarë ndryshimesh kohore kanë ndodhur në martesën në Kosovë, sipas moshës dhe gjinisë, dhe cilat janë efektet e saj? b) Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në martesë, sipas moshës dhe gjinisë?

Për realizimin e këtij hulumtimi nisemi nga hipoteza se në Kosovë, gjatë shekullit XX, ka pasur prirje për rritjen e moshës së martesave sipas gjinisë, por me lëvizje të vogël, ndërsa në fund të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI, mosha e martesave sipas gjinisë në Kosovë ka shënuar rritje të theksuar.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e moshës së martesave sipas moshës dhe

<sup>30</sup>. Asllan Pushka, *Aspektet gjeopopolitike në Kosovë dhe rreth saj*, (Prishtinë, 2000), f. 215.

gjinisë në Kosovë janë: politikë, socio-ekonomikë dhe të jashtëm (luftërat).

### **Mosha e hyrjes në martesë për djem dhe vajza nga fillimi i shekullit XX e këndej**

Mosha e hyrjes në martesë, veçanërisht në martesën e parë, ka rëndësi të madhe për riprodhimin e popullsisë. Hyrja e hershme në martesë mundëson shfrytëzimin e periudhës së riprodhimit që nga periudha më e hershme riprodhuese (mosha më të hershme) të popullsisë.

Në Kosovë, në fillim të shek. XX, martesat realizohej në moshë të re për të dyja gjinitë. “Martesa bëhej më herët, për vajzat në moshën 13-16 vjeçare, kurse për djemt 15-18 vjeçare. Martesa e vajzave përtej 20-vjeçare ishte shumë e rrallë, sikurse edhe e meshkujve, që nuk duhej të kalonte moshën 25-vjeçare. Vajza më e vjetër se 20 vjet trajtohet si e “moçme”, ndërsa djali mbi 25 vjet “plak”. Nga gjysma e shekullit të kaluar (XIX) dhe në këtë shekull (XX), u ngrit mosha mesatare e martesës prej 15-17 vjet për femra dhe 17-20 vjet për meshkuj. Martesat e hershme bëheshin për shkak të nevojave për punë në familje, kujdesin e fëmijëve etj”<sup>31</sup>.

Në këtë periudhë kohore, kushtet socio-ekonomike në Kosovë ishin të rënda. Për të siguruar ekzistencën, nevojitet krahu i punës. Meqë aktiviteti i njeriut ishte i varur nga dora e tij dhe ushqimi sigurohej me anë të përdorimit të veglave të thjeshta të punës, martesat e hershme dhe numri i madh i lindjeve ishin të domosdoshme. Në këtë gjendje të rënd socio-ekonomike përfshiheshin edhe sëmundjet ngjitëse (kolera, lia, tuberkulozi, etj.) apo luftërat, që merrnin jetë të shumta njerëzish. Në këtë situatë, hyrja në moshë të re në martesë e

popullsisë ishte përparësi, sepse mundësonte shfrytëzimin e plotë të periudhës së riprodhimit dhe në këtë mënyrë edhe përkundër fatkeqësive të lartpërmendura, familja arrinte të mbijetonte dhe të sigurohej fuqia punëtore.

Në modelin patriarkal të familjes, martesat e hershme nënkuptonte lindjen e shumë fëmijëve, disa prej të cilëve vdisnin nga sëmundjet e ndryshme ngjitëse. Kriteri i martesës ishte pjekuria biologjike, por jo edhe ajo sociale dhe psikologjike. Personat e martuar, në pikëpamje socio-psikologjike, formoheshin nën përkujdesjen familjare<sup>32</sup>.

Për të parë më mirë rrjedhën e moshës së martesave sipas gjinisë në Kosovë, do të analizojmë nëpër vite martesën si më poshtë. Në bazë të analizës së martesave sipas moshës dhe gjinisë në studimin nga viti 1950 e deri në vitin 2007, del se prirja e përgjithshme (shih tabela 1) synon drejt realizimit të martesës (për djem) në moshën 25-29 vjeç.

Prej viteve 1955 e deri më 1996, nga të gjitha martesat e djemve vetëm një rast ishte nën moshën 15 vjeç. Kështu, për vitin 1955, martesat e djemve në moshën 15-19 vjeç zinin 17.1% të të gjitha martesave. Në këto vite mbizotëronin martesat në moshën 20-24 vjeç (36.2% të martesave). Ndërkaq, martesat në moshë 25-29 vjeç zinin 26.6% të martesave, e pasuar nga mosha 30-34 vjeç me 8.4% të tyre. Kurse të gjitha martesat mbi 35 vjeç përbënin 11.6%.

Karakteristike e të gjitha martesave sipas moshës së djemve për periudhën 1955 e deri në vitin 1986 është lëvizja e përqindjes së grup-moshave të martesave; disa me prirje rënieje, pjesa tjetër në rritje. Mosha e martesës nga 15-19 vjet (1955) nga 17.1% që ishte atë vit, shënoi rënie të vazhdueshme deri në vitin 1986, kur kjo moshë u zvogëlua

<sup>31</sup>. Ibid. f. 215.

<sup>32</sup>. Ibid. f. 216.

**Tabela 1:** *Mosha e martesës së djemve për periudhën e dytë të shekullit XX<sup>33</sup>*

| Viti | Mosha e martesës për djem |            |       |            |       |            |       |            |       |             |       |
|------|---------------------------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|-------------|-------|
|      | Martesa                   | 15-19 vjeç |       | 20-24 vjeç |       | 25-29 vjeç |       | 30-34 vjeç |       | Mbi 35 vjeç |       |
|      | Gjithsej                  | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.         | %     |
| 1955 | 6815                      | 1167       | 17.12 | 2471       | 36.25 | 1812       | 26.58 | 570        | 8.36  | 794         | 11.65 |
| 1966 | 8246                      | 487        | 5.9   | 2905       | 35.22 | 3048       | 36.96 | 1046       | 12.68 | 752         | 9.11  |
| 1976 | 10268                     | 432        | 4.2   | 4141       | 40.33 | 3544       | 34.51 | 1063       | 10.35 | 1037        | 10    |
| 1986 | 11623                     | 363        | 3.12  | 4075       | 35    | 4900       | 42.15 | 1616       | 13.9  | 825         | 7     |
| 1996 | 12244                     | ...        | ...   | ...        | ...   | ...        | ...   | ...        | ...   | ...         | ...   |

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, analizuar nga autori.

në 3.1%. Ndërkaq, mosha e martesave 25-29 vjeç për djem (1955), nga 26.5% shënoi rritje deri në 42.1% (1986). Rritje shënoi edhe mosha 30-34 vjeç (më 1955 ishte 8.3%; më 1986 ishte 13.9%).

Ndërsa mosha martesave mbi 35 vjeç shënoi rënie të vazhdueshme (më 1955 ishte 11.6%; më 1986 ishte 7%). Megjithatë, kemi vënë re se të gjitha grup-moshat e martesave të djemve për periudhën rreth 50-vjeçare kanë ndryshuar. E veçanta e kësaj vihet re në fillim të gjysmës së dytë të shek. XX, ku mbizotëronte mosha e martesës së djemve 20-24-vjeçarë, ndërkaq, nga fundi i këtij shekulli arriti të mbizotëronte mosha e martesës 25-29 vjeç. Po ashtu, sipas analizave të bëra për

periudhën më të re të moshës së martesës, kemi këto rezultate (shih tabelën 2).

Të dhënat për periudhën më të re për martesat sipas moshës së djemve tregojnë se nga viti 2002 e këndeje kemi lëvizje të martesave sipas moshës, ku mosha e djemve 15-19-vjeçarë në vitin 2002 ishte 1.19% dhe për të shkuar vazhdimisht në rënie, deri në vitin 2007 (1.08%). Në këtë mënyrë, të gjithë grup-moshat e martesave për djem për periudhën më të re kanë pasur rënie. Përrjashtim bën mosha mbi 35 vjeç, që vazhdimisht është rritur nga 18.42% (2002) në 23.61% (2007).

Për periudhën që është marrë në studim, kemi vënë re se mosha e martesës për djem është rritur. Në këtë kohë nuk kemi

**Tabela 2:** *Mosha e martesës së djemve për periudhën më të re<sup>34</sup>*

| Viti | Mosha e martesës për djem |            |      |            |       |            |       |            |       |             |       |
|------|---------------------------|------------|------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|-------------|-------|
|      | Martesa                   | 15-19 vjeç |      | 20-24 vjeç |       | 25-29 vjeç |       | 30-34 vjeç |       | Mbi 35 vjeç |       |
|      | Gjithsej                  | Nr.        | %    | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.         | %     |
| 2002 | 18280                     | 218        | 1.19 | 3738       | 20.45 | 6147       | 33.62 | 4809       | 26.03 | 3368        | 18.42 |
| 2004 | 16989                     | 228        | 1.34 | 3256       | 19.16 | 5295       | 31.16 | 4263       | 25    | 3947        | 23.23 |
| 2006 | 15825                     | 182        | 1.15 | 3113       | 19.67 | 4987       | 31.51 | 3980       | 25.15 | 3563        | 22.51 |
| 2007 | 16824                     | 182        | 1.08 | 3265       | 19.4  | 5260       | 31.26 | 4145       | 24.63 | 3972        | 23.61 |

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, analizuar nga autori.

<sup>33</sup>. Vjetari statistikor i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, *Statistikat vitale të Kosovës (prej vitit 1950 deri 1988, Prishtinë)*.

<sup>34</sup>. Enti Statistikor i Kosovës, *Statistikat vitale të Kosovës*, (për vitin 2002 deri 2007, Prishtinë).

**Tabela 3:** *Mosha e martesës së vajzave për periudhën e dytë të shekullit XX<sup>35</sup>*

| Viti | Mosha e martesës për vajza |            |       |            |       |            |       |            |      |             |      |
|------|----------------------------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|------------|------|-------------|------|
|      | Martesa                    | 15-19 vjeç |       | 20-24 vjeç |       | 25-29 vjeç |       | 30-34 vjeç |      | Mbi 35 vjeç |      |
|      | Gjithsej                   | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %    | Nr.         | %    |
| 1955 | 6815                       | 2984       | 43.78 | 2831       | 41.54 | 588        | 8.62  | 227        | 3.33 | 178         | 2.61 |
| 1966 | 8246                       | 2744       | 33.27 | 3793       | 45.99 | 1121       | 13.59 | 304        | 3.68 | 280         | 3.39 |
| 1976 | 10268                      | 3177       | 30.94 | 4912       | 47.83 | 1237       | 12.04 | 347        | 3.38 | 594         | 5.78 |
| 1986 | 11623                      | 2787       | 23.97 | 5884       | 50.62 | 2042       | 17.56 | 413        | 3.55 | 497         | 4.27 |
| 1996 | 12244                      | ...        | ...   | ...        | ...   | ...        | ...   | ...        | ...  | ...         | ...  |

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, analizuar nga autori.

të bëjmë më me martesa nën moshën 15 vjeç, sa ishte në gjysmën e parë të shek. XX, ndërsa mosha 15-19 vjeç ka shënuar vazhdimisht rënie nga 17.12 (1955) në 1.08% (2007). Rritje kanë shënuar mosha 30-34 vjeç, përkatësisht mosha mbi 35 vjeç; më 1955 (11.65%) në vitin 2007 (23.61%).

Ndërsa të dhënat për moshën e martesës për gjininë femërore për periudhën e dytë të shekullit XX kemi këto rezultate (shih tabelën 3).

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, mosha e martesës së vajzave ka pasur lëvizje drejt rritjes. Gjatë kësaj periudhe kohore, martesa të realizuara për vajzat nën moshën 15 vjeçare ishin 13 raste. Mosha e martesës 15-19 vjeç vazhdimisht zvogëlohej nga 43.78% më 1955 në

23.97% në vitin 1986. Ndërkaq mosha 20-24 vjeç e martesave vazhdimisht u rrit nga 41.54% që ishte në vitin 1955 në 50.62% në vitin 1986. Po ashtu edhe mosha 25-29 vjeç shënoi rritje prej 8.62% më 1955 në 17.56% në vitin 1986. Ndërsa moshat e tjera nuk patën lëvizje të theksuar në drejtim të rritjes.

Gjatë gjithë kësaj periudhë kohore u pa se mosha e martesës së vajzave ka shënuar rritje. Përderisa në vitin 1955 dominonte mosha e martesave 15-19 vjeç (43.78%), në fund të gjysmës së dytë të shek. XX, përkatësisht në vitin 1986, dominon mosha e martesës 20-24 vjeç (50.62%).

Për periudhën më të re të martesës sipas moshës së vajzave, kemi këtë pasqyrë (shih tabelën 4).

**Tabela 4:** *Mosha e martesës së vajzave për periudhën më të re<sup>36</sup>*

| Viti | Mosha e martesës për vajza |            |       |            |       |            |       |            |       |             |       |
|------|----------------------------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|------------|-------|-------------|-------|
|      | Martesa                    | 15-19 vjeç |       | 20-24 vjeç |       | 25-29 vjeç |       | 30-34 vjeç |       | Mbi 35 vjeç |       |
|      | Gjithsej                   | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.        | %     | Nr.         | %     |
| 2002 | 18280                      | 1819       | 9.95  | 6879       | 37.63 | 5364       | 29.34 | 2523       | 13.8  | 1695        | 9.27  |
| 2004 | 16989                      | 1880       | 11    | 5819       | 34.23 | 4629       | 27.24 | 2508       | 14.76 | 2155        | 12.68 |
| 2006 | 15825                      | 1730       | 10.9  | 5800       | 36.65 | 4068       | 25.7  | 2304       | 14.55 | 1923        | 12.15 |
| 2007 | 16824                      | 1716       | 10.19 | 6032       | 35.85 | 4375       | 26    | 2453       | 14.58 | 2248        | 13.36 |

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, analizuar nga autori.

<sup>35</sup>. Vjetari statistikor i KSA të Kosovës, *Statistikat vitale të Kosovës*, (prej vitit 1950 deri 1988, Prishtinë).

<sup>36</sup>. Enti Statistikor i Kosovës, *Statistikat vitale të Kosovës*, (për vitin 2002 deri 2007, Prishtinë).


Për këtë periudhë të shkurt kohore, mosha e martesës së vajzave nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh në drejtim të rritjes apo e kundërta e saj. Në këtë rast përjashtim bën mosha e martesave të vajzave mbi 35 vjeç, me rritje të vogël nga 9.27% që ishte në vitin 2002 në 13.36% në vitin 2007. Por, nëse analizojmë moshën e martesës së vajzave gjatë periudhës më të fundit me atë të viteve '50 të shekullit të kaluar, kemi të bëjmë me ndryshime të mëdha. Në vitin 1950 mosha e martesës së vajzave 15-19 vjeç ishte e përfaqësuar me 43.78%, ndërsa në vitin 2007 e njëjta moshë është përfaqësuar me 10.19%, pra ka shënuar rënie. Ndërkaq, mosha 20-24 vjeç në vitin 1955 ishte 41.54% dhe e njëjta moshë në vitin 2007 është e përfaqësuar me 35.85%; kurse mosha e martesave 25-29 vjeç në vitin 1955 është 8.62%, në vitin 2007 ka shënuar rritje në 26%. Në këtë kohë kanë shënuar rritje edhe moshat mbi 30 vjeç, përkatësisht 35 vjeç, aq sa ishte në vitin 1955 (2.61%) në 13.36% (2007).

Në fillim të gjysmës së dytë të shek. XX dominonte mosha 20-24 vjeç (36.25%) për meshkuj, kurse për femra mosha 15-19 vjeç (43.78%) për t'u rritur të dyja grup-moshat sipas gjinisë më vonë. Në vitin 1986 dominonte mosha 25-29 vjeç (42.15%) për meshkuj dhe 20-24 vjeç (50.62%) për femra. Ndërkaq, deri në vitin 2007 dominimi i moshës së martesave 25-29 vjeç për meshkuj dhe 20-24 vjeç për femra mbeti e njëjtë, por shënoi rritje të konsiderueshme mosha mbi 30 vjeç, përkatësisht 35 vjeç (23.61%) për meshkuj dhe (13.36%) për femra.

Me këtë prirje, nga shekulli i kaluar e deri më sot martesat sipas grup-moshave të reja për të dy gjinitë vazhdimisht kanë pasur rënie, ndërsa grup-moshat e mëdha të martesave për të dyja gjinitë janë rritur.

Për të parë edhe më mirë evolucionin e martesës sipas moshës dhe gjinisë në Kosovë, kemi paraqitur grafikun më poshtë, që paraqet moshën mesatare të hyrjes në martesë për të dyja gjinitë (shih grafikun 1).

**Grafiku 1:** Mosha mesatare e hyrjes në martesë për periudhën e dytë të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI<sup>37</sup>



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, analizuar nga autori.

<sup>37</sup>. Vjetari statistikor i KSA të Kosovës, *Statistikat vitale të Kosovës, (prej vitit 1950 deri 1988, Prishtinë)* & ESK, *Statistikat e kurorëzimeve dhe shkurozimeve në Kosovë, (Prishtinë, 2007)*.

Për periudhën rreth gjashtëdhjetëvjeçare, mosha mesatare e martesës u rrit 4.7 vjet për djem dhe 5.7 vjet për femra. Sipas analizës së të dhënave, vërehet se mosha e martesës te femrat është rritur më shumë se ajo e djemve. Ndërkaq, mosha mesatare e martesës për të dyja gjinitë u rrit për 5.3 vjet.

Diferenca në moshë e martesës në vitin 1950 ishte 5.1 në favor të burrit, por kjo moshë shkoj duke u zvogëluar deri në 4.1 në vitin 2007. Diferenca në moshë në mesë burrit dhe gruas, për periudhën e marrë për studim, sillet rreth 0-6 vjet.

Nëse shikohen martesat sipas përgatitjes shkollore në Kosovë, sipas të dhënave të vitit 1987, dominojnë martesat me e meshkujve me shkollë të mesme - më tepër se 50% - ndërsa te femrat, një në katër që kishte lidhur martesë atë vit ishte me shkollë të mesme. Me shkollë të lartë ishte 1.7% e femrave të martuara<sup>38</sup>. Ndërsa për periudhën më të re, përkatësisht vitin 2007, kemi rritje të nivelit të arsimimit të të martuarve. Në vitin 2007, të martuar me shkollim të mesëm janë 73.6% meshkuj dhe 58.9% femra. Ndërkaq, me shkollim të lartë janë 4.9% e të martuarve meshkuj dhe 3.8% femra. Sa për martesat ku partnerët janë me nivel të ulët arsimimi (pa shkollë, shkollë fillore të pakryer dhe me shkollë fillore), ato shënuan rënie të vazhdueshme.

Sa i përket përkatësisë etnike, gjatë gjithë kohës kanë dominuar martesat kombësisë shqiptare mbi 90% (viti 2007) më pas boshnjake, turke, serbe etj.

Duhet thënë pa mëdyshje se shtyrja e moshës së martesës (rritja) përcillet me efekte të theksuara në rrjedhat demografike. Nëse e analizojmë rrjedhën e

natalitetit sipas grup-moshave të femrave nga viti 1950 e deri në 2007, kemi ndryshime të theksuara.

Nga të dhënat (tabela 9) vërehet qartë rënia e mundësisë së riprodhimit në periudhën dyzetvjeçare (1950-1990). P.sh., grupi i grave 45-49 vjet në vitin 1990 kishin lindur afro 16 herë më pak fëmijë se grupi i moshës së njëjtë në vitin 1950, ose rreth 40 herë më pak në vitin 1996 në raport me vitin 1950. Ulja e mundësisë së riprodhimit është e konsiderueshme edhe te breznitë e reja të femrave kosovare<sup>39</sup>.

Te femrat më të reja se 40 e 35 vjet (brezat e lindur pas vitit 1950 dhe 1955) vërehet një rënie e madhe e riprodhimit, që tregon procesin e tranzicionit të shpejtuar demografik në sferën e lindshmërisë. Procesi i rënies së lindshmërisë tek të gjitha grup-moshat është më intensiv pas viteve '70, kur fillon të rritet edhe mosha mesatare e nënës me rastin e lindjes së fëmijës së parë, që do të bëhet tashmë veçori e lindshmërisë së popullsisë së Kosovës, veçanërisht te femrat e shkolluara, të punësuar dhe te ato që jetojnë në vendbanime urbane<sup>40</sup>.

Nga të gjitha grup-moshat e nënave, në lindjen e parë kishte ndryshime. Në këtë mënyrë zvogëlohet periudha e riprodhimit të femrës dhe kjo ndikon në uljen e numrit të lindjeve. Sa më e vonshme të jetë mosha e hyrjes në martesën e parë, përqindja e sterilitetit është më e madhe. Dushan Brezniku, në bazë të të dhënave për popullsinë jugosllave ka vlerësuar se: femrat, të cilat për herë të parë martohen në moshën 20-vjeçare karakterizohen me përqindjen më të vogël të sterilitetit (vetëm 5.40%), ndërsa numri i femrave

<sup>38</sup>. Tefik Basha, *Martesa dhe shkurrorëzimet në KSA të Kosovës*, Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare, Materiale nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 dhe 8 dhjetor 1989, (Prishtinë 1990), f. 479.

<sup>39</sup>. Hivzi Islami, *Studime demografike, 100 vjet të zërvillimit demografik të Kosovës*, Akademia e Shkencave dhe Artëve të Kosovës, (Prishtinë 2005), f. 89.

<sup>40</sup> Ibid.

sterile është më i madh tek ato që bashkëshortësinë e parë e kanë lidhur në moshën 30-vjeçare (17.23%). Femrat që e lidhin bashkëshortësinë më vonë, respektivisht në moshën 40-vjeçare, më tepër se gjysma mbeten sterile (55.05%), pra nuk janë të afta të marrin pjesë në procesin e riprodhimit<sup>41</sup>. Pra, ekziston një lidhje e ngushtë mes moshës së femrës, lidhjes së martesës dhe lindshmërisë.

Në ndryshimin e rrjedhave demografike, në këtë rast mosha e hyrjes në martesë, lidhjen e martesës, ndikojnë një mori faktorësh socio-ekonomikë, politikë etj. Për të parë më mirë se cilët janë faktorët që kanë ndikim në rritjen e moshës së martesës, do të shpjegojmë më poshtë.

### **Faktorët që ndikuan në rritjen e moshës së martesës sipas gjinisë në Kosovë**

Nga analiza e të dhënave të parashtruara më lart del në pah se mosha e martesës, si për djemtë dhe për vajzat, ka prirje të përgjithshme për t'u rritur nga viti në vit në krahasim me periudhën e shekullit XX. Studimi i martesës sipas moshës dhe gjinisë në Kosovë, nuk është i rastit, por ka shkaqet e saj.

*Shpërbërja e familjes patriarkale.* Kjo është një ndër shkaqet që ka ndikuar në rritjen e moshës së martesave. Gjatë gjithë shekullit të kaluar, familja kosovare ishte e organizuar mbi bazën e familjes patriarkale, ku prindi (babai sidomos e në raste të rralla edhe nëna) dhe i zoti i shtëpisë kishin përgjegjësi të plotë për fejesën dhe martesën e fëmijës së tyre. Në atë kohë, martesat realizoheshin në moshë të re, pikërisht se prindi ose i zoti i shtëpisë e ndiente si detyrim martesën e fëmijëve. Por, me kalimin e viteve, gjithnjë e më tepër martesat po bëheshin problem i vetë të rinjve.

*Ngritja e nivelit të arsimimit.* Faktor

tjetër që ka ndikuar për rritjen e moshës së martesës është ngritja e nivelit të arsimimit. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, zuri vend përhapja e institucioneve shkollore (shkolla fillore, të mesme dhe universitare), ku arsimi fillor u bë i detyrueshëm dhe kjo pati ndikimin e vet në shtyrjen e moshës së martesave. Dëshira për të arritur më shumë në fushën e arsimimit dhe avancimin e karrierës së tyre, shpesh i bënë të rinjtë që ta shtynin martesën për vite më vonë.

*Pavarësia ekonomike.* Në rritjen e moshës së martesës ka ndikuar edhe pavarësia ekonomike e të rinjve. Në shekullin e kaluar, familja përbëhej nga numër i madh anëtarësh, ku vetëm njëri punonte për të mbajtur pjesëtarët e tjerë. Më pas, kjo ndryshoi dhe çdo anëtar i familjes synonte për të ardhura individuale. Por gjendja e rëndë ekonomike bën që të rinjtë ta shtynë martesën për më vonë.

*Faktori i jashtëm.* Gjatë analizës që bëmë më lart, vihet re se në fillim të shekullit XX, mosha mesatare e hyrjes në martesë ishte 20 vjeç për djemtë dhe 17 vjeç për vajzat. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (1945), mosha e hyrjes në martesë për të dyja gjinitë ishte rritur në 26.5 vjeç për djemtë dhe në 21.4 vjeç për vajzat (1950). Por duhet thënë se martesat mori goditje të rëndë në vitet '80 e sidomos në '90, kur ndodhi emigrimi i popullsisë mashkullore, sidomos të rinjtë, për shkak të përndjekjes nga pushteti serb. Ndërsa më tej, ndryshime në rrjedhat demografike e veçanërisht në martesat dhe shkurorëzime solli lufta e fundit (1999) në Kosovë. Për një periudhë relativisht të shkurtë kohore (rreth 10 vite), mosha e martesës u rrit me rreth 4 vjet. Ndërkaq, që nga viti 1950 e deri me 2007, mosha e martesës u rrit me rreth 6 vjet (shih grafikun numër 1).

*Migrimet e popullsisë.* Këto u shkaktuan nga lufta dhe situata e pavolitshme në

<sup>41</sup>. Ibid. Tefik Basha, f. 477.

Kosovë, ku shumë të rinj e lanë vendlindjen e tyre për të kërkuar punë, arsimim e banim në zona më të mëdha urbane. Në këtë kohë, Prishtina, si kryeqendër, u shndërrua në një gjenerator për tërheqjen e të rinjve drejt saj. Kjo kishte ndodhur për disa arsye, si: vendosja e administratës qendrore, universiteti publik dhe hapja e shumë universiteteve private, vendosja e selive ndërkom-bëtare, hapja e më shumë vendeve të punës nga bizneset e ndryshme etj. Po ashtu, një numër i madh i të rinjve nga vise të ndryshme të Kosovës, për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, emigruan në vende të ndryshme të botës. Studime të ndryshme kanë bërë të ditur se gjithkush që ndërron vendbanimin përballet me rrethana të reja, andaj i nevojitet kohë për t'u ambientuar me rrethin e ri. I tëri ky proces merr një kohë të gjatë qoftë shkollimi, punësimi, banimi, etj, çka bën që të shtyhet edhe martesja.

Përveç faktorëve të përmendur më lart, në rritjen e moshës së martesës ndikojnë edhe faktorë të tjerë socialë, ekonomikë, politikë etj, të cilët kërkojnë studime të mëtejshme.

## Përfundime

Në këtë studim jemi munduar të analizojmë moshën e martesës dhe të identifikojmë disa prej efekteve të kësaj rritjeje në rrjedhat demografike dhe shoqërore, si dhe shkaqet që lidhen me këto ndryshime.

Rezultatet tregojnë se moshja e martesës ka shënuar rritje gjatë gjithë kohës së

marrë për studim. Në fillim të shekullit XX, moshja mesatare e martesës ishte 15-17 vjeç për femra dhe 17-20 vjeç për meshkuj. Ndërkaq, në gjysmën e dytë të po këtij shekulli, përkatësisht në vitin 1986, moshja e martesës sipas gjinisë u rrit dhe dominoi moshja 20-24 vjeç (50.62%) për femra dhe 25-29 vjeç (42.15%) për djem. Kurse në periudhën më të re, përkatësisht në vitin 2007, dominimi i moshës mbeti i njëjtë për të dyja gjinitë me atë të vitit 1986, por u rrit moshja e martesës mbi 35 vjeç; nga 7% për djem dhe 4.27% për femra, që ishte në vitin 1986 në 23.61% për djem dhe 13.36% për femra në vitin 2007. Ndërsa moshja 15-19 vjeç shënoi rinie të vazhdueshme për të dyja gjinitë - nga 17.12% për djem dhe 43.78% për femra në vitin 1955, për të vazhduar me rënie deri në 1.08% për djem dhe 10.19% për femra në vitin 2007. Moshja mesatare e hyrjes në martesë për periudhën rreth gjashtëdhjetëvjeçare u rrit me rreth 6 vjet.

Gjatë studimit u pa se hyrja e vonshme në martesë krijon efekte të ndryshme në rrjedhat demografike, si zvogëlimin e numrit të lindjeve, zvogëlimin e periudhës riprodhuese, rritja e shkallës së sterilitetit dhe efekte tjera.

Shkaqet që kanë çuar në rritjen e moshës së martesës janë të ndryshme, por më kryesoret janë shkaqet shoqërore-ekonomike, shpërbërja e familjes patriarkale, ngritja e nivelit të arsimimit, pavarësimi ekonomik i të rinjve, luftërat, migrimet e popullsisë dhe faktorë të tjerë.

## BIBLIOGRAFIA

Basha, Tefik. "Martesa dhe shkurrëzimet në KSA të Kosovës". Materiale nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 dhe 8 dhjetor 1989, Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë:1990.  
Brada, Riza. *Pedagogjia Familjare*, Pejë: 1995.  
Devolder, Daniel. *Effects of the European late*

*marriage pattern on kinship*. Centre d'Estudis Demographics. Italy: 1998.  
Engelen T. & Kok J. *Permanent Celibacy and Late Marriage in the Netherlands*. 1890-1960. Population, 2003/1.  
Giddens, Anthony. *Sociologjia*. Çabej. Tiranë: 2004.

- Islami, Hivzi. *Fshati i Kosovës kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural*. Rilindja. Prishtinë: 1985.
- Islami, Hivzi. *Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*. ASHAK. Prishtinë: 2005.
- Meçi, Xhemil. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Tiranë: 1997.
- Mensch, Barabara. Singh, Susheela. & Casterline, John. *Trends in the timing of first marriage among men and women in developing World*. Population Council. No. 202. 2005.
- Pushka, Asllan dhe Nazife. *Analiza e statistikave vitale të Kosovës për periudhën më të re*. ESK. Prishtinë: 2008.
- Pushka, Asllan. *Aspektet gjeopopullative në Kosovë dhe rreth saj*. Prishtinë: 2000.
- Savezni Zavod za Statistiku, Demografska Statistika 1960*. Socijalisticka Federativna Republika Jugoslavija. Beograd: 1963.
- Selimi, Yllka. *Jetë familjare*. ASHSH. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë: 2007.
- Statistikat e kurorëzimeve dhe shkëputjeve në Kosovë 2007*. Enti Statistikor i Kosovës. Prishtinë: 2007.
- Statistikat vitale të Kosovës*. Enti Statistikor i Kosovës. Prishtinë: 2002-2007.
- Tsutsui, Junya. *Factors of Late Marriage*. Japan: 2002.
- Vjetari statistikor i KSA të Kosovës. *Statistikat vitale të Kosovës*. ESK. Prishtinë: 1950-1988.

## RECENSIONE, ANALIZA VEPRASH

---

### Sociologjia e një filmi: demokracia e vitit 1936

Rreth filmit **“Koncert në vitin 1936”**

**Prof. dr. Hasan Jashari,**

*Universiteti i Europës Juglindore,*

*Tetovë- Maqedoni*

*More toger, të kam rixha...*

Ky shkrim merret me sociologjinë e filmit “Koncert në vitin 1936”, realizuar nga kinostudioja “Shqipëria e re”. Filmi paraqet një vendbanim tipik fshatar të kohës së Migjenit, siç ka qenë Lushnja e atyre viteve. Në film mund të vërehen këto çështje karakteristike të kohës:

1. Realiteti i atëhershëm i shoqërisë, një përzierje feudalo-kapitaliste me shtrësim të theksuar social. Jeta e përditshme në një mjedis ku urbanizimi ishte një fenomen ende i panjohur jo vetëm si koncept, por edhe si praktikë shoqërore.

2. Ardhja e dy këngëtareve në Lushnjë nuk është vetëm një mision kulturor, por edhe një porosi filozofike e kohës, që të shprehin kulturën e Oksidentit, pra Perëndimit: piano *Hartman*, Paris, Vjenë etj.

3. Orvatja e autorëve të filmit që të venë në lojë vitet dhe demokracinë e mbretit Zog.

4. Pikëpamjet demokratike të pushtetit të kohës së mbretit për rikthim nga Perëndimi nëpërmjet ngritjes së idesë së

progresit nëpërmjet vlerave të Europës dhe demokracisë: “Europa, aleatja e jonë e madhe...”

4. Porositë filozofike të pushtetarëve të atëhershëm properëndimorë (kohës së Zogut) përputhen me idetë e integriteteve dhe vlerave europiane që recitohen me entuziazëm e mburrje sot në Shqipëri dhe Ballkan.

5. Nga të dhënat, nga skenari, na paraqiten dy identitete kulturore: njëri lokal, që është një përzierje e kulturës orientale dhe traditës që është dominuese, si dhe identitetit të ri aksidental, që është në zanafillë.

\*  
\*   \*

Qasja shkencore e një prodhimi kulturor nuk është një çështje e lehtë. Ajo, në esencën e saj, është një ndërmarrje tejet delikate. Ngaqë kultura sot është forma bazë e shfaqjes së jetës sonë, logjikisht rrjedh se edhe ndikimet e saj në jetën sociale të njerëzve dhe më gjerë janë të mëdha. Që në fillim duhet të përballemi me një dilemë fundamentale: a thua se regjisori i filmit pati një porosi mobilizimit ideologjik për sajimin e filmit njëlloj sikur edhe pushtetarët e mbretit që mundoheshin të jetësonin ideologjinë e tyre te qytetarët me anë të fjalorit, gjesteve,

simboleve, ligjeve, vlerave të reja... Mund të thuhet se filmi përshkruan një situatë tejet dramatike kur në horizont shihet një identitet i ri kulturor, ai oksidental, përbri identitetit ekzistues tepër të fuqishëm dhe i shtrirë thellë në popullatë, identiteti oriental. Kjo, pra, është një analizë e ndërlikuar e krijimit të po këtij identiteti të ri.

Në kësi rrethanash mund të flasim për atë që në sociologjinë e kulturës e quajmë evolucionin kulturor. Në situatën e Shqipërisë në prag të Luftës së Dytë Botërore, kjo ecje ishte e ngadaltë, madje edhe e mundimshme. Duhet të theksohet se politika, si veprimtari që drejton të gjitha veprimtaritë e tjera, edhe kësaj radhe paraqitet si nxitëse e shndërrimeve kulturore.

Shikuar më gjerë, nuk ka gjë më të devotshme në jetën e njerëzve se puna e tyre për të mirën e të gjithëve. Historia e njerëzimit është përplot me diktatorë, por edhe me bamirës. Pushtetarët e të gjitha kohërave dhe shoqërive kanë qenë vazhdimisht në kërkim të asaj që ka qenë e mirë për veten e tyre, për bashkëmundimtarët dhe popullin. Mirëpo, historia, si mësuese e jetës që është, na mëson se vazhdimisht të këqijat e eksperimenteve me popullin janë bërë në kurriz të tij.

Duke parë filmin *Koncert në vitin 36*, na nxiten disa përsiatje, mendime dhe dilema. Ky film është plot e përplot me koncepte sociologjike: çështje të shtresave, grupeve, rivalitetit, stereotipave, vlerave e normave morale, mentalitetit patriarkal. Në shpjegimin e filmit mund t'u referohemi lirisht Durkheim, Max Weber, Aleksis de Tocqville, Marks etj. Ndosh-ta për një çast filmi na motivon që të bëjmë një risistematizim të kohës dhe të vlerave të shkuara dhe të tashme. Ndosh-ta kjo do të na detyrojë që në mënyrë reale të shikojmë përreth dhe ne, që e kemi tani gojën plot Europë dhe Perëndim, gjykoj se nuk jemi të parët që kemi zbuluar një gjë të tillë, nuk jemi as edhe pi-

onierë të demokracisë, siç pretendojmë. Pra, ajo që dua të theksoj është fakti se këtu e vërteta ka një karakter elementar dhe nëpërmjet filmit ne mund të vijmë në përfundim se karakteristikë më e theksuar e tij është vetë regjimi i mbretit, i cili i ka vënë vetes disa qëllime madhore për një transformim social të shoqërisë shqiptare. Këto synime janë filozofi vepri-mi e pushtetarëve, përderisa populli vështirë se i kupton dhe i pranon në një mjedis të varfër dhe pa perspektiva qytetare. Është tepër e vështirë që një kulturë tradicionale të ndërrohet në kushtet e një zone rurale të izoluar dhe të varfër.

Ngjarja zhvillohet në qytetin e Lushnjës, i cili i ngjan një fshati tipik shqiptar të asaj kohe. Skenari është i Kiço Blushit, bazuar në tregimin "Në baltërat e Myzeqesë" të Dhimitr Shuteriqit, një nga tregimtarët më të mirë të socrealizmit. Dy artiste të reja, Donika Prokopi, këngëtare (sopranoja Tefta Tashko Koço, e sapokthyer nga Parisi aso kohe) dhe Eleni Jan-kollari, pianiste, nisen drejt Lushnjës, ku duhet të japin një koncert. Një rrugëtim me peripeci mes baltërave të Myzeqesë, që vijoi me një pritje të ftohtë dhe të çuditshme nga drejtuesit lokalë me mendësi injorante dhe burokratiko-feudale. Pushtetarë që pianon *Hartman* e konsiderojnë si shqetësim, sepse mendojnë se është njeri që vjen në Lushnjë pa i informuar ata. Njerëz të papjekur dhe jo në nivel të funksionit të tyre shoqëror. Zaten në zonat rurale e reja gjithherë depërton shumë vonë dhe me shumë vështirësi. Lushnja e atyre viteve ishte një zonë me pabarazi të mëdha shoqërore, do të thoshte Emil Dyrkhemi, ngaqë pjesa dërmues e popullsisë ishte e papunë, e varfër. Ndosh-ta duke e shikuar panoramën e fshatit diku në humbëtitë, mund të pajtohemi me tablotë e trishtueshme të Shqipërisë të asaj kohe, shkruar nga **Karl May në librin e udhëpërshkrimeve të tij *Durch das Land der Skipetaren*.**

Bëhet pyetja: a mund ta përshkruajmë më mirë se në film një vendbanim të asaj kohe, me gjithë ato figura njerëzish, pamje fshati, ndodhi të ndërlikuara dhe tepër autentike? Materiali burimor i grumbulluar dhe i shfaqur me mjeshtëri të rrallë dëshmon se pushteti mundohet të ketë një raport demokratik me popullatën e shtresave të ndryshme, religjioneve, gjinive, profesioneve të ndryshme. E gjithë kjo në film - bota e asaj kohe - paraqitet më shpejt se ç'zhvilloheshin në të vërtetë gjërat. Autorët e filmit i janë qasur një raporti tejet të ndërlikuar shoqëror të asaj kohe, ku pushteti nuk jepte asnjë shërbim social, por kërkonte lojalitet të plotë nga qytetarët. Skenari i filmit në përgjithësi na jep të dhëna të bollshme për të kuptuar një rreth tipik patriarkal, ku kemi seksizëm të theksuar. Kjo vërehet nga ajo që vetëm meshkujt mund të lëvizin lirshëm jashtë shtepisë dhe të frekuentojnë akçihanet (kafenetë, gjellëtoreset).

### **Ndikimi i faktorëve të jashtëm**

A e çrregulloi jetën në komunitet ardhja e dy këngëtareve? Sa mund të dallohet në këtë rast ndikimi i një faktori të jashtëm? Çfarë shkelleje morale bënë ato? Janë vetëm disa pyetje, që përkojnë me kompleksitetin e jetës së njerëzve në një provincë shqiptare të viteve para Luftës së Dytë Botërore. Këngëtarët që shkojnë në Lushnjë përplasen me një botë tepër të mbytur në arkaizma, turqizma dhe kulturë orientale, me fjalor me huazime dhe vlera të osmanlinjve, pra, të Perandorisë Turke e cila kishte sunduar 500 vjet, por koha e ikjes së saj ishte ende e freskët. Rrethi është tipik konservator dhe injorant. Përplasja e dytë është mes pushtetarëve dhe popullit, qytetarëve. Përplasja e tretë është mes vetë mbretërisë dhe pushtetarëve të saj. Përderisa mbretëria kishte ide properëndimore, mënyra e prezantimit dhe ushtrimit të këtyre vlerave ishte jo

bindëse, jo e denjë, ndërsa në zonat rurale pushtetarët e brutalizonin zbatimin e tyre. Kjo domosdo krijonte një konflikt social mes popullit fukara dhe pushtetit që nuk ofronte asgjë për ta, përveç ideve europiane. Pra, domosdo imponohet një konflikt mes komunitetit fshataresk, sociokulturës lokale dhe modernizimit të Shqipërisë si ide e Lartmadhërisë. Kemi po ashtu një konflikt në mes Turqisë moderne të reformuar nga Mustafa Kemal Atatürk dhe Shqipërisë, që këmbëngulte të mbetej në padituri dhe kundërshtonte ndryshimet duke u munduar që të ruan traditën e osmanlinjve, një traditë që vetë turqit e kishin reformuar.

### **Filmografia - ditar i kohës.**

#### **Provinca - vendi ku ka ndaluar ora**

Filmi na ofron material faktografik për njerëzit e Shqipërisë së atëhershme. Për stilin e jetës, zakonet e tyre. Por, njëkohësisht, në film kemi edhe një seleksionim dhe interpretim të mirëfilltë sociologjik e filozofik të këtyre të dhënave, indikatorëve të ndryshëm. Mentaliteti, fjalori, vlerat e gjithëmbarshme janë dëshmi e një rruge tejet të vështirë dhe të mundimshme të Shqipërisë. Një fshat i madh, pa kaluar ende në kapitalizmin industrial, me elemente feudale të organizimit shoqëror dhe vlerave të reja të paartikulluara sa duhet. Një përzierje fesh e interesash të ndryshme lokale, qeveritare, interesa bejlerësh, por edhe interesi i theksuar aksidental i qeveritarëve.

Elementi turk, veçmas ndikimi i fesë islame dhe koha shumë e afërt me më ikjen e pushtimit, vetëm 24 vite, na sjellin në një gjykim se jeta sociale e njerëzve është e zymtë. Fjalori i popullatës dhe i pushtetarëve lokalë është: lepe, peqe, akçihane, estekfurllah etj. Nga filmi mund të kuptojmë sociologjinë e Lushnjës dhe Shqipërisë së asaj kohe: jeta e njerëzve në fshatrat e Shqipërisë, punët, profesionet e

tyre si shitës të kininave, farkëtarë, bujq që kërkonin reformë agrare. Ekonomia fshatare paraqitet si e këputur dhe e pa shpresë. Pra, qartë mund të formësohet dhe të ndërtohet mozaiku hapësinor i jetës në Myzeqenë e kërcënuar nga malaria. Por çështje në vetvete është funksioni kulturor i bashkësisë lokale. Ajo, siç thotë Klod Levi Stross, është robi i kulturës së saj. Institucionet lokale janë të pazhvilluara, funksionojnë jo të bazuara në interesa, mirëkuptim dhe në parimin e bashkëpunimit, por me dhunë. Bejlerët bëjnë një pushtet paralel me shtetin. Grupet sociale janë të zhvilluara dobët, kurse stratifikimi social, pabarazia janë tepër të shkallëzuara. Vërehet një shtresë e vogël e lartë, e përbërë nga pushtetarët lokalë, bejlerët dhe njerëzit e tyre. Kjo shtresë kontrollon jetën sociale, jetën kulturore, postën, telegrafin, policinë, gazetatat. Një shtresë e mesme e padukshme, me pak mësues, punëtorë, qeveritarë dhe zanatçinj, si dhe një shtresë e ulët, numerikisht tepër të madhe.

### **Sociologjia e filmit dhe një stil i tipik i jetës**

Ideja e këtij shkrimi është që të fokusohemi te çështja bosht e filmit. Kjo është kritika që i bëhet ideologjisë zogiste nga pushteti i Enver Hoxhës. Filmi është xhiruar në vitin 1978 dhe ideja ka qenë që të vihej në lojë politika publike e mbretit Zog. Shqipëria atëherë ishte në dashuri me Kinën dhe Revolucionin e saj Kulturor. Dhe kjo bëhet vërtet me të qeshura, se si mbreti ka nxjerrë ligje për heqjen e ferexheve, festeve dhe çarçafëve për gratë dhe vajzat. Kishte edhe ligje për vagabondët dhe lypësit, ligj për karrocierët, që të mbanin uniforma të pëlqyeshme dhe të mos i rrihnin kuajt. Realisht, këto mund të jenë çështje të debatueshme, por një pjesë e tyre, tani, në Ballkanin Perëndimor, janë pjesë e kulturës perëndimore dhe i punës

që bëjnë një numër i madh i organizatave joqeveritare dhe qeveritare.

Bëhet një pyetje: a ishte Zogu në aspektin ideologjik properëndimor në vitin 1936? Gjithsesi po. Pyetja tjetër është: pse Enveri e ndaloi fenë plotësisht, bashkë me të edhe ferexhetë? Këtu ndoshta ironia e paraqitur në film bazohet në faktin se kjo orvatje e Zogut nuk realizohej sa duhej, por të mos harrojmë se kemi të bëjmë me 30 vjet përpara dhe me një nismë tepër fisnike. Hoxha e kishte rrugën të hapur kur e filloi projektin e tij të heqjes së fesë nga roli i saj shoqëror dhe atë e bëri me dhunë.

### **Sytë nga Oksidenti**

Nëpërmjet protagonistëve kryesorë lexojmë të dhënat e kohës, sjelljen individuale dhe kolektive të figurave të rëndësishme në bashkësi. Informimi publik bëhet nga tellalli, zëdhënësi, zyrtari lajmëtar i sotshëm i bashkisë apo i një institucioni. Kërkesa e prefektit Xhevo dhe nënprefektit Fotaq që populli të drejtojë sytë nga Oksidenti janë pra integrimet e sotme europiane, Bashkimi European si metaforë e të gjitha politikave qeveritare pas vitit 1991. Pra, vlerat europiane në shoqërinë shqiptare; heqja e ferexheve po ashtu. Duhet thënë se ideologjia komuniste e viteve 70-80 të shekullit të kaluar, ndërsa kritikonte deri në tallje ideologjinë e Zogut, në esencë i ka bërë asaj një shërbim të mirëfilltë. Nga fjalori i pushtetarëve fitojmë përshtypjen dhe bindemi thellë se Zogu ka qenë vizionar. Ngjarja e filmit është një ndodhi dhe njëkohësisht një porosi e fortë e kohës për popullatën dhe gjithë Shqipërinë. Ajo dëshmon për një nismë të rilindjes kulturore e ekonomike nëpërmjet Perëndimit. Dhe me këtë rast vijoj të këmbëngul se ajo ka ndodhur në një kohë tejet të vështirë edhe për popullatën edhe për qeverinë e atëherëshme. Koha e dëshpërimit të madh, kur

njerëzit e atjeshëm, siç shprehen, nuk e kanë parë as Tiranën. Me sa duket, qytetarët në Shqipërinë e atëhershme, përkundër ngulmimeve për kulturën e Romës e Parisit, ishin të papërgatitur për këto lëvizje kulturore.

Natyrisht, krejt padashur, filmi i xhiruar në kohën e komunizmit nxjerr në pah vlerat e demokracisë shqiptare në vitin 36. Këto janë vetëm disa vlera të kohës, synime që paraqesin një nismë të rikthimit të Shqipërisë në Europë dhe imazhit të

saj properëndimor. Filozofi politike, pra e mbretërisë. Krejt tjetër është ajo se sa, në ato kushte, mbretëria ka mundur dhe ka realizuar këto përcaktime politike në praktikë. Mund të themi lirisht se europianizimi i atëhershëm i Shqipërisë ishte një çështje e pashpresë, por qeveria e nxititi këtë proces.

Si përfundim, ky film paraqet një analizë të mirëfilltë sociologjike të kohës në të cilën është zhvilluar ngjarja, si dhe jetën sociale të njerëzve.

## REFERENCAT

- Carol Hodge & Marc Almond, *Europës Bacquard*, Heinemann, 1994.
- Fisk D•on, *Popularna kultura*, Clio, Beograd, 2001.
- Amato, Paul R., Booth, Alan.- *A generation at risk*. Harvard University Press, 1997.
- Abdulati, Hammudah.- *The Family Structure in Islam*. Indiana, 1997.
- Davutoglu, Ahmet.- *Kriza globale*. Shkup: Logos A, 2005.
- Fukujama, Francis.- *Amarecan Cros -Roads*. Berlin: Vertblum, 2006.
- Giddens, Anthony.- *Sociologjia*, Tirana, 1997.
- Alfred Kreber.- „O Kulturi”, Teorije o drustvu, V. Karadzic, Beograd, 1984.
- Sociology Goes to the Movies*. New Delhi: Sage, 2006.
- Inglehart, R.- *Modërnization and Postmodernization. Cultural, Economic and Political Changes in 43 Societies*, Princeton: Princeton University Press, 1997.
- Jashari, Hasan.- *Sociologjia e arsimit*. Shkup: Interlingua, 2005.
- Jashari, Hasan.- *Familja dhe bashkësia*. Tetovë: UEJL, 2006.
- Jary, David, Jary Julia.- *Hyman Dictionary of Sociology*. HarperCollins Publisher.
- Latifi, Veton.- *Lidershipi politik*, Akademik Press, Shkup, 2009.
- Laifi, Veton.- *Konceptet e demokracisë*, Akademik Press, Shkup, 2009.
- Laswell H. D.- *The structure and function of communication in society*. Bloomington: Illinois state university, 2002.
- Micel, X. Vilijam.- *E-topija*. Massacuscst Institut of Technology, 2000.
- Ruano, Jean-Claude.- *Borbalan Lëidentite, Lëin-dividu, le groupe, la societe*. Edition Sciences humaines, 1998.
- Sokolwicz, Lech Mroz Zofia.- *Between Tradition and Postmodernity*. Warsaw: DiG, 2003.
- Jukka Grunow.- *Sociologjia ukusa, Jesenski i Turk*, Zagreb, 1999.
- Norbert Elias.- *O procesu civiliziranja*, Antibarbarus, Zagreb, 1996.
- Mike Featherstone.- *Konsumer culture and post-modernism*, SAGE, London, 1990.
- Terry Eagleton.- *Ideja kulture*, Jesenski i Turk, Zagreb, 2002.
- Inga Tomiæ-Koludroviæ, Anëi Leburiaë, *Sociologjia zivotnog stila*, Jesenski i Turk, Zagreb, 2002.
- Manuel Castells.- *Uspen umreznoga drustva*, Golden Marketing, Zagreb, 2001.
- Rajinder Kumar.- *Dudrah, Bollywood: its Films*. Hong Kong: The Chinese University Press, 2005.

## Servet Pëllumbi midis filozofit dhe politikanit

Rreth librit **“Filozofia e aktualitetit”**  
të prof. Servet Pëllumbit  
**Gëzim Tushi, Instituti i Sociologjisë**

Servet Pëllumbi njihet për polivalencën e tij në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Ai është, pa dyshim, jo vetëm politikan dhe intelektual i njohur me kontribute brenda vendit dhe përtej tij, por njëherësh është, dhe me siguri do të mbesë, njëri nga filozofët më të mirë të plejadës së tij, një “gur themeli” i historisë së mendimit filozofik dhe sociologjik shqiptar. Libri i tij më i fundit, “Filozofia e aktualitetit”, është një rast që të lejon të thuash shumë gjëra të merituar, që janë vlera permanente teorike, morale dhe intelektuale për autorin e saj.

Sot është kohë e vështirë të merresh me filozofi dhe ca më e vështirë të shkruash dhe të hedhësh ide në fushën e mendimit filozofik, sepse në kohën tonë ka shumë “mirazhe deformuese”, që të krijojnë idenë e gabuar e simpliste se ajo, filozofia, në pamje të parë duket e “paaftë” për t’u përzierë me problemet e ngatërruara të modernitetit. Por, në të vërtetë, nuk është kështu. Këtë e kupton kur mbaron së lexuari librin e prof. Pëllumbit, i cili jo vetëm që të krijon përshtypje tjetër, por dhe bindesh se në shoqërinë moderne hapësira e filozofisë jo vetëm që nuk është ngushtuar, por përkundrazi është zgjeruar edhe më shumë.

Servet Pëllumbi është autori që, si filozof, i ka gjithnjë merak jo vetëm kontekstet e mendimit, por veçanërisht përcaktimet, nevojën për definicione të sakta, idetë sa më të shtjelluara dhe teorikisht të qarta, sa më adekuate, sa më afër së vërtetës objektive, qoftë kjo sociale apo shpirtërore. Njeri me skrupulozitet intelektual, moralisht sqimatar dhe filozofikisht elegant, ai të bind me librin e tij të fundit

për disa të vërteta që janë fundamentale dhe për të cilat shoqëria dhe njerëzit tanë kanë nevojë më shumë se kurrë. Mendimi teorik dhe përsiatjet filozofike të tij dëshmojnë atë të vërtetë që autori nuk e thotë tekstualisht, por që nënkuptohet në të gjitha faqet e librit të tij, se shoqëria jonë në fazën e tanishme të zhvillimit të qytetërimit demokratik, ka nevojë më shumë se kurrë për koncepte të qarta, për optika filozofike realiste dhe optimiste, ndërsa njerëzit tanë kanë nevojë imediate për ide të qëndrueshme.

Libri i prof. Servetit është pasqyrim adekuat i faktit se shoqëria jonë ka shumë probleme që nuk zgjidhen vetëm me parë dhe mendim konsumist, me perceptime të thjeshtëzuara utilitariste dhe pragmatiste të jetës. Por duket se shoqëria dhe njerëzit tanë sot kanë nevojë për më shumë qartësi ontologjike, për struktura mendore konceptuale dhe aftësi të gjëra epistemologjike. Në libër ka shumë fakte, analiza e përsiatje filozofike të shkëlqyera, që na bindin se shoqëria shqiptare është e mbushur me probleme që duhen konceptuar më parë se të zgjidhen. Nga ana tjetër, koha moderne në shoqërinë tonë është “kohë hamletiane”, e mbushur me njerëz që kanë shumë dilema sociale, vakume të thella ekzistenciale, humnera shpirtërore, paqartësi të forta, “tërmete” të fuqishme emocionale. Të gjitha këto nuk zgjidhen pa ndihmën e mendimit filozofik teorik, pa trajtimet konceptuale për të cilat ka fuqi, pushtet dhe autoritet filozofia teorike.

Në këtë rast, libri “Filozofia e aktualitetit” dhe autori i saj përbëjnë një “entitet krijues” dhe janë të lidhur pazgjidhshmërisht. Në këtë kontekst, libri është një tjetër dëshmi për fizionominë krijuese të autorit, e potencës, karakterit, merakut intelektual dhe rolit të përjetshëm të misionarit, që ky njeri e ka patur konstanten e pandryshuar morale dhe qytetare të personalitetit të tij. Ndaj, megjithëse i aftë të

bëjë edhe “filozofin e kabinetit”, por dhe politikanin e jetës empirike, ai, në librat e veta, gjithnjë ka merak që idetë e vështira t’i trajtojë me kujdes, me sens mase dhe me merakun që ato të mos mbeten si “zbukurim intelektual” apo tregues për të bërë ekzibicion personal. Ai, me shumë sukses, i tregon lexuesit, qytetarit dhe publikut profesionalisht të interesuar se është filozof që di të ndërtojë me sens mase edhe “teori të kulluara”, kur duhet apo kur nevojat e shtrimit të problemeve është thellësisht konceptuale, por në të njëjtën kohë është i zoti të bëjë edhe vëzhgime të holla të realitetit tonë (kjo është veçori e natyrshme e filozofit). Pse ka këtë merak krijues, prandaj është më i zoti kur bën deduksione kontekstuale të realitetit tonë social, të cilat, të trajtuara në mënyrë filozofike, e lejojnë Servet Pëllumbin të bëjë konkluzione me vlerë orientuese dhe në shumë raste edhe definitive për realitetet tona.

Po të lexosh me vëmendje librin, e kupton fare qartë aftësinë e autorit për të përdorur “armën e filozofisë” në kontekste të larmishme dhe të diversifikuara nga pikëpamja tematike dhe sociale. Dhe këtë e kupton edhe kur ai është në fushën e tij të preferuar të “teorisë së kulluar”, në zonën e të menduarit akademik apo kur shikon dhe trajton “epifenomenet sociale” si filozof.

Servet Pëllumbi ka ca arsye të jetës dhe të karrierës së vet politike e profesionale që ia kanë mësuar artin e përshtatjes “par excellence” me realitetin teorik dhe empirik. Kur është akademik, ai bën akademikun, kur është në politikë luan rolin e politikanit dhe kur merret me problemet e filozofisë, është filozof. Profesori ka meritë sepse, si filozof, ka treguar se ka forcë që ta largojë teorinë filozofike nga “klishe-të e vdekura”, puna e ngurtë dhe e ftohtë e specialistit dogmatik të filozofisë. Dhe prandaj ai ka gjithnjë aftësinë që problemet në dukje të “ngushta” të filozofisë në librin e vet “Filozofia e aktualitetit”, i

bën çështje të interesit të përgjithshëm.

Në këtë libër ka analiza shumë të thella, disa prej të cilave përtej kufijve të realitetit tonë social dhe interpretimit filozofik, që e ridëshmojnë autorin e saj si një analizues që ka skrupulozitetin dialektik për parë dhe vlerësuar sendet, gjërat dhe dukuritë sociale në thelbin e kundërshtive. Kjo aftësi polivalente e njohur duket te ky autor edhe kur është pedagog dhe bën leksione të shkëlqyera, edhe kur është politikan dhe luan rolin e burrit të mençur të shtetit, por edhe kur është filozof, që bën filozofi teorike të klasit të parë.

Profesori e ka në natyrën e vet që të jetë i qetë, i matur, qoftë kur është në rolin e filozofit apo në atë të politikanit. Por brenda natyrës së tij të qetë, në këtë libër ai ka shfaqur një “verb filozofik” gjithë nerv, ngaqë shumë gjëra, sipas tij, kanë devijuar subjektivisht nga normat dhe standardet e qytetërimit demokratik e liberal. Pa dyshim që jetojmë në “epokë tjetër”, jemi në valët realiteteve të jetës moderne dhe doemos që relativizmi edhe në filozofi është bërë prirje globale. Është kohë e vështirë, sepse tani jetojmë në një epokë moderne, kur nuk ka më “besime” të mëdha, të përherëshme, të qëndrueshme dhe të pandryshueshme. Nuk ka më doktrina filozofike që të jenë të “patejkalueshme”.

Ndaj në këtë libër më duket se, si rrallë herë në veprat e tij, dikotomia e autorit midis “qetësisë platonike” të filozofit dhe verbit të intelektualit dhe qytetarit të angazhuar është shumë e fortë, përtej natyrës së tij. Dhe kjo tregon se ai ka arsye të forta intelektuale, morale, filozofike dhe qytetare.

Autori mund të ketë dashur t’i thotë opinionit publik dhe studiuesve të filozofisë shumë gjëra. Por ajo që kuptohet qartë është mesazhi i tij se shoqëria, njerëzit dhe jeta jonë, si kurrë më parë, për shkak të ndryshimeve epokale kontekstuale dhe konceptuale që kanë ndodhur në këto

dy dekada të jetës demokratike, kemi nevojë urgjente për mendimin e kualifikuar dhe elitar filozofik. Ky është një imperativ i madh intelektual, social dhe filozofik, në të cilin autori e vuri “gurin e vet” edhe me veprën “Filozofia e aktualitetit”, që është një galeri e problematikave kryesisht të filozofisë politike që ka tani shoqëria shqiptare.

Filozofi i shquar francez Zhak Derrida ka thënë se filozofia është gjithnjë, pra jo vetëm në histori, por edhe në aktualitetin tonë. Ajo nuk ka “vdekur”, por jeton dhe për të, me sa duket, koha moderne ka sjellë “materie të bollshme”. Këtë e vërteton edhe Servet Pëllumbi në librin e vet “Filozofia e aktualitetit”, që lexuesit e kanë në dorë nga një botim i shkëlqyer i Shtëpisë Botuese “Dudaj”.

## Kombi dhe era globale

Recensë e veprës **“Kombet dhe nacionalizmi në erën globale”**

Të **A. D. Smith**, *Instituti për Studime Publike dhe Ligjore & Dudaj*, Tiranë 2008

Nga **Enis Sulstarova**, *Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale; Instituti i Sociologjisë*

Qëllimi i Smithit në librin e tij *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale* është rivlerësimi i këndvështrimeve që ai ka për nacionalizmin dhe, brenda teorisë së tij, të analizojë tendencat e globalizimit dhe ringjalljen e lëvizjeve nacionaliste e etnike kudo në botë. Sipas tij, ka tri këndvështrime teorike, që përpiqen ta rrokin këto procese.

I pari thotë se nacionalizmat bashkëkohore janë dukuritë e fundme të një periudhe që e ka kryer ciklin e saj. Nacionalizmi nuk është më një ndër lëvizjet e mëdha historike të tanishme dhe kombet do të shkojnë drejt zhdukjes, për t’u zëvendësuar nga njësi më kozmopolite.

Këndvështrimi i dytë thotë se kombet dhe nacionalizmi janë produkte të pashmangshme të modernitetit dhe nuk kanë për t’u zhdukur për aq kohë sa të gjitha zonat e botës ta kenë kryer tranzicionin drejt modernitetit.

Këndvështrimi i tretë thotë se kombet dhe nacionalizmi janë të lashtë. Era e tanishme moderne, ose pasmoderne, është ajo që do të zhduket, por kombet do të vazhdojnë të jenë themele të shoqërisë njerëzore.

Smith nuk bie dakord me asnjërin prej këndvështrimeve dhe në tre kapitujt e parë të librit angazhohet në kritika ndaj tyre. Mbrojtësi i këndvështrimit të parë është Erik Hobsbaum [Eric Hobsbawm]. Sipas tij, tri procese po ndodhin sot në botë, që po e çojnë shtet-kombin drejt fundit: çpolitizimi i shtet-kombit, që do të thotë ndarja e sferave politike dhe kulturore; çmilitarizimi i shtet-kombit; rutinizimi i nacionalizmit dhe marrja përsipër prej organizatave ndërkombëtare të shumë prej funksioneve të shtet-kombit. Smithi i kundërshton këto argumente duke thënë se, së pari, *contra* Gellnerit, nacionalizmi nuk mund të reduktohet në parimin se njësia kombëtare duhet të përputhet me atë politike. Ai është një lëvizje që kërkon edhe të rigjenerojë nga ana kulturore dhe morale bashkësinë kombëtare, përveç se kërkon realizimin e mobilizimit politik dhe vetëvendosjen e kombit. Së dyti, nuk është e vërtetë se kombet po çmilitarizohen dhe, siç e treguan luftërat në ish-Jugosllavi, ushtritë konvencionale vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm. Së fundi, në rendin e tanishëm ndërkombëtar, shtet-kombi është i legjitimuar nga e drejta e vetëvendosjes, e parashikuar nga Karta e OKB-së.

Më pas autori e kthen vëmendjen te supozimi i ekzistencës së një shoqërie kozmopolite. Në histori të gjitha shoqëritë e shpallura kozmopolite i kanë pasur rrënjët tek imperializmi i shteteve të fuqishme. Prireja e kohëve të fundit, të përmbledhura nën termin e “globalizimit”, mund të

shihen nën këtë dritë si imponimi i hegjemonisë së disa shteteve të Perëndimit mbi pjesën tjetër të botës. Sipas Smithit, një kulturë me të vërtetë kozmopolite në epokën e sotme duhet të jetë universale, në kuptimin e të qenit më universale se sa kanë qenë të gjitha perandoritë deri tani. Ajo duhet të jetë një kulturë joetnike, në kuptimin që përdorimi prej saj i elementeve etnike apo kombëtare të jetë neutral. Ajo duhet të jetë edhe një shoqëri e pakohë, në kuptimin që nuk duhet të ketë një sfond historik, nuk duhet të ketë një ritëm të vetin, as një sens të kohës apo sekuencës. Edhe nëse një kulturë e tillë mund të jetë në formim e sipër, ajo nuk mund t'i kënaqë nevojat njerëzore, siç bënin kulturat e së shkuarës.

Për sa i përket këndvështrimit të dytë, sipas të cilit kombet janë konstrakte elitare për t'iu përgjigjur nevojave të modernizimit, Smithi vëren disa dobësi të përgjithshme të argumenteve të tij. Është e vërtetë se nacionalizmi si ideologji dhe lëvizje politike është një dukuri e vonë e shek. XVIII, por është e mundur që ndjenjat kombëtare të gjurmohen në shek. XIII-XVI në disa vende të Europës Perëndimore. Dështimi i shumë shteteve të reja të Afrikës dhe Azisë dëshmon për dobësinë e identiteteve dhe institucioneve kombëtare, që nuk marrin parasysh apo përpiqen të kapërcejnë lidhjet etnike. Modernistët, siç i quan Smithi mbështetësit e këtij këndvështrimi, nuk arrijnë të shpjegojnë për se njerëzit zgjedhin etnicitetin apo nacionalizmin si mjete të modernizimit dhe jo klasën apo rajonin. Modernistët fokusohen te manipulimi i masave nga ana e elitave dhe anashkalojnë dinamikën e mobilizimit masiv *për se*, që flasin për përgjigjet nga ana e masave. Modernistët nuk marrin siç duhet në konsideratë fuqinë e lidhjeve paramoderne etnike dhe faktin se shtete të fuqishme dhe të rëndësishme ko-

mbëtare u formuan pikërisht rreth bërthamave etnike (p.sh. anglezët, francezët, kastilianët, suedezët).

Këndvështrimi i tretë është ai i pernalistëve (nga *perennial*, i vazhdueshëm, diçka që është për një kohë të gjatë), që thonë se nuk ka asgjë të re te kombet moderne, veç teknologjisë dhe aparatit administrativ, që mund të përdorin elitat e tyre. Smithit i duket i pakënaqshëm ky këndvështrim, sepse lë mënjanë analizën dallime të rëndësishme që ekzistojnë midis bashkësive paramoderne dhe atyre moderne. Kombet moderne janë “kombe të masave” dhe ndryshojnë prej grupeve elitare që, në lashtësi apo mesjetë, thirreshin me termin *nation*. Kombet moderne janë bashkësi ligjore dhe politike, që nënkuptojnë të drejtat e qytetarëve, si dhe sovranitetin e tyre, që nuk ishte dukuri e zakonshme në mesjetë. Kombet moderne legjitimohen nga një ideologji universale, nacionalizmi, i cili mungonte në kohët e shkuara.

Së fundi, kombi modern është territorial në një kuptim më të fortë se ç'ishin bashkësitë paramoderne.

Në krerët vijues të librit, Smithi shqyrton krizën e shtetit kombëtar (kreu 4), mundësinë e një mbi- apo tej-nacionalizmi (kreu 5) dhe ofron një mbrojtje të kombit (kreu 6).

Në kreun e fundit të librit, Smithi argumenton se kombet dhe nacionalizmi mbeten baza e vetme reale për një shoqëri të lirë të shteteve në botën moderne. Kombet dhe nacionalizmi janë të nevojshëm, sepse vetëm ata mund të rrënjosin rendin ndërshtetëror te parimi i sovranitetit popullor dhe identiteti kombëtar përbën bazën e vetme për kohezionin social. Veçse kjo nuk duhet të bëjë të harrojmë se kombet janë të trupëzuar historikisht: ata janë trashëgimtarë dhe shndërrime moderne të etnive paramoderne.

# PROCEEDINGS - ABSTRACTS

ISBN: 978-99956-795-7-6

---

*Në këtë botim janë përfshirë punimet (ose pëmbledhje të tyre), të prezantuara në konferencën shkencore ndërkombëtare: "Njëzet vjet transformime demokratike; Shqipëria në kontekst eurolindor" organizuar nga Instituti i Sociologjisë, Universiteti "Aleksandër Moisiu" i Durrësit dhe Fondacioni "Fridrich Ebert Stiftung", mbajtur në Tiranë (Tirana International Hotel), më 20-21 dhjetor 2009.*

*Ato janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe botohen si Proceedings, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 467, datë 18. 07. 2007 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik".*

---

## **The macroeconomic framework in Albania during 1989-2009: performance and problems**

**Luan SHAHOLLARI MA**, *Albanian Institute of Sociology.*

The stabilization of the macroeconomic indicators is a condition for the sustainable development of every country. This is a essentially necessary process toward a democratic and market economy system especially for Albania, as an ex-communist country. The analysis presents progressive achievements, though with some fluctuations, since the Berlin Wall falling. Liberalization and privatization are essentially economic processes but they were not accomplished by coherent programs. As a result, GDP in 1991-1992 decreased to 27 %, inflation increased to

237 %, unemployment level 26.5 %, budget deficit toward GDP -58.6 %, etc. Reforms showed their effectiveness only after 1993. GDP increased to 13.3 %, inflation decreased to 6 % in 1995. But, in the same time, were expanded informal economy, corruption and pyramidal schemes that collapsed in the end 1996 and in the beginning of 1997. As consequence of this collapse, thousands of Albanian households wasted over \$1.5 billions, GDP decreased 10.2 % in 1997; inflation increased to 42.1 %, budget deficit reached 13 % of GDP, unemployment level 14.9 %. Unlike the first depreciation (1991-1992) that was caused both by objective and subjective factors, the second came mostly by unproprieate governmental policies. The program of the next government that came in power after the 1997 crisis resulted successfully in

the economic reforms. The macroeconomic stabilisation came in improving yera after year during 1998-2008. GDP has resulted in average over 6% per a year, reaching 3 963 usd per capita in 2008, 5 times more then in 1989. Mostly of state own enterprises in mobile and fix telecommunication, airports, bank system, in the minerar ,cemento, food industry, SME-s, were privatized. Since year 2005 about 80 per cent of GDP was provided by privat sector. Privatization and fiscal policies deepened the economic freedom. All these impacted in the opening of negotiations Albania-EU for Stabilization Association Agreement on January 31, 2003 as well as for the signing of this Agreement on June 12, 2006. The acceptance of Albania in the OTAN on April 4, 2009 was the next important integration step to the euroatlantik structures. Though Albania was not directly impacted from the world financial crisis, it is not able to avoid her effects. The decreasing of remittances, export-imports, exchange rate are impacting the growing of GDP, deficit budget, unemployment level, etc. These effects will continue in the year 2010 too, but I think that now we have all the necessary capacities and experiences to maintain the macroeconomic stability within estimated limits.

### **NGO-s and Civil Society:**

**Where we have been, Where we are and where are we going...**

**Dr. Eglantina Gjermeni**, *Deputy, Member of Albanian Institute of Sociology;*

**Dr. Lori E. Amy** *USA; Fulbright Scholar Tirana, Albania, 2009 – 2010*

We want to situate a discussion of the role of the NGO sector in developing civil society within the larger conflicts about the role of the state in the post cold war

era. In the twenty years since the dismantling of the Berlin wall – the symbol par excellence of cold war politics – we have seen the euphoric belief in the power of the global free market give way to the sober realities that un-checked markets lead to economic collapse, as for example with the 1997 economic collapse from Pyramid schemes in Albania and the 2008 global economic crisis precipitated by banking practices in the United States. This context is extremely important as it raises questions about the practices of decentralization in Albania after the fall of the communist government. The NGO sector has been, by and large, responsible for addressing social sector problems resulting from the large-scale dis-investment in the public sphere under the dictates of privatization. Especially in the realm of social services, the state has been virtually invisible. Assisted by the international agencies structuring development aid, the NGO sector has been largely responsible for defining and addressing the many social problems accompanying transition – domestic and family crises of internal migration and displacement, violence against women and children, human rights abuses, sexual violence and trafficking, the increased insecurity of the individual and family in states of emergency (the Kosova war, the economic collapse and resulting civil crisis). As Albania moves towards integration with the European Union, we must begin to re-imagine the responsibility of the state to the individual and the family and restructure the means by which social-sector services are provided. It is in this context that we analyze the history of the Gender Alliance for Development Center (GADC), a non-governmental organization promoting women's human rights and equality of women and men in Albania. We will use the GADC as a case study that can help us map the nature and scope of the work that NGOs

